



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 487 Akti

Nr. 646 Vendimi
Tiranë, më 13.4.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Lulzim Hamitaj	Kryesues
Genta Tafa (Bungo)	Relatore
Valbona Sanxhaktari	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler, në datën 11.4.2023, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Fahrije Stringa (Budo)**, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;
Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;
Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoji arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Genta Tafa (Bungo), vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5 të nenit 179/b të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në pikën 5 të nenit 3 dhe në pikën 1 të nenit 5 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjekti i rivlerësimit Fahrije Stringa (Budo), aktualisht me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është subjekt i rivlerësimit, që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni), në datën 15.6.2020, zhvilloi procedurën e shpërndarjes me short të çështjeve në trupa gjyqësore, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit Fahrije Stringa (Budo) do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjyqësor i përbërë nga komisionerët Genta Tafa (Bungo), Valbona Sanxhaktari dhe Lulzim Hamitaj. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionerja Genta Tafa (Bungo).

4. Në mbledhjen e trupit gjyqësor të datës 17.6.2020 u caktua me mirëkuptim kryesues z. Lulzim Hamitaj, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjyqësor, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit.

5. Në referim të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit Fahrije Stringa (Budo) nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

6. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimi deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

7. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V, “Kontrolli i figurës”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

8. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI, “Vlerësimi i aftësive profesionale”, të ligjit nr. 84/2016, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

9. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK); dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ). Këto raporte janë administruar nga relatorja me fillimin e hetimit administrativ.

10. Në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dërgoi raportin¹ e hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Fahrije Stringa (Budo). Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, është konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për burimin financiar të pasurive;*
- *ka mosdeklarime të pasurive;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

11. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka dërguar raportin² e saj për subjektin e rivlerësimit, në përfundim të të cilit ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit Fahrije Stringa (Budo).

12. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe ka dërguar, në zbatim të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, një raport³ të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

13. Në vijim, relatorja e çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret: vlerësimi i pasurisë; kontrolli i figurës; dhe vlerësimi i aftësive profesionale.

14. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, në datën 9.3.2023 vendosi: (i) përfundimin e hetimit

¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 6.2.2020.

² Raporti nr. *** prot., datë 27.10.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. **, datë 6.1.2021, të KDZH-së.

³ Me shkresën nr. *** prot., datë 9.11.2021.

kryesisht për të tria kriteret për subjektin e rivlerësimit; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me materialet e dosjes; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur prova dhe shpjegime, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

15. Subjekti i rivlerësimit, në datën 17.3.2023, u njoftua mbi të drejtën e saj për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkonte marrjen e provave të reja ose thirrjen e dëshmitarëve lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes në datën 20.3.2023, ndërsa në datën 3.4.2023 ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja në përgjigje të rezultateve të hetimit.

16. Pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore⁴.

II. SEANCA DËGJIMORE

17. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore publike me njoftimin e bërë elektronikisht me *email*, në datën 17.3.2023.

18. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 11.4.2023, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler.

19. Subjekti i rivlerësimit Fahrije Stringa (Budo) mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

20. Znj. Fahrije Stringa (Budo) ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, duke u përgjigjur në kohë, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ.

20.1 Subjekti i rivlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur, ka qenë korrekte dhe e gatshme për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

21. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet

⁴ Vendimi i ndërmjetëm nr. 3, datë 6.4.2023.

funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

21.1 Referuar vendimit nr. 2/2017⁵ të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016 rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

22. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e këtij subjekti, dërguar në Komision; (d) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportet e kontrollit të figurës të dorëzuar pranë Komisionit nga DSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar pranë Komisionit nga KLGJ-ja; (ë) denoncimet e publikut; (f) gjetjet dhe opinionin e paraqitura me shkrim nga vëzhguesi ndërkombëtar; si dhe (g) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

23. Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së këtij subjekti. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, si dhe burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive.

23.1 Subjekti ka filluar detyrën në datën 13.5.2000 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Në deklaratën *Vetting* (shtojca 2), të dorëzuar në ILDKPKI në datën 29.1.2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar se zotërojnë këto pasuri:

⁵ “41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: ‘Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit’. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se ‘Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë’. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

24. Depozitë në bankën “Societe Generale Albania”⁶, krijuar në datën 29.7.2009, në shumën 30,000 euro dhe gjendje në shumën 34,811.31 euro, në datën 20.10.2016

Burimi i krijimit sipas deklaratës Vetting: “a) Shuma 351,706 lekë, e depozituar në Bankën e Kursimeve në datën 24.9.1999, dhuruar nga motra ime L.B. Kjo depozitë është tërhequr në fund të vitit 2005 pranë ‘Raiffeisen Bank’ dhe është depozituar në datën 13.1.2006 në Bankën Popullore shuma 520,000 lekë, e cila së bashku me interesat në janar 2009 është në shumën 705,547.21 lekë.

b) Prindërit e mi, pranë BIA Bank kanë pasur një llogari bankare. Në datën 23.8.2004 më kanë përfshirë edhe mua për arsye të moshës së thyer. Këtë depozitë e kam tërhequr më 8.1.2009 pranë ‘Intesa Sanpaolo Bank’ bashkë me interesat në shumën 2,926,125.75 lekë. Burimi janë: të ardhurat e realizuara në vazhdimësi të jetës së tyre; dëmshpërblimet e përfituara si të prindjekur politikë nga Ministria e Financave, nga letra me vlerë, edhe përmes vendimeve gjyqësore; nëna ime M.B ka shitur një shtëpi në Durrës në datën 26.12.2003 në vlerën 1,500,000 lekë vlerë reale, si dhe të ardhura nga vajza e tyre L.B. Këto shuma të konvertuara në euro në datën 29.7.2009, në shumën 30,000 euro, janë depozituar prej meje në Bankën Popullore, së bashku me interesat, edhe gjendje në total 34,811.31 euro në datën 20.10.2016. Pjesa takuese: 100%”.

Konstatimi i ILDKPKI-së

- Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor mbi të ardhurat e shtetasës L.B.(motra e subjektit) për dhurimin në shumën 351,706 lekë, si dhe për ndihmën e dhënë prindërve për krijimin e depozitës në bankën Italo-Shqiptare.
- Mungesë burimi të ligjshëm financiar për krijimin e depozitës në bankën Italo-Shqiptare në emër të prindërve të subjektit, pasi referuar kontratës nr. ***, datë 26.12.2003, shuma e përfituar për shitjen e apartamentit nga nëna e subjektit është 500,000 lekë dhe njëkohësisht depozitimi i shumës 1,500,000 lekë në këtë bankë është kryer në datën 7.10.2003, moment i cili është para lidhjes së kontratës së shitjes.

Hetimi⁷/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

⁶ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) nxjerrje llogarie datë 20.10.2016, lëshuar nga banka “Societe Generale Albania”; (ii) nxjerrje llogarie datë 9.1.2017, lëshuar nga “Raiffeisen Bank”; (iii) dokument për delegim, datë 23.8.2004, lëshuar nga Banka Italo-Shqiptare; (iv) deklaratë noteriale nr. *** rep., datë 16.3.2005; (v) mandat tërheqje datë 8.1.2009 (fotokopjuar i paqartë), lëshuar nga ISP Bank, kopje karte ID të shtetasit I.B; (vi) nxjerrje të llogarive bankare të lëshuara nga Banka Italo-Shqiptare, e regjistruar në emër të shtetasve I dhe M.B; (vii) vendim nr. ***, datë 21.4.2010, për miratimin e dëmshpërblimit financiar për ish të dënuarit politikë të regjimit komunist; (viii) vendim nr. **, datë 15.12.1997, lëshuar nga Gjykata Popullore e Rrethit Mirditë; (ix) kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 11.11.2016, lëshuar nga ISSH, me objekt “kërkesë e I.B për rishikimin e pensionit”; (x) kthim përgjigjeje nr. ** prot., datë 5.1.2017, lëshuar nga Zyra e Përmbarimit Tiranë; (xi) vendim nr. ***, datë 8.8.1994, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; (xii) vendim nr. ***, datë 8.10.1993, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; (xiii) vendim nr. ***, datë 6.10.1994, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me paditëse M.B dhe të paditur Ndërmarrjen e Minerës së Bakrit Rubik; (xiv) kontratë shitjeje nr. ***, datë 29.1.2002, me palë shitëse I.K dhe palës blerëse M.B; (xv) kontratë shitjeje nr. ***, datë 26.12.2003, me palë shitëse M.B dhe palës blerëse F.K.

⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 18.9.2020, drejtuar bankave të nivelit të dytë; shkresë kthim përgjigjeje nr.***/tbo- ** prot., datë 1.10.2020, e “Intesa Sanpaolo Bank”.

25. Nga nxjerrja e llogarisë së subjektit të rivlerësimit në “Societe Generale Albania” rezulton se në datën 29.7.2009 ajo ka çelur depozitën me afat, me vlerë 30,000 euro, e cila në vijimësi ka krijuar përfitime nga interesat bankare. Balanca e kësaj depozite në datën 31.12.2016 rezulton në vlerën 34,811.31 euro. Në këtë llogari vihet re se në datën 29.7.2009 janë depozituar shumat:

- 15,400 euro nga bashkëshorti i subjektit me përshkrimin “të ardhura nga tërheqja nga llogaria bankare në ‘Intesa Sanpaolo Bank’”;
- 14,600 euro nga subjekti i rivlerësimit, me përshkrimin “derdhje *cash* me të ardhura nga tërheqja në “Intesa Sanpaolo Bank” dhe Banka Popullore më parë.

26. Në lidhje me këtë depozitë, subjekti, në DPV/2009, ka deklaruar: “Në janar 2009 kam mbyllur depozitën në Bankën Popullore. Kam tërhequr shumën 705,547.21 lekë.

Në janar 2009 kam mbyllur depozitën në ‘Intesa Sanpaolo Bank’. Kam tërhequr shumën 2,926,125.9 lekë.

Në korrik 2009 kam depozituar në Bankën Popullore shumën 30,000 euro, të dyja shumat e mësipërme të tërhequra dhe të ardhurat nga interesat bankarë”.

27. Nga nxjerrja e llogarisë së subjektit të rivlerësimit në “Intesa Sanpaolo Bank” rezulton se subjekti ka kryer tërheqjet e mëposhtme:

- Në datën 13.1.2009 subjekti ka tërhequr nga llogaria e saj me nr.***, çelur në Bankën Popullore, shumën 705,500 lekë, nën komentin “tërheqje *cash* nga Fahrije Stringa”.
- Në datën 8.1.2009 subjekti ka tërhequr nga llogaria e prindërve të saj M dhe I.B shumën 2,926,125.94 lekë, nën komentin “*cash withdraw Fahrije Budo për interesat e mia më të mira*” .

28. Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj depozite, bazuar në deklarin e subjektit në deklaratën *Vetting*, si dhe në deklaratat periodike, ku subjekti ka cilësuar edhe burimet e kësaj depozite, Komisioni ka analizuar burimet si vijon:

a) Shuma 351,706 lekë, e depozituar nga subjekti në Bankën e Kursimeve Tiranë në datën 24.9.1999, dhuruar nga motra e subjektit, znj. L.B, e martuar në Itali që prej vitit 1997

29. “Raiffeisen Bank”⁸, e cila ka trashëguar Bankën e Kursimeve, ka vënë në dispozicion kartelën e depozitës nr. ***, me afat 12-mujor, çelur në datën 24.9.1999, që subjekti i rivlerësimit ka pasur pranë Bankës së Kursimeve. Në këtë kartelë pasqyrohen të gjitha lëvizjet e depozitës së kursimit që nga data e çeljes dhe deri në mbylljen e saj. Komisioni evidentoi në këtë kartelë, ndër të tjera, edhe depozitimin e shumës 351,706 lekë në datën 24.9.1999. Teprica e depozitës në datën 30.6.2005 rezulton të jetë në shumën 528,640 lekë.

30. Nga nxjerrja e llogarisë bankare të subjektit në “Raiffeisen Bank” rezulton se teprica e fondeve të transferuara nga Banka e Kursimeve janë mbyllur në depozitë, e cila pas maturimit të saj është tërhequr nga subjekti në datën 10.11.2005, nën komentin “*cash withdraw*, sa mbyll depozitë me afat Fahrije Budo”, në vlerën 528,570 lekë. Në datën 13.1.2006 subjekti ka kryer depozitimin e shumës 600,000 lekë në Bankën Popullore. Në janar të vitit 2009 depozita në

⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 13.10.2022, drejtuar “Raiffeisen Bank”; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 28.10.2022, e “Raiffeisen Bank”.

Bankën Popullore ka akumuluar interesat përkatëse, duke arritur vlerën 705,547.21 lekë, tërhequr nga subjekti.

31. Subjekti, në DPV/2003, në lidhje me këtë depozitë, ka deklaruar: *“Depozitë në lekë në datën 24.9.1999, nr. karteletë ***, në emër të Fahrije Budos, me burim dhuratë nga motra L. B, e cila është martuar dhe banon në Itali që prej vitit 1997”*.

32. Komisioni i ka kërkuar subjektit të depozitë dokumentacion provues për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të shtetas L.B. Në përgjigje të pyetësorit datë 19.10.2022, subjekti⁹ ka shpjeguar: *“Motra ime L.B ka ndërruar jetë më 20.5.2015, për këtë arsye e kam të pamundur të gjej dokumentacion për të ardhurat e saj. Motra e dërgoi këtë shumë për ta pasur si depozitë për marrjen e vizës në ambasadë, pasi ishte kusht për marrjen e saj. Duke qenë se ka pasur kushte shumë të mira ekonomike, e martuar me shtetas italian në datën 24.11.1997, pasi ne përfunduar procedurat e marrjes së vizës, motra më sugjeroi t’i mbaja në llogari pasi ne do na duhej të hynim shpesh në ambasadë për vizë. Kjo shumë është lënë në llogari”*.

33. Pavarësisht këtij shpjegimi të subjektit, në përfundim të hetimit, Komisioni vlerësoi t’i kalojë subjektit të rivlerësimit barrën e provës, duke mos e përfshirë në analizë financiare shumën 351,706 lekë, të deklaruar nga subjekti, si të përfutur si dhuratë nga motra e saj L.B.

34. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti pretendoi se kjo shumë ka qenë e depozituar pranë Bankës së Kursimeve që në datën 24.8.1999, përpara emërimit të saj në detyrë dhe përpara se të ishte subjekt i deklarimit sipas ligjit. Motra e dërgoi këtë shumë për ta pasur si depozitë garancie për marrjen e vizës në ambasadë, pasi ishte kusht për marrjen e saj. Duke qenë se ka pasur kushte shumë të mira ekonomike, e martuar me shtetas italian në datën 24.11.1997, pasi ata përfunduan procedurat e marrjes së vizës, motra i sugjeroi t’i mbante në llogari, pasi do i duhej të hynin shpesh në ambasadë për vizë. Kjo shumë është lënë në llogari dhe nuk është përdorur nga familjes e subjektit. Subjekti parashtrroi gjithashtu se këtë shumë e ka deklaruar saktësisht edhe në deklaratën e parë të pasurisë në DPV/2003.

35. Komisioni analizoi shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti gjatë procesit të rivlerësimit, nga të cilat rezultoi se: (i) kjo shumë është deklaruar si burim për krijimin e depozitës në deklaratën përpara fillimit të detyrës në vitin 2003; (ii) kjo shumë është krijuar para fillimit të detyrës së subjektit; (iii) kjo shumë ka qëndruar në bankë edhe në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting* dhe nuk është përdorur për krijimin e ndonjë pasurie të subjektit; (iv) subjekti ka bërë të gjitha përpjekjet për të siguruar informacionin lidhur me të ardhurat e motrës saj, duke paraqitur llogaritë bankare, informacion mbi pasuritë e paluajtshme

⁹ Subjekti i ka bashkëlidhur përgjigjes së saj dokumentacionin: (i) certifikatë martesë datë 14.8.1998, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Tiranë, sipas së cilës vërtetohet se në aktet e martesës të vitit 1997 znj. L.B ka lidhur martesë me shtetasin B.D; (ii) kartë identiteti lëshuar nga shteti italian për znj. L.B, si dhe kartën e siguracionit të kësaj shtetaseje, datë 30.10.2007; (iii) garanci e lëshuar nga shtetasi B.D në datën 8.7.2002, në përmbajtje të së cilës ky shtetas deklaroi se është i gatshëm të akomodojë në banesën e tij prej 130 m² shtetasin R.S. Ai deklaroi se të ardhurat e tij mesatare vjetore janë në vlerën 38,000,000 lit; (iv) garanci e lëshuar nga shtetasi B.D, në datën 28.10.2002, në përmbajtje të së cilës ky shtetas deklaroi se është i gatshëm të akomodojë në banesën e tij prej 130 m² shtetasin I.B. Ai deklaroi se të ardhurat e tij mesatare vjetore janë në vlerën 18,000 euro; (v) nxjerrje llogarie datë 3.7.2002 nga banka italiane “Antoniana Popolare Veneta”, me gjendje 32,000 euro dhe 17,000 euro; (vi) dokument nga agjencia e pronave të shtetit italian, ku evidentohet se në pronësi të shtetasit B.D janë regjistruar 5 pasuri të paluajtshme; (vii) leje qëndrimi në shtetin italian për shtetasin I.B, lëshuar nga Ministria e Brendshme e Italisë në datën 19.2.2003; (viii) leje qëndrimi në shtetin italian për shtetasin M.B, lëshuar nga Ministria e Brendshme e Italisë në datën 19.2.2003.

në pronësi të bashkëshortit të motrës, si dhe garancitë e lëshuara nga bashkëshorti i saj. Nga llogaritë bankare konstatohet se bashkëshorti i motrës së saj ka të ardhura të konsiderueshme, fakt ky që vërtetohet edhe me deklaratimet e tij në deklaratat e garancisë, të cilat përbëjnë provë të plotë, pasi ato janë përdorur nga prindërit e subjektit pranë Ambasadës Italiane për të përfituar vizë dhe më tej lejen e qëndrimit; (v) subjekti i ka deklaruar si burim këto të ardhura në DPV/2003.

36. Në përfundim, Komisioni, duke marrë në konsideratë faktet e sipërcituara, përpjekjet e subjektit të rivlerësimit për të dhënë sa më shumë informacione të mundshme për Komisionin, megjithëse në kushtet e një pamundësie objektive, dhe bindjes së brendshme se kjo pasuri nuk ka shërbyer për krijimin e një pasurie tjetër të paluajtshme apo të luajtshme, e cila mund të krijonte dyshime për një nga situata e parashikuara në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, për një vlerësim proporcional, objektiv dhe të drejtë, vlerëson të përfshijë në analizë financiare shumën 351,706 lekë.

b) Llogari bankare e prindërve të subjektit I dhe M.B. Këtë depozitë subjekti deklaron se e ka tërhequr më 8.1.2009 pranë “Intesa Sanpaolo Bank”, së bashku me interesat në shumën 2,926,125.75 lekë.

37. Nga hetimi i kryer nga Komisioni në lidhje me këtë depozitë, ka rezultuar se:

i. Në datën 11.11.1999 babai i subjektit, z. I.B, ka çelur në BIA Bank depozitën nr. ***, në vlerën 217,500 lekë.

Në këtë depozitë është shtuar shuma 500,000 lekë, depozituar *cash* nga shtetasi I.B në datën 10.5.2002 dhe pas maturimit të saj dhe përfitimit të interesave gjendja në datën 7.10.2003 ka qenë 830,918.85 lekë. Në këtë datë kjo shumë është transferuar në llogarinë dyemërore të shtetasve I dhe M.B.

ii. Në datën 11.11.1999 nëna e subjektit, znj. M.B, ka çelur në BIA Bank depozitën nr. ***, në vlerën 250,000 lekë.

Në këtë depozitë është shtuar shuma 200,000 lekë, depozituar *cash* në datën 11.2.2002 dhe pas maturimit të saj dhe përfitimit të interesave gjendja në datën 10.5.2002 të jetë 497,425.17 lekë. Në këtë datë kjo shumë është transferuar në llogarinë dyemërore të shtetasve I dhe M.B.

iii. Në datën 3.10.2000 prindërit e subjektit I dhe M.B kanë çelur në BIA Bank depozitën dyemërore nr. ***, në vlerën 350,000 lekë.

Në këtë llogari, përveç shumave shtesë të transferuara nga llogaria individuale e shtetasit I. B në shumën 830,918.85 lekë dhe nga llogaria individuale e shtetasit M.B në shumën 497,425.17 lekë, në datën 7.10.2003 është shtuar vlera 1,500,000 lekë “depozitim *cash*”. Në datën 7.4.2004 shtetasi I.B tërheq nga kjo llogari shumën 1,000,000 lekë.

Teprica në shumën 2,448,936.35 lekë ka përfituar interesa dhe në datën 8.1.2009 subjekti ka tërhequr nga llogaria e prindërve të saj M dhe I.B shumën 2,926,125.94 lekë, nën komentimin “*cash withdrawal* F.B për interesat e mia më të mira”.

38. Për të vërtetuar të ardhurat e ligjshme të prindërve të saj, të cilat kanë shërbyer si burim për krijimin e kësaj depozite, si dhe veprimet bankare të kryera prej tyre në këtë depozitë, gjatë hetimit subjekti ka paraqitur një numër të konsiderueshëm dokumentesh¹⁰.

39. Komisioni ka analizuar aftësinë financiare të prindërve të subjektit për krijimin e depozitës bankare në BIA Bank (aktualisht “Intesa Sanpaolo Bank Albania”) në datën 11.11.1999, dhe në vijim, duke iu referuar burimeve financiare të deklaruara nga subjekti në deklaratën *Vetting*:

i. Dëshmperblimet e përfituara nga prindërit e subjektit si të përndjekur politikë

40. Referuar VKM-së Nr. ***, datë 21.4.2010, rezulton se shtetasi I.B ka kryer dënimin për periudhën 5 vjet, 4 muaj e 21 ditë dhe përfiton dëshmperblim në shumën 3,970,000 lekë (vlera 3,322,658 lekë deduktohet të jetë vlera e papërfitur, pasi janë zbritur shumat 100,000 lekë dhe 547,342 lekë). Bazuar në përmbajtjen e VKM-së, shuma e dëshmperblimit do të transferohet nga një llogari speciale në Bankën e Shqipërisë në një llogari personale të përfituesit në një nga bankat e nivelit të dytë. Referuar *statement*-it bankar të vënë në dispozicion nga BKT Bank¹¹ rezulton se në periudhën gusht 2010 – shtator 2017 në llogarinë bankare të shtetasit I.B në këtë

¹⁰ (i) Dokument për delegim datë 23.8.2004, i lëshuar nga Banka Italo-Shqiptare, si dhe deklaratë noteriale nr. *** rep., datë 16.3.2005, përmes së cilës prindërit e subjektit I dhe M.B konfirmojnë se në bankën Italo-Shqiptare kanë depozituar shumën 2,477,890 lekë, e cila përfaqëson të ardhurat e realizuara në vazhdimësi gjatë jetës së tyre dhe për efekt moshe kërkojnë që në këtë llogari të përshihet edhe vajza e tyre F.S(B), e cila përkujdeset për plotësimin e nevojave të tyre; (ii) mandat tërheqjeje datë 8.1.2009, i lëshuar nga “Intesa Sanpaolo Bank”, ku konfirmohet se në këtë datë subjekti i rivlerësimi ka tërhequr shumën 2,926,125 lekë; (iii) nxjerrje llogarie e lëshuar nga Banka Italo-Shqiptare, e regjistruar në emër të shtetasve I dhe M.B për periudhën 31.12.1999 – 1.1.2008, nga ku rezulton se në datën 1.1.2008 kjo llogari ka pasur balancë në shumën 2,792,551 lekë; (iv) nxjerrje llogarie e lëshuar nga Banka Italo-Shqiptare, e regjistruar në emër të shtetasve I dhe M.B për periudhën 31.12.1999 – 20.4.2004; (v) Vendim Nr. ***, datë 21.4.2010, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e dëshmperblimit financiar për ish të dënuarit politikë të regjimit komunist”, bashkëngjitur të cilit gjendet lista e përfituesve, ku rezulton se shtetasi I.B ka kryer dënimin për periudhën 5 vjet, 4 muaj e 21 ditë dhe përfiton dëshmperblim në shumën 3,970,000 lekë (vlera 3,322,658 lekë deduktohet të jetë vlera e pa përfitur, pasi janë zbritur shumat 100,000 lekë dhe 547,342 lekë); (vi) shkresë nr. *** prot., datë 1.10.2022, e “Raiffeisen Bank”, përmes së cilës kjo bankë informon subjektin se i ndjeri I.B ka përfitur dëshmperblim në të holla në shumën 100,000 lekë, si dhe letra me vlerë privatizimi në shumën 547,342 lekë. Lidhur me përfitimin e dëshmperblimit në të holla në datën 9.12.1994 është kryer pagesa e shumës prej 50,000 lekësh dhe në datën 14.8.1995 është kryer pagesa e shumës prej 50,000 lekësh; (vii) vendim nr. **, datë 15.12.1997, lëshuar nga Gjykata Popullore e Rrethit Mirditë, ku i pandehuri I.B është akuzuar dhe dënuar për agjitacion e propagandë dhe rezulton të jetë dënuar me 10 vjet burgim; (viii) kthim përgjigjeje nr. ***prot., datë 11.11.2016, e lëshuar nga ISSH-ja, ku analizohet praktika e dosjes së përfitimit të pensionit të pleqërisë të shtetasit I.B; (ix) vendim nr. ***, datë 8.8.1994, i lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me palë paditëse I.B dhe palë të paditur Ndërmarrjen e Minierës së Bakrit Rubik, ku rezulton se është vendosur me formë të prerë që kjo ndërmarrje duhet t’i paguajë paditësit shumën 242,782 lekë; (x) vendim nr. ***, datë 8.10.1993, i lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë (i formës së prerë), me palë paditëse I.B dhe palë të paditur ISSH-në, ku rezulton se është vendosur detyrimi i palës së paditur t’i paguajë paditësit diferencat e mbajtura padrejtësisht nga pensioni prej 25% e 30%; (xi) vendim nr. ***, datë 6.10.1994, i lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë (i formës së prerë), me palë paditëse shtetasen M.B dhe palë të paditur Ndërmarrjen e Minierës së Bakrit Rubik, ku rezulton se është vendosur që kjo ndërmarrje duhet t’i paguajë paditëses shumën 152,929 lekë; (xii) kthim përgjigjeje nr. ** prot., datë 5.1.2017, e lëshuar nga Zyra e Përmbarimit Tiranë, me objekt “kërkesa e shtetas Fahrije Stringa (Budo) për informacion në lidhje me vendimet e përmbarimit gjatë periudhës 1993 – 1994”, ku konfirmohet se në arkivë disponohen vendimet nga viti 1996 e në vazhdim dhe, si rrjedhojë, nuk mund të ofrohet informacioni i kërkuar; (xiii) kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 29.1.2002, e lidhur midis palës shitëse I.K dhe palës blerëse M.B, me objekt “shitja e pasurisë apartament banimi me sip. 50.27 m²”, i ndodhur në z. k. ***, Durrës, në shumën 100,000 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale; (xiv) kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 26.12.2003, e lidhur midis palës shitëse M.B dhe palës blerëse F.K, me objekt “shitja e pasurisë apartament banimi me sip. 50.27 m²”, i ndodhur në z. k. ***, Durrës, në shumën 500,000 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale.

¹¹ Shkresë nr. *** prot., datë 18.9.2020, drejtuar bankave të nivelit të dytë; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 5.10.2020, e BKT-së.

bankë është kredituar në total vlera 3,322,658 lekë, e cila përputhet me vlerën e dëmshpërblimit të miratuar sipas VKM-së Nr. ***, datë 21.4.2010. Këto vlera rezultojnë të jenë përfituar nga babai i subjektit të rivlerësimit pas periudhës 1999 – 2004, gjatë së cilës janë kryer depozitimet në depozitën në “Intesa Sanpaolo Bank”, për rrjedhojë, nuk mund të kenë shërbyer për krijimin e kësaj depozite.

Referuar konfirmimit të “Raiffeisen Bank”, shtetasi I.B ka përfituar dëmshpërblim në të holla në shumën 100,000 lekë, si dhe letra me vlerë privatizimi në shumën 547,342 lekë. Lidhur me përfitimin e dëmshpërblimit në të holla, në datën 9.12.1994 është kryer pagesa e shumës prej 50,000 lekësh dhe në datën 14.8.1995 është kryer pagesa e shumës prej 50,000 lekësh. Vlera prej 100,000 lekësh është përfshirë në analizën financiare për mundësinë e prindërve të subjektit për krijimin e depozitës bankare.

ii. Letra me vlerë

41. Në pyetësin e datës 19.10.2022, Komisioni i ka kërkuar subjektit paraqitjen e dokumentacionit provues për konvertimin e letrave me vlerë në monedhën lekë. Në përgjigje të këtij pyetësi, subjekti ka sqaruar se *letrat me vlerë janë përfituar nga babai i saj bazuar në VKM-në Nr.184, datë 4.5.1994, për kompensimin pasuror të ish të dënuarve politikë nga sistemi komunist. Në familje dihet që babai i ka konvertuar me vlerë të plotë, shumë vite më parë tek një person që ka marrë pjesë në privatizimin e një prone shtetërore. Nuk disponohen prova konkrete, por nisur nga faktet e vuajtjeve të mëdha që ka kaluar ai dhe familja për 35 vite, këto letra me vlerë nuk do t'i kishte dhënë kurrë me vlerë më të ulët se 1:1.*

42. Në kushtet kur subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion provues lidhur me konvertimin e letrave me vlerë në monedhën lekë, Komisioni nuk ka mundur të evidentojë dhe të përfshijë në analizë financiare të ardhurat e përfituara nga babai i subjektit nga këmbimi i tyre, duke i kaluar barrën e provës për të depozituar dokumentacion provues për përfitimin e shumës 547,342 lekë nga konvertimi i letrave me vlerë të babait të saj.

43. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti pretendoi se letrat me vlerë janë përfituar nga babai i saj bazuar në Vendimin Nr. 184, datë 4.5.1994, të Këshillit të Ministrave, për kompensimin pasuror të ish të dënuarve politikë nga sistemi komunist. Ndër të tjera, në këtë vendim saktësohet se: *“Kompensimi pasuror... do të bëhet kryesisht me letra me vlerë...”* (pika 1); *“ish të dënuarit dhe të përndjekurit politikë që kanë përfituar të drejtën e kompensimit pasuror sipas ligjit ‘Për statusin ...’, në zbatim të neneve 7 dhe 9, përfitojnë në formën e letrave me vlerë një kompensim vjetor prej 120,000 lekësh”* (pika 2); *“...ata kanë të drejtë të marrin pjesë pa ankand në procesin e privatizimit të pronës shtetërore”*; *“...kanë të drejtë t'i shesin, disponojnë ose këmbejnë në të gjitha format që përcakton ligji letrat me vlerë etj.”*

Subjekti i rivlerësimit deklaroi: *“Babai i ka tjetërsuar me vlerë të plotë shumë vite më parë tek një person që ka marrë pjesë në privatizimin e një prone shtetërore. Për shkak të kohës së gjatë të kaluar, unë nuk arrij të disponoj prova konkrete, por di të them me siguri të plotë që këto të ardhura që babai im i ka dhënë me një vlerë reale 1:1, i ka dhënë për pjesëmarrjen e një personi në privatizimin e një prone shtetërore. Unë nuk arrij të disponoj prova konkrete, por nisur nga faktet e vuajtjeve të mëdha që ka kaluar ai dhe familja për 35 vite, këto letra me vlerë nuk do t'i kishte dhënë kurrë me vlerë më të ulët se 1:1”*.

Në lidhje me këtë shumë, në kushtet kur ndodhet në pamundësi objektive, pasi konvertimi i letrës me vlerë nuk gjendet për shkak të periudhës së gjatë që ka kaluar dhe të faktit që kjo letër me vlerë nuk i përkiste subjektit por babait të saj, subjekti i rivlerësimit kërkon që të aplikohet neni 32/2 i ligjit nr. 84/2016.

44. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se në kushtet kur ka kaluar një kohë e gjatë, babai i saj nuk është gjallë, duke e vendosur subjektin në mënyrë të arsyeshme në kushtet e një pamundësie objektive për të evidentuar saktësisht personin dhe shoqërinë për të cilën janë përdorur këto letra me vlerë nga njëra anë, si dhe duke marrë në konsideratë parashikimet e VKM-së Nr. 184/1994, e cila i jepte përparësi letrave me vlerë të të përndjekurve politikë në raport me letrat me vlerë të shpërndara gjatë kësaj periudhe tek qytetarët e tjerë nga ana e qeverisë, si dhe faktin që babai i subjektit i ka pasur në pronësi këto letra, nga ana tjetër, pranon shpjegimet e subjektit të rivlerësimit.

Në këtë vlerësim, Komisioni mban në vëmendje se ato nuk kanë ndikim në analizën financiare të prindërve të subjektit për krijimin e kësaj depozite, edhe sikur të mos përfshihen.

iii. Vendime gjyqësore

45. Referuar vendimit gjyqësor nr. ***, datë 8.8.1994, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me palë paditëse I.B dhe palë të paditur Ndërmarrjen e Minierës së Bakrit Rubik, rezulton se kjo ndërmarrje duhet t'i paguajë paditësit shumën 242,782 lekë. Referuar shënimit të sekretarisë vendimi ka marrë formë të prerë.

46. Referuar vendimit gjyqësor nr. ***, datë 6.10.1994, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me palë paditëse M.B dhe palë të paditur Ndërmarrjen e Minierës së Bakrit Rubik, rezulton se kjo ndërmarrje duhet t'i paguajë paditëses shumën 152,929 lekë. Referuar shënimit të sekretarisë vendimi ka marrë formë të prerë.

47. Vlerat e përfituara nga prindërit e subjektit nga ekzekutimi i këtyre vendimeve duket se përputhen me vlerat e depozitave të çelura prej tyre në BIA Bank dhe janë përfshirë në analizën financiare për mundësinë e prindërve të subjektit për krijimin e depozitës bankare.

iv. Shitja e pasurisë së paluajtshme nga nëna e subjektit, znj. M.B, në datën 26.12.2003, në vlerën 1.500,000 lekë

48. Nga dokumentacioni i administruar nga ASHK Durrës¹² rezulton se me kontratën e shitblerjes nr. **, datë 29.1.2003, shtetasja M.B ka blerë nga shitësja I.K pasurinë apartament me sip. 50.27 m², ndodhur në z. k. ***, lagjja "V i S", Durrës, për çmimin 100,000 lekë. Në vijim, me kontratën e shitjes nr. ***, datë 26.12.2003, shtetasja M. B e ka shitur këtë pasuri në favor të blerësit F.K, për çmimin 500,000 lekë. Referuar përmbajtjes së kontratës kjo vlerë është likuiduar plotësisht jashtë zyrës noteriale.

49. E pyetur në lidhje me mospërputhjen e konstatuar në çmimin e shitjes së apartamentit, në përgjigje të pyetësorit datë 19.10.2022, subjekti ka deklaruar: *"Kam deklaruar vlerën reale të shitjes së pasurisë. Nga dokumentacioni bankar rezulton që babai ka depozituar në bankë në datën 7.10.2003 shumën 1,500,000 lekë. Në kontratën e shitjes është specifikuar që çmimi i shitjes është likuiduar plotësisht jashtë zyrës noteriale dhe pala shitëse ka deklaruar se ka*

¹² Shkresë nr. *** prot., datë 18.9.2020, drejtuar ASHK Durrës; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 7.10.2020, e ASHK Durrës.

marrë të hollat në dorëzim. Me kontratën e shitjes jam njohur vetëm në vitin 2016, kur kam përgatitur dokumentacionin për Vetting. Veprimet janë kryer prej nënës time si pronare pasurie. Në kohën kur unë u vura në dijeni nëna kishte ndërruar jetë”.

50. Komisioni ka marrë në konsideratë në analizë shumën e shitjes të përcaktuar në kontratë prej 500,000 lekësh, për të cilën janë paguar edhe detyrimet tatimore. Nga hetimi i Komisionit nuk provohet që ky apartament të jetë shitur në shumën 1,500,000 lekë, pasi edhe depozitimi i kryer nga babai i subjektit në datën 7.10.2003 është kryer 2 muaj përpara nënshkrimit të kontratës së shitjes dhe për më tepër *cash*. Gjithashtu, nuk provohet që nga ana e prindërve të subjektit të jenë paguar detyrimet tatimore për këtë shumë. Në përfundim, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit, pasi:

- Kishte mospërputhje në lidhje me deklarin e subjektit në deklaratën *Vetting* se apartamentit është shitur në vlerën 1,500,000 lekë dhe kontratës së shitjes së këtij apartamenti.
- Nuk provohej që ky apartament të jetë shitur në shumën 1,500,000 lekë.
- Nuk provohej pagesa e detyrimeve tatimore për shumën 1,500,000 lekë.
- Për rrjedhojë, në analizë financiare u përfshi vetëm shuma 500,000 lekë.

51. Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, pretendoi se nëpërmjet kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 26.12.2003, nëna e saj e ka shitur këtë pasuri në favor të blerësit F.K, në shumën 1,500,000 lekë. Në deklaratën *Vetting* ajo ka deklaruar vlerën reale të shitjes së pasurisë, të cilën e ka ditur gjithmonë se ka qenë 1,500,000 lekë, sikundër rezulton edhe nga dokumentacioni bankar ku babai i saj ka depozituar në datën 7.10.2003 shumën 1,500,000 lekë. Në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate, sikundër rezulton edhe nga përmbajtja e aktit noterial, çmimi i shitjes është likuiduar plotësisht jashtë zyrës noteriale dhe pala shitëse ka deklaruar se ka marrë të hollat në dorëzim përpara nënshkrimit të saj.

Veprimet juridike për tjetërsimin e kësaj prone janë kryer prej nënës së saj si pronare pasurie. Në kohën kur ajo u vu në dijeni, nëna e saj fatkeqësisht kishte ndërruar jetë, ndaj dhe e ka të pamundur të marrë sqarime prej saj se përse është vendosur kjo shumë në kontratë. Gjithashtu, kjo pasuri është blerë nga nëna e saj në një kohë kur ajo ka qenë e shkëputur nga trangu familjar dhe nuk ka pasur as dijeni për veprimet juridike që nëna kryente për tjetërsimin e pasurive të saj dhe të babait. Kjo shumë ka qenë e depozituar në bankë dhe ka shërbyer për krijimin e depozitës në emër të prindërve të saj. Për sa i përket çmimit të pasurisë së paluajtshme, referuar udhëzimit nr. 1, datë 8.5.2003, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB të vlerave mesatare të tregut të lirë të banesave dhe të koeficientit ‘K’ datë...”, vlera mesatare e apartamenteve tip, tregu i lirë, për qytetin e Durrësit është 51,724 lekë për metër katror dhe në tërësi për sipërfaqen 50.27 m², çmimi sipas këtij udhëzimi do të ishte 2,600,165.48 lekë, pra, kurrësi nuk mund të kishte vlerë reale shumën prej 500,000 lekësh të përcaktuar në këtë kontratë, pasi nëna e saj e ka tjetërsuar këtë pasuri në një vlerë edhe më të ulët se vlera 2,600,165.48 që rezulton nga përlllogaritja e këtij çmimi referuar udhëzimit nr. 1/2003.

Përveç sa më lart, subjekti deklaron se nuk ka qenë në trangu familjar të familjes, pasi në atë kohë ka qenë e martuar dhe ka jetuar me bashkëshortin dhe nënën e saj, ndaj këto rrethana (duke pasur parasysh që kjo është një situatë të cilën nuk mund ta riparojë dot sot, pasi nëna e

saj ka ndërruar jetë) duhet të konsiderohen nga ana e Komisionit në raport me detyrimet e saj si subjekt deklarimi, përballë mospagimit të këtij tatimi nga nëna për diferencën e konstatuar nga Komisioni.

52. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit dhe pretendimet e saj, konstaton se:

- i. Vlera e një apartamenti në qytetin e Durrësit në tregun e lirë të apartamenteve në vitin 2003 ka qenë në 51,724 lekë/m². Në këto kushte, vlera sipas tregut të lirë për këtë apartament është në 2,600,000 lekë.
- ii. Babai i subjektit ka depozituar *cash* shumën 1,500,000 lekë në datën 7.10.2003.
- iii. Subjekti ka pranuar që në kontratën e shitjes është vendosur një çmim i ndryshëm nga ai i përfituar realisht nga prindërit e saj.
- iv. Subjekti nuk ka qenë pjesë e trungut familjar të prindërve të saj.
- v. Subjekti nuk e ka përdorur shumën 1,500,000 lekë për krijimin e ndonjë pasurie të saj. Kjo shumë vijon të jetë edhe sot në depozitë bankare.
- vi. Nëna e subjektit ka ndërruar jetë dhe është e pamundur që nga ana e saj të jepen shpjegime apo të paguhet vlera e mbetur e detyrimeve tatimore.

Në vlerësim të fakteve dhe rrethanave të mësipërme, duke vlerësuar se këto veprime nuk janë kryer nga subjekti rivlerësimit, e cila ka qenë përfituese nëpërmjet dhurimit të shumave financiare, të cilat rezultojnë me burime të ligjshme, nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi ligjore. Po ashtu, në këtë vlerësim, trupi gjykues ka mbajtur në konsideratë faktin se këto të ardhura (kjo pasuri) nuk ka shërbyer për krijimin e ndonjë pasurie të paluajtshme apo mbulimin e shpenzimeve, të cilat mund ta vendosnin subjektin në një nga kushtet e nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

v. Pension pleqërie

53. Komisioni ka administruar:

- shkresën nr. *** prot., datë 11.11.2016, lëshuar nga ISSH-ja, ku analizohet praktika e dosjes së përfitimit të pensionit të pleqërisë të shtetasit I.B;
- shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 28.9.2022, lëshuar nga ISSH-ja, nëpërmjet së cilës informohet mbi masën e përfitimit të pensionit të pleqërisë të shtetases M.B.

Të ardhurat e evidentuara nga pensioni i përfituar nga prindërit e subjektit të rivlerësimit janë përfshirë në analizën financiare për periudhën 1992 – 23.8.2004 në vlerën totale 1,226,012 lekë.

vi. Në lidhje me të ardhurat e motrës së subjektit, znj. L.B

54. Subjektit gjatë hetimit i është kërkuar që të specifikojë shumën e kontributit të shtetases L.B, që ka shërbyer për krijimin e depozitës së prindërve, si dhe burimin e ligjshëm të të ardhurave të saj. Nga ana e subjektit, në përgjigje të pyetësorit të datës 19.10.2022, është sqaruar se ajo e ka të pamundur për të specifikuar shumën e dhuruar nga motra, për sa kohë as prindërit dhe as e motra nuk jetojnë më.

55. Në kushtet kur nga ana e subjektit: (a) nuk është depozituar dokumentacion provues për burimin e ligjshëm të të ardhurave të shtetases L.B; (b) nuk është provuar shuma e saktë e dhuruar që ka shërbyer për krijimin e depozitave të prindërve të saj – Komisioni nuk ka

përfshirë në analizë financiare kontributin e shtetas L.B, duke i kaluar subjektit barrën e provës.

56. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti deklaroi se ky kontribut ka qenë në shuma të vogla dhe e ka të pamundur sot, me gjithë periudhën e gjatë të kaluar, duke pasur parasysh edhe që këto shuma janë dhënë si kontribut për babain dhe nënën e saj, të specifikojë vlerat e tyre.

57. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se për sa kohë që nga ana e saj nuk është specifikuar kontributi, nuk mund të përfshijë në analizë financiare të ardhurat e pretenduara si të dhuruara nga ana e motrës tek prindërit e saj.

58. Komisioni, në analizën financiare¹³ që i dërgoi subjektit së bashku me rezultatet e hetimit në lidhje me depozitën e prindërve nuk ka përfshirë:

- të ardhurat e subjektit gjatë periudhës së jetesës me prindërit, pasi nga ana e saj nuk janë pretenduar si burim;
- shpenzimet jetike për të mos rënduar pozitën e prindërve të subjektit, për sa kohë ato nuk i mbulojnë këto shpenzime me të ardhurat e deklaruara;
- të ardhurat e pretenduara si të dhëna nga motra, pasi nuk është përcaktuar shuma konkrete, si dhe nuk është vënë në dispozicion dokumentacion provues për burimin e ligjshëm të të ardhurave.

59. Nga analiza financiare duket se prindërit e subjektit nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin dhe shtimin e depozitës në “Intesa Sanpaolo Bank” në shumën -1,402,488.58 lekë, si dhe subjekti nuk provoi me dokumentacion provues burimin e ligjshëm të të ardhurave të prindërve të saj për këtë depozitë.

Në këto kushte, shuma 2,926,125.94 lekë, e tërhequr nga subjekti në vitin 2009 në llogarinë e prindërve të saj, nuk do të përfshihet në analizë financiare për krijimin e depozitës në “Societe Generale Albania” në datën 29.7.2009.

Si rrjedhojë e mospërfshirjes së kësaj shume në analizë financiare, duket se subjekti nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e kësaj depozite në shumën -1,495,244.38 lekë¹⁴. Për këtë subjektit iu kalua barra e provës.

60. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti pretendoi se për sa i përket analizës financiare për depozitat e prindërve të saj, ku ajo është thjesht në cilësinë e përfaqësueses dhe jo të titullares së krijimit të kësaj depozite, në këtë analizë të përfshihen edhe të ardhurat e saj dhe të motrës, për sa kohë ato kanë jetuar me prindërit e saj dhe ajo e ka të pamundur për të sjellë dokumentacion shtesë për të ardhurat e prindërve. Subjekti pretendoi se në analizë janë përfshirë likuiditetet e krijuara prej saj, por nuk janë përfshirë të ardhurat e dhuruara nga motra për krijimin e depozitës. Në lidhje me analizën financiare të krijimit të depozitës në vitin 2009, subjekti pretendoi se nëna e bashkëshortit ka ndërruar jetë në maj të vitit 2008 dhe pas kësaj periudhe ata kanë qenë dy persona në familje. Komisioni ka llogaritur shpenzimet e jetesës deri në vitin 2016 për 3 persona. Për periudhën 1.1.2009 – 29.7.2009 këto shpenzime sipas standardit të përdorur nga Komisioni llogariten të jenë në vlerën 159,390 lekë.

Subjekti i ka bashkëlidhur parashtrimeve të saj:

¹³ Shihni tabelën nr. 1 të rezultateve të hetimit.

¹⁴ Në lidhje me analizën financiare të kësaj depozite referohuni në tabelën nr. 2 të rezultateve të hetimit.

- kopje të librezës së punës së shtetas L.B, ku evidentohet punësimi i saj në vitet 1970 – 1997;
- vërtetim i DRSSH-së lidhur me të ardhurat e përfituara nga shtetasja L.B në vitet 1994 – 1997;
- vërtetim datë 28.4.2005, i DRSSH-së Lezhë lidhur me të ardhurat e përfituara nga shtetasja L.B në vitet 1970 – 1990;
- vërtetim datë 14.12.2004 nga Miniera e Bakrit Repts, për vjetërsinë në punë të shtetas L. B për vitet 1970 – 1990.

61. Komisioni, duke u bazuar në argumentet e mësipërme, për sa i përket të ardhurave të dhuruara nga motra, si dhe të ardhurave të përfituara nga shitja e pasurisë apartament, vendosi të kryejë një analizë të re financiare. Në këtë analizë janë përfshirë shpenzimet jetike të subjektit dhe familjarëve të saj, duke u llogaritur në vlerën 0.30% të ardhurat e subjektit, për sa kohë është përfshirë edhe depozita e krijuar nga subjektit në vitin 1999, e cila është një likuiditet ndryshe nga depozita e krijuar nga prindërit e subjektit, të ardhurat e shtetas L.B, të ardhurat e dhuruara nga kjo shtetase, si dhe të ardhurat në shumën 500,000 lekë të përfituara nga shitja e apartamentit në vitin 2003 nga prindërit e subjektit.

62. Analiza financiare

Tabela nr. 1

	Periudha 1992 – 23.8.2004
Pasuria	3,809,143.14
<i>Ndryshim likuiditeti</i>	3,809,143.14
Detyrime	0.00
Detyrime	0.00
Pasuria neto	3,809,143.14
Të ardhura	4,612,222.00
Të ardhurat e subjektit Fahrije Stringa (Budo)	1,202,125.00
Të ardhurat e babait të subjektit I.B nga pensioni	412,144.00
Të ardhurat e babait të subjektit I.B nga diferencat e pensionit, shkresa nr. *** prot., datë 11.11.2016	178,792.00
Të ardhurat e babait të subjektit I.B, dëmshpërblimet e përfituara si i përndjekur politik nga MF	100,000.00
Të ardhurat e babait të subjektit I.B, letrat me vlerë	0.00
Të ardhurat nga shitja e pasurisë apartament	500,000.00
Të ardhurat e nënës së subjektit M.B	813,868.00
Të ardhurat nga ekzekutimi i vendimit datë 8.8.1994, I.B	242,782.00
Të ardhurat nga ekzekutimi i vendimit datë 6.10.1994, M.B	152,929.00
Të ardhura nga interesat bankare	351,852.00
Të ardhurat nga motra e subjektit L.B	657,730.00
Shpenzime	1,449,583.63
Shpenzime jetike	1,449,583.63
Mundësia për kursime	-646,504.77

Nga analiza financiare rezulton se prindërit e subjektit nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e kësaj depozite. Kjo pamundësi e tyre krijohet pasi Komisioni nuk ka përfshirë në analizë financiare shumën totale të shitjes së apartamentit prej 1,500,000 lekësh, si dhe shumën e përfitur nga babai i subjektit nga shitja e letrave me vlerë. Duke mbajtur në konsideratë këtë konstatim, si dhe faktin që rezultati negativ është në një vlerë të ulët, duke vlerësuar se këto veprime nuk janë kryer nga subjekti i rivlerësimit, e cila ka qenë

përfituese nëpërmjet dhurimit të shumave financiare të cilat rezultojnë me burime të ligjshme, Komisioni vlerëson se ajo nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi ligjore.

Për rrjedhojë, shumat e tërhequra nga subjektit në këto depozita do të përfshihen në analizë financiare për krijimin e depozitës në vitin 2009 në vlerën për të cilët provohet burimi i ligjshëm në shumën 2,279,621.13 lekë. Komisioni pranoi edhe shpjegimet e subjektit në lidhje me shpenzimet e jetesës, të cilat u korrigjuan në analizën e re financiare, duke u llogaritur nga muaji maj i vitit 2008 e në vijim për dy persona.

63. Analiza financiare për krijimin e depozitës në vitin 2009

Tabela nr. 2

	Datë 29.7.2009
Pasuria	2,572,284.54
<i>Ndryshim likuiditeti</i>	<i>2,572,284.54</i>
Detyrime	0
Pasuria neto	2,572,284.54
Të ardhura	3,675,398.62
Të ardhurat e subjektit Fahrije Stringa (Budo)	574,340.08
Të ardhurat nga qiratë	275,314.41
Të ardhurat e bashkëshortit R.S	0
Të ardhurat e nënës së bashkëshortit G.S	0
Të ardhurat nga interesat e depozitave	546,123.00
Të ardhurat nga depozitat e prindërve	2,279,621.13
Shpenzime	239,042.40
Shpenzime jetike	159,390.00
TIMS	79,652.40
Mundësia për kursime	864,071.68

64. Nga analiza financiare rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e kësaj depozite. Në përfundim në lidhje me këtë depozitë, subjekti ka kryer deklaram të saktë dhe ka të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e saj.

65. Depozitë me afat në “Raiffeisen Bank”¹⁵, krijuar në datën 27.3.2015, në shumën 16,000 USD, me gjendje sot në vlerën 16,034 USD, datë 18.10.2016, në emër të bashkëshortit të subjektit, z. R.S. Subjekti ka deklaruar: *“Në këtë depozitë, me dëshirën e tij, më ka përfshirë edhe mua si bashkëshorten e tij. Bashkëpronësi e pandarë”.*

Burimi i krijimit sipas deklaratës Vetting: *“Kjo shumë është kthimi i huas në datën 27.3.2015 nga huamarrësit. Në janar 2014 unë dhe bashkëshorti im kemi dhënë hua shumën 16,000 USD. Kontrata është lidhur në korrik 2014, me afat 1 vit. Kjo shumë është vlera e të ardhurave të përfituara të bashkëshortit tim R.S nga qiratë mujore të godinës së ish-gjykatës, në adresën Rr. e D, Tiranë dhe të 2 dyqaneve të kësaj godine, për vitet 2011, 2012 dhe 2013, në vlerën rreth 5,100 USD në çdo vit, si dhe përfitimi nga bonot e thesarit në janar 2014 në vlerën përkatëse të interesave 64,373 lekë/rreth 600 USD”.*

¹⁵ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) nxjerrje llogarie datë 5.1.2017, nga “Raiffeisen Bank” në emër të shtetasit R.S, për periudhën 27.3.2015 – 5.1.2017; (ii) informacion datë 18.10.2016, e “Raiffeisen Bank”, ku konfirmohet se shtetasi R.S ka depozitë 12-mujore në shumën 16,034 USD; (iii) kontratë huaje nr. ***, datë 12.7.2014; (iv) deklaratë noteriale nr. ***, datë 12.7.2014; (v) kontratë qiraje nr. ***, datë 24.5.2005.

Konstatimi i ILDKPKI-së

- *Bashkëshorti i subjektit në deklaratat e interesave privatë periodikë vjetorë 2011 – 2013, ka deklaruar të ardhura nga qiraja, gjatë kësaj periudhe shumat e përfituar nga qiratë nuk janë deklaruar në gjendje cash, për t'u pakësuar në vijim për hapjen e depozitës në shumën 16,000 USD në vitin 2015.*

Hetimi¹⁶/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

66. Nga nxjerrja e llogarisë së bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në “Raiffeisen Bank” rezulton se në datën 27.3.2015 është depozituar shuma 16,000 USD, me përshkrimin “kthim huaje”, nga e cila janë krijuar në vijimësi përfitime nga interesat bankare. Në datën 31.12.2016 gjendja në këtë depozitë është në shumën 16,034.66 USD.

67. Për të vërtetuar huadhënien e shumës 16,000 USD, subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) kontratë huaje nr. ***, datë 12.7.2014, e lidhur midis huadhënësve Fahrije Stringa dhe R. S dhe huamarrësve M.T, D.T dhe E.K, me objekt huadhënien e shumës 16,000 USD, e cila është dhënë hua në janar të vitit 2014 dhe do të kthehet e plotë pa interesa në janar të vitit 2015;
- b) deklaratë noteriale nr. ***, datë 12.7.2014, ku deklaruesit M.T, D.T dhe E.K deklarojnë se i kanë marrë hua shtetasve R e Fahrije Stringa shumën 16,000 USD, për periudhën janar 2014 – janar 2015, pa interesa.

68. Nga verifikimi i deklarimeve vjetore rezulton se në lidhje me këtë huadhënie subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si vijon:

- Në DPV/2014: *“Në janar 2014 unë dhe bashkëshorti im kemi dhënë hua shumën 16,000 USD. Kontrata është lidhur në korrik 2014, me nr. ***, datë 12.7.2014, me afat 1 vit. Kjo shumë është vlera e të ardhurave të përfituara të bashkëshortit tim nga qiratë mujore të godinës së ish-Gjykatës dhe të dy dyqaneve të kësaj godine për vitet 2011, 2012 dhe 2013 në vlerën rreth 5,100 USD në çdo vit, si dhe përfitimi nga bonot e thesarit në janar 2014”.*
- Në DPV/2015: *“Shuma 16,000 USD e dhënë hua është kthyer nga huamarrësit në datën 27.3.2015 dhe është depozituar në ‘Raiffeisen Bank’ në këtë datë, sipas kontratës së depozitës me afat. Në këtë kontratë më ka përfshirë edhe mua si bashkëshorten e tij, me dëshirën e tij”.*

Analiza financiare lidhur me mundësinë e subjektit për dhënien e huas në janar 2014

69. Subjekti deklaron se shuma 16,000 USD ka si burim:

- a) të ardhurat e përfituara nga kontratat e qirave të pasurive të paluajtshme në bashkëpronësi të bashkëshortit dhe familjarëve të tij, të përfituara në vitet 2011, 2012 dhe 2013;
- b) përfitimi nga bonot e thesarit në janar të vitit 2014 në vlerën përkatëse të interesave 64,373 lekë/rreth 600 USD.

¹⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 18.9.2020, drejtuar bankave të nivelit të dytë; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 30.10.2020, e “Raiffeisen Bank”.

70. Nga analizimi i deklarimeve periodike të subjektit lidhur me të ardhurat e përfituara nga qiradhënia në vitet 2011, 2012 dhe 2013, si dhe deklarimeve të dhëna pranë ILDKPKI-së, ka rezultuar se:

- Në DPV/2011 subjekti ka deklaruar: (i) të ardhura nga qiraja mujore nga godina e ish-gjykatës në Rr e D, me vlerë 375 USD/muaj; (ii) të ardhura nga qiraja mujore e dy dyqaneve të godinës në vlerën 90 USD/muaj, në periudhën janar – dhjetor 2011; (iii) subjekti nuk ka deklaruar gjendje *cash*.
- Në DPV/2012 subjekti ka deklaruar: (i) të ardhura nga qiraja mujore nga godina e ish-gjykatës në Rr e D, me vlerë 337.5 USD/muaj; (ii) të ardhura nga qiraja mujore e dy dyqaneve të godinës në vlerën 90 USD/muaj, në periudhën janar deri në dhjetor 2012; (iii) subjekti nuk ka deklaruar gjendje *cash*.
- Në DPV/2013 subjekti ka deklaruar: (i) të ardhura nga qiraja mujore nga godina e ish-Gjykatës në Rr e D, me vlerë 337.5 USD/muaj; (ii) të ardhura nga qiraja mujore e dy dyqaneve të godinës në vlerën 90 USD/në muaj, në periudhën janar – dhjetor 2013; (iii) subjekti nuk ka deklaruar gjendje *cash*.
- Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka sqaruar: *“Gjendja cash në vitin 2013 ishte në vlerën 15,300 USD + 50,000 euro. Në DPV/2014 dhe në deklaratën Vetting kam deklaruar se shuma 16,000 USD është vlere e të ardhurave të përfituara nga bashkëshorti im nga qiratë e godinës së ish-gjykatës për vitet 2011, 2012 dhe 2013 në vlerën 5,100 USD/vit. Pra gjendja cash në fund të vitit 2013 ka qenë 5,100 USD + 5,100 USD + 5,100 USD = 15,200 USD”*.
- Në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në datën 2.7.2015, e pyetur lidhur me gjendjen *cash* deri në datën 31.12.2013, subjekti ka deklaruar: *“Gjendja cash deri në datën 31.12.2013 është në vlerën 50,000 euro, të përfituara nga shitja e apartamentit...”*.

71. Nga analizimi i deklarimeve të mësipërme në lidhje me gjendjen *cash*, rezulton se të ardhurat e qirave vjetore të përfituara nga bashkëshorti i subjektit në masën 5,100 USD/vit nuk janë deklaruar si gjendje *cash* në deklaratimet vjetore dhe as në procesverbalin e datës 2.7.2015 në ILDKPKI, për t’u pakësuar në vijim për dhënie e huas në favor të huamarrësve M.T, D.T dhe E.K. Për më tepër, subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e këtyre kursimeve për vitet 2011 – 2013.

72. Për sa më sipër, duke marrë në konsideratë se:

- i. subjekti nuk ka deklaruar shtesa/pakësime të gjendjes *cash* në vitet 2011 - 2013 të shumës totale 15,200 USD;
 - ii. subjekti në vitin 2015 nuk ka deklaruar si gjendje *cash* pranë ILDKPKI-së shumën 15,200 USD;
 - iii. subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e gjendjes *cash* në shumën 15,200 USD,
- Komisioni nuk përfshiu shumën 15,200 USD në analizën financiare të vitit 2014, duke i kaluar barrën e provës subjektit.

73. Në lidhje me përfitimin nga bonot e thesarit në janar të vitit 2014, në vlerën përkatëse të interesave 64,373 lekë/rreth 600 USD, referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga

Banka e Shqipërisë, Zyra e Bonove të Thesarit⁷, paraqitur nga subjekti pranë ILDKPKI-së, rezulton se në periudhën 1.1.2014 – 25.2.2014, shtetasi R.S ka tërhequr interesat e përfituara nga bonot e thesarit në vlerën 64,373 lekë. Kjo vlerë është përfshirë në analizën financiare për dhënien e huas.

74. Komisioni kreu analizën financiare¹⁷ në lidhje me dhënien e huas, duke mos përfshirë në këtë analizë shumën prej 15,200 USD. Nga analiza financiare duket se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme në shumën 1,644,294.05 lekë për dhënien e huas. Për këtë rezultat të hetimit, subjektit iu kalua barra e provës.

75. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti pretendoi se këtë kontratë huaje e ka lidhur për faktin se në atë kohë shtetasi M.T, D.T dhe E.K kishin pësuar një fatkeqësi në familjen e tyre, bashkëshorti i znj. E.K kishte ndërruar jetë për shkak të një aksidenti me rrymën elektrike, duke sjellë si pasojë një rëndim financiar në familjen e tyre, për mungesë të pagimit të kredive që kishin në atë kohë. Për këtë shkak u përpoqën t'i gjendeshin afër sado pak, duke i ndihmuar me mjete monetare në formën e dhënies së një huaje pa interes.

Veprimet juridike i ka deklaruar saktësisht në DPV-të periodike, sipas përshkrimit të mëposhtëm:

- Në DPV/2014 ka deklaruar: *“Në janar 2014 unë dhe bashkëshorti im kemi dhënë hua shumën 16,000 USD. Kontrata është lidhur në korrik 2014, me nr. ***, datë 12.7.2014, me afat 1 vit. Kjo shumë është vlera e të ardhurave të përfituara të bashkëshortit tim nga qiratë mujore të godinës së ish-gjykatës dhe të dy dyqaneve të kësaj godine për vitet 2011, 2012 dhe 2013, në vlerën rreth 5,100 USD në çdo vit, si dhe përfitimi nga bonot e thesarit në janar 2014”.*
- Në DPV/2015 ka deklaruar: *“Shuma 16,000 USD e dhënë hua është kthyer nga huamarrësit në datën 27.3.2015 dhe është depozituar në ‘Raiffeisen Bank’ në këtë datë, sipas kontratës së depozitës me afat. Në këtë kontratë më ka përfshirë edhe mua si bashkëshorten e tij, me dëshirën e tij”.*

76. Si burim për dhënien e këtyre shumave kanë shërbyer të ardhurat e përfituara nga kontratat e qirave të pasurive të paluajtshme në bashkëpronësi të bashkëshortit të saj dhe familjarëve të tij, të përfituara në vitet 2011, 2012 dhe 2013, si dhe bonot e thesarit në janar të vitit 2014 në vlerën përkatëse të interesave 64,373 lekë/rreth 600 USD. Këto të ardhura i ka deklaruar saktësisht në DPV-të e viteve 2011, 2012 dhe 2013, si dhe në deklaratën Vetting. Subjekti deklaroi: *“Sikurse kam sqaruar dhe shpjeguar edhe në pyetësorin standard dhe përgjatë gjithë hetimit administrativ, unë kam deklaruar me detaje çdo vit të ardhurat që vinin nga qiraja, në rubrikën ‘të ardhura’, duke qenë e bindur se ato ishin subjekt i ligjit dhe nuk kam deklaruar asnjëherë kursimet cash. Por ndërkohë del qartë nga deklarimi në DPV/2014 kur përmend kursimet nga qiraja në vitet 2011 - 2013 në shumën 5,100 USD dhe është e kuptueshme që këto shuma kanë ekzistuar si likuiditet dhe kanë qenë gjendje cash në banesë. Deklarimi im pranë ILDKPKI-së në vitin 2015 për gjendjen cash në vitin 2013 lidhej vetëm me shitjen e pasurisë së paluajtshme nga bashkëshorti im, pasi kam menduar që konteksti i pyetjes lidhej pikërisht me këtë pasuri të paluajtshme të tjetërsuar dhe nuk kam menduar që duhej të përmendeshin edhe të ardhurat e tjera që vinin nga marrëdhënia e qirasë së pasurisë së bashkëshortit tim në*

¹⁷ Shihni tabelën nr. 3 të rezultateve të hetimit.

bashkëpronësi me familjen e tij. Dua të deklaroj me sinqeritet të plotë që mosdeklarimi i këtyre shumave si gjendje cash ka ardhur thjesht nga një padijeni dhe pakujdesi e imja në mënyrën e plotësisimit të deklaratës, kurrsesi për qëllime të tjera. Dua të theksoj se ne si familje, si unë edhe bashkëshorti im apo prindërit tanë, i kemi kursyer gjithnjë të ardhurat e krijuara nga qiratë apo tjetërsimet e pasurive dhe asnjëherë nuk i kemi shpenzuar ato. Unë jetoj vetëm me bashkëshortin tim, shpenzimet tona janë modeste, asnjëherë nuk kemi kryer shpenzime luksi, sikundër del qartë edhe nga deklaratimet tona. Duke marrë në konsideratë se kontratat e qirave të lidhura nga bashkëshorti im për pasuritë e tij në bashkëpronësi, si akte noteriale, ishin tejet transparente e të gjurmueshme, është moskuptimi im i ligjit që ka sjellë si pasojë mosdeklarimin e kësaj shtese të gjendjes së likuiditeteve edhe në këtë rubrikë përkatëse në DPV-të e këtyre viteve. Pra, deklarimi jo në rubrikën e duhur nuk duhet të përbëjë kurrsesi një shkak për deklarim të pasaktë apo deklarim të pamjaftueshëm, pasi do të binte ndesh me parimin e proporcionalitetit. Mosdeklarimi i shtesës së gjendjes së likuiditeteve në rubrikën e duhur nuk përbën një pasaktësi apo pamjaftueshmëri, por thjesht një parregullsi formale që nuk ka sjellë asnjë pasojë, pasi burimi i ligjshmërisë së shtesës qartazi rezultojnë nga të ardhurat e qirave dhe kjo provohet në mënyrë të sigurt dhe pa asnjë kundërshtim”.

77. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, konstaton se:

- i. Subjekti nuk rezulton të ketë deklaruar kursime përgjatë gjithë periudhës së deklarimit të saj.
- ii. Subjekti nuk rezulton që të ketë deklaruar si gjendje *cash* shumën 15,300 USD kur është pyetur në ILDKPKI.
- iii. Subjekti ka deklaruar si burim për dhënien e huas në vitin 2014 shumën 15,300 USD si kursim *cash* të viteve 2011 - 2013.
- iv. Subjekti ka deklaruar kthimin e kësaj huaje në vitin 2015, si dhe depozitim të saj në “Raiffeisen Bank”.
- v. Huadhënësit kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për kthimin e huas.
- vi. Nga analiza financiare me përfshirjen e të ardhurave të trajtuara më lart, subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e kursimeve *cash* në shumën 15,300 USD, pasi ajo rezulton me një balancë pozitive për periudhën 2011 – 2013 në shumën 821,936 lekë.

78. Bazuar në konstatimet e mësipërme, si dhe duke marrë në konsideratë faktin se: (i) kemi të bëjmë me dhënien e një huaje dhe jo marrjen e saj, të cilën subjekti, nëse nuk do të kishte të ardhura të mjaftueshme të ligjshme, mund edhe të mos e deklaronte, pasi ajo nuk ka shërbyer si burim për krijimin e ndonjë pasurie në vitin 2014; (ii) subjekti e ka deklaruar si burim gjendjen *cash* në shumën 15,300 USD në DPV/2014, duke korrigjuar në këtë mënyrë deklaratimet e saj në deklaratat e mëparshme periodike; (iii) subjekti ka deklaruar rregullisht të ardhurat nga qiraja, duke paguar edhe detyrimet përkatëse tatimore, si dhe ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e këtyre kursimeve *cash*; (iv) të ardhurat që kanë gjeneruar mjetet monetare në gjendje *cash* janë krijuar nga burime reale dhe totalisht të provuara si në aspektin faktik – nëpërmjet kontratave të qirave dhe veprimeve bankare – ashtu edhe në këndvështrimin e ligjshmërisë së këtyre të ardhurave, për të cilat janë paguar rregullisht tatimet përkatëse. Kësisoj Komisioni nuk gjendet në kushtet e një pretendimi të krijimit të

gjendjes *cash* në banesë, bazuar thjesht në mundësitë hipotetike financiare sipas analizave financiare, pasi në këtë rast të ardhurat e konsiderueshme nga qiradhëniet janë plotësisht të provuara e të tatuara dhe të papërdorura për ndonjë destinacion alternativ. Në këto kushte, bazuar në parimin e objektivitetit, këto burime nuk mund të injorohen nga Komisioni, pasi penalizimi i subjektit për thjesht faktin e mosdeklarimit me korrektësi për shtimin apo pakësimin e gjendjes *cash* ndër vite, në rrethanat konkrete, do të ishte jo proporcional.

Gjithashtu, Komisioni, në mbështetje të qëndrimit të mbajtur nga Kolegji në çështje të ngjashme, e cila përbën tashmë jurisprudencë të konsoliduar të tij¹⁸, vlerëson se një deklaram i pasaktë në deklaramet e mëparshme periodike të interesave nuk mund të konsiderohet se është bërë në kundërshtim me përcaktimin e germës “a” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, për rrjedhojë, nuk është element i mjaftueshëm për t’u konsideruar si një shkak i vetëm dhe i veçuar që prodhon situatën e deklaramit të pamjaftueshëm, në kuptim të pikës 3 të nenit 61 të këtij ligji.

Për më tepër, bazuar në deklaramet e subjektit në DPV/2014, këto pasaktësi janë korrigjuar prej saj duke qenë konsistente në deklaramet, pasi: (i) në DPV/2014 deklaroi si burim për dhënien e huas kursimet nga qiratë për vitet 2011 - 2013 në secilën vit në shumën 5,100 USD; (ii) në deklaramtën *Vetting*, ku si burim për këtë depozitë deklaroi gjendjen *cash* në shumën 15,300 USD të krijuar nga të ardhurat e përfituara në vitet 2011 - 2013 nga dhënia me qira e pasurive të paluajtshme, përkatësisht 5,100 USD në vit.

Për sa më sipër, Komisioni krijoi bindjen se shuma prej 15,300 USD ka ekzistuar si kursim *cash* dhe se subjekti ka pasur mjaftueshëm burime financiare me të ardhura të ligjshme për ekzistencën e këtij kursimi. Tërësia e veprimeve të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur (bashkëshortit) krijojnë bindjen e arsyeshme se pasaktësitë në deklaramet vjetore mbeten shkak i veçuar, i pashoqëruar me dyshime të arsyeshme për deklaram të rremë apo fshehje pasurie nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe, për pasojë, krijoi bindjen se ato duhen pranuar duke u përfshirë në analizën financiare të subjektit.

79. Analiza financiare për dhënien e huas

Tabela nr. 3

	Janar 2014
Pasuria	-1,864,079.63
<i>Ndryshim likuiditeti</i>	<i>-1,864,079.63</i>
Detyrime	-1,818,240.00
Hua dhënë shtetasve M dhe D.T dhe E.K	1,818,240.00
Pasuria neto	-45,839.63

¹⁸ Vendimet nr. 9/2020 (JR), datë 26.6.2020, nr. 16/2020 (JR), datë 13.7.2020 dhe nr. 31/2020 (JR), datë 18.11.2020, të Kolegjit.

Të ardhura	164,572.45
Të ardhurat e subjektit Fahrije Stringa Budo	102,150.00
Të ardhura nga qiratë	62,422.45
Të ardhurat e bashkëshortit R.S	0.00
Të ardhurat e nënës së bashkëshortit G.S	0.00
Të ardhurat nga interesat e depozitave	0.00
Shpenzime	36,666.33
Shpenzime jetike	36,666.33
TIMS	0.00
Mundësia për kursime	173,745.75

Nga analiza financiare e kryer sërish nga Komisioni, me përfshirjen e kësaj shume, rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për dhënien e kësaj huaje.

Në lidhje me kthimin e huas

80. Subjekti është pyetur në lidhje me burimin e ligjshëm të të ardhurave të huamarrësve, që kanë shërbyer për kthimin e huas dhe në përgjigje të pyetësorit datë 19.10.2022, ka deklaruar *se në deklaratën noteriale nr. ***, datë 28.10.2022, znj. E.K ka deklaruar burimin e të ardhurave për kthimin e huas në datën 27.3.2015. Si burim për shlyerjen e huas ka shërbyer ekzekutimi i një vendimi nga studioja përmbarrimore "S.B" si rrjedhojë e aksidentit në punë të bashkëshortit të saj, të ndjerit Q.K. Nga statement-i bankar i BKT-së, datë 19.5.2015, konfirmohet se në datën 20.3.2015 i është likuiduar shuma e dëmshpërblimit 20,753,000 lekë.*

Subjekti i ka bashkëlidhur përgjigjes dokumentacionin e mëposhtëm:

- deklaratë noteriale nr. ***, datë 28.10.2022, e shtetasës E.K, në përmbajtje të së cilës ajo deklaroi se si burim për shlyerjen e huas ndaj shtetasve Fahrije e R.S ka shërbyer dëmshpërblimi i marrë përmes ekzekutimit të vendimit të gjykatës nga studio përmbarrimore "S.B.S" sh.p.k. si rrjedhojë e aksidentit në punë të bashkëshortit të saj;
- *statement* i llogarisë bankare të shtetasës E.K në BKT, ku evidentohet kreditimi i llogarisë përmes transfertës bankare datë 20.3.2015, në vlerën 20,753,000 lekë të kryer nga llogaria e studios përmbarrimore "S.B.S" sh.p.k. dhe tërheqja në datën 25.3.2015 e shumës 4,000,000 lekë;
- nxjerrje llogarie e shtetasit R.S në "Raiffeisen Bank", ku evidentohet depozitimi *cash* i kryer nga bashkëshorti i subjektit në datën 27.3.2015, në vlerë 16,000 USD.

81. Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit rezulton se huamarrësit E.K etj. kanë pasur mundësi financiare për kthimin e huas subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj.

82. Në përfundim të hetimit për këtë pasuri, Komisioni konkludon se nuk lindin paqartësi apo pamjaftueshmëri mjetesh monetare.

83. Depozitë me afat në Bankën Kombëtare Tregtare¹⁹, krijuar në datën 25.1.2011 në emër të babait të subjektit I.B. Subjekti ka deklaruar: *"Në këtë depozitë, me dëshirën e tij,*

¹⁹ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) nxjerrje llogarie datë 18.10.2016, lëshuar nga banka BKT; (ii) depozitë me afat datë 19.1.2017, lëshuar nga BKT, e cila konfirmon se shtetasit Fahrije Stringa ose I.B kanë depozitë në shumën 3,568,198 lekë; (iii) vërtetim nr. *** prot., datë 19.1.2017, lëshuar nga ISSH; (iv) prokurë e përgjithshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.2.2004; (v) vendim nr. ***, datë 21.11.2007, lëshuar nga Gjykata e Rrethit

më ka përfshirë edhe mua si vajzën e tij, për arsye të moshës së tij të thyer, pasi unë kujdesem për të, për lehtësi menaxhimi. Kjo depozitë në datën 19.1.2017 është gjendje 3,568,198.07 lekë”.

Burimi i krijimit sipas deklaratës Vetting: “(a) Babai im I.B në datën 25.1.2011 ka depozituar në BKT këstin e parë të dëmshpërblimit të tij si i përndjekur politik - i burgosur në shumën 415,332 lekë; (b) babai im I.B në datën 20.5.2011 ka depozituar në BKT dëmshpërblimin për nënën e tij, të ndjerën F.B, si e përndjekur politike, në shumën 1,026,000 lekë; (c) babai im I.B në datën 13.2.2012 ka shtuar në depozitën e tij në BKT të ardhurat e përfutuara nga pensioni i vajzës së tij L.B, e cila jeton në Itali dhe ia ka lënë atij për tërheqje dhe menaxhim që nga maji i vitit 2004 e në vijim, në shumën 1,200,000 lekë; (ç) babai im I.B në datën 4.9.2012 ka shtuar në depozitën e tij në BKT këstin e dytë të dëmshpërblimit si i përndjekur politik - i burgosur, në shumën 415,332 lekë”.

Hetimi²⁰/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

84. Nga nxjerrja e llogarisë së subjektit të rivlerësimit dhe babait të saj në Bankën Kombëtare Tregtare evidentohet se kjo llogari ka shërbyer si llogari mbështetëse për depozitat e krijuara nga data 25.1.2011 deri më 13.9.2018 (datë kur është mbyllur si llogari). Në këtë llogari janë kryer depozitimet e mëposhtme:

i. Në datën 25.1.2011 është kredituar shuma 415,332 lekë, me përshkrimin “I.B për I.B ose Fahrje Stringa kalim në depozitë 1 vit, kësti i parë i dëmshpërblimit si i përndjekur politik, burgu” (kaluar në depozitë po në këtë datë).

ii. Në datën 20.5.2011 është kredituar shuma 1,026,000 lekë, me përshkrimin “Derdhje në depozitë, shuma është dëmshpërblim si e përndjekur politike për nënën F.B” (kaluar në depozitë po në këtë datë).

iii. Në datën 13.2.2012 kredituar shuma 1,200,000 lekë, me përshkrimin “Derdhje në depozitë 346 ditë të ardhura të përfutuara nga pensioni i vajzës L.B, që i ka lënë për tërheqje dhe administrim nga maji 2004” (kaluar në depozitë po në këtë datë).

iv. Në datën 4.9.2012 kredituar shuma 415,332 lekë, me përshkrimin “I.B për I.B ose Fahrije Stringa, kalim në depozitë” (shpërblim si i persekutuar politik kësti i dytë, kaluar në depozitë po në këtë datë).

v. Në datën 25.1.2013 në llogari janë kredituar principalet e depozitave të sipërcituara, në vlerën totale 3,191,495.70 lekë, si dhe interesat e gjeneruara prej tyre 62,375.42 lekë. Totali prej 3,253,971.12 lekësh (principal + interesa) është kaluar në depozitë me afat 12-mujor në llogarinë dyemërore të shtetasve I.B dhe Fahrije Stringa në BKT.

vi. Kjo depozitë pas maturimit të përvitshëm, në datën 29.1.2017, rezulton në vlerën 3,568,198 lekë.

85. Nga analizimi i deklarimeve vjetore, rezulton se:

Gjyqësor Tiranë, me palë paditëse I.B dhe palë të paditur ISSH dhe DRSSH; (vi) vendim nr. ***, datë 21.4.2010, për miratimin e dëmshpërblimit financiar për ish të dënuarit politikë të regjimit komunist.

²⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 18.9.2020, drejtuar bankave të nivelit të dytë; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 5.10.2020, e BKT-së.

- Në DPV/2011 subjekti ka deklaruar: “*Babai im I.B në datën 25.1.2011 ka depozituar në BKT këstin e parë të dëmshpërblimit të tij si i përndjekur politik - i burgosur. Më ka përfshirë edhe mua në këtë llogari për arsye të moshës së tij të thyer, pasi unë kujdesem për të, për lehtësi menaxhimi.*”

Babai im I.B në datën 20.5.2011 ka depozituar në BKT dëmshpërblimin për nënën e tij F.B, si e përndjekur politike. Më ka përfshirë edhe mua në këtë llogari për arsye të moshës së tij të thyer, pasi unë kujdesem për të, për lehtësi menaxhimi”.

- Në DPV/2012 subjekti ka deklaruar: “*Babai im I.B në datën 13.2.2012 ka shtuar në depozitën e tij në BKT, në të njëjtën llogari që kishte, të ardhurat e përfituara nga pensioni i vajzës së tij L.B, e cila jeton në Itali dhe ia ka lënë atij për tërheqje dhe menaxhim që nga maji 2004 e në vijim, në shumën 1,200,000 lekë.*”

Babai im I.B në datën 4.9.2012 ka shtuar në depozitën e tij në BKT shumën – këstin e dytë të dëmshpërblimit të tij si i përndjekur politik - i burgosur në shumën 415,332 lekë. Më ka përfshirë edhe mua në këtë llogari për arsye të moshës së tij të thyer, pasi unë kujdesem për të, për lehtësi menaxhimi.

Babai im I.B në datën 28.2.2013 ka tërhequr në BKT, në të njëjtën llogari, shumën e depozituar nga DRSSH Tiranë prej 354,915 lekësh, nga të cilat 292,515 lekë të fituara me proces gjyqësor me procedurë përmbartimore për nënën e tij, të ndjerën F.B, si e përndjekur politike. Diferenca e shumës së tërhequr me atë të përfituruar janë pagesa e ekspertit dhe taksa përmbartimore”.

Në lidhje me burimin e krijimit të depozitës

86. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar se kjo depozitë bankare është krijuar me burim nga të ardhurat e poshtëshënuara:

- a. Dëmshpërblim i përfituruar nga babai i subjektit, z. I.B, si i përndjekur politik - i burgosur, në shumën 415,332 lekë dhe kësti i dytë i këtij dëmshpërblimi në shumën 415,332 lekë, depozituar në BKT në datën 4.9.2012**

87. Ministria e Financave dhe Ekonomisë²¹ informon se në sistemin elektronik të kryerjes së pagesave E-dëmshpërblime, në dosjen e ish të përndjekurit politik I.B, miratuar me nr. ***, në VKM-në Nr. 268, datë 21.4.2010, me vlerë totale të miratuar prej 3,292,658 lekësh. Aktualisht kjo vlerë e miratuar është shpërndarë në mënyrë të plotë me tetë këste proporcionale (411,582 lekë secili këst) në favor të z. B, ku konkretisht: kësti i parë është përfituruar në vitin 2010; kësti i dytë në vitin 2012; kësti i tretë, i katërt dhe i pestë në vitin 2015; kësti i gjashtë në vitin 2016; kësti i shtatë dhe i tetë në vitin 2017.

88. Nga analizimi i pasqyrave bankare të llogarisë së shtetasve I dhe Fahrije Budo në BKT janë evidentuar kreditimet e mëposhtme:

- Në datën 3.8.2010 në llogarinë bankare të shtetasit I. B në BKT është kredituar shuma 415,332 lekë, me përshkrimin “përndjekur politik, likuidim detyrimi nr. *** prot.”.

²¹ Shkresë nr. *** prot., datë 29.9.2022, drejtuar Ministrisë së Financave; kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 11.10.2022, e Ministrisë së Financave.

- Në datën 25.1.2011 shtetasi I.B e ka transferuar këtë shumë në llogarinë depozitë dyemërore të shtetasve Fahrije dhe I.B, me përshkrimin “për I.B ose Fahrije Stringa kalim në depozitë 1 vit, kësti i parë i dëmshpërblimit si i përndjekur politik, burgu”.

- Në datën 26.7.2012 në llogarinë bankare të shtetasit I.B në BKT është kredituar shuma 415,332 lekë, me përshkrimin “dëmshpërblim për ish i dënuar politik, kësti i dytë, shkresa nr. ***, datë 23.7.2012...”.

- Në datën 4.9.2012 shtetasi I.B e ka transferuar këtë shumë në llogarinë depozitë dyemërore të shtetasve Fahrije dhe I.B, me përshkrimin “për I.B ose Fahrije Stringa kalim në depozitë 1 vit, kësti i dytë i dëmshpërblimit si i përndjekur politik, burgu”.

b. Dëmshpërblim i përfutur nga babai i subjektit për nënën e tij, znj. F.B, si e përndjekur politike, në shumën 1,026,000 lekë

89. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* vendimin gjyqësor nr. ***, datë 21.11.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me palë paditëse I.B, të paditur ISSH dhe DRSSH, me objekt “anulimi pjesërisht i vendimit nr. **, datë 23.3.2006, i DRSSH-së Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 10.5.2006, të Komisionit Qendror të Ankimit në Institutin e Sigurimeve Shoqërore”. Referuar dispozitivit të këtij vendimi, gjykata ka vendosur: *Anulimin e pjesshëm të vendimit nr. ***, datë 23.3.2006, të DRSSH-së Tiranë dhe vendimit nr. ***, datë 10.5.2006, të ISSH-së. Detyrimin e palës së paditur të akordojë si masë përfitimi në favor të palës paditëse, pension pleqërie për shkak të internimit për të ndjerën F.B, shumën 842,990 lekë, si dhe interesat e kësaj shume sipas marzhit të interesave të ponderuara të Bankës së Shqipërisë deri në ekzekutimin e vendimit, duke filluar nga data e shpalljes së vendimit. Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër të saj.*

Ky vendim rezulton të jetë ankimuar, dhe Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 2.12.2008, ka vendosur: *Lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 21.11.2007.*

90. Në lidhje me ekzekutimin e këtij vendimi gjyqësor, në përgjigje të pyetësorit datë 19.10.2022, subjekti²² ka sqaruar: “*Bashkëngjitur aktekspertimit nr. ***, datë 14.12.2010, që*

²² Subjekti i ka bashkëlidhur përgjigjes dokumentacionin: (i) fragment të *statement*-it bankar të llogarisë së shtetasit I.B në BKT, ku evidentohet se në datën 20.5.2011 ky shtetas ka kryer depozitimin *cash* të shumës 1,026,000 lekë, me përshkrimin “derdhje në depozitë, shuma është dëmshpërblim si e përndjekur politike për nënën F.B”; (ii) shkresë e shtetasit I. B drejtuar DRSSH-së Tiranë (e padatur), përmes së cilës babai i subjektit paraqet ankesën e tij, në të cilën pretendon se mbi bazën e vendimi gjyqësor datë 21.2.2007 ka përfutur nga qendra e pensioneve shumën 1,026,000 lekë, kur ndërkohë ky institucion detyrohet të paguajë në total vlerën 1,158,709 lekë. Kësaj shkresë i bashkëlidhet aktekspertimi kontabël i përgatitur nga ekspertja L.H, protokolluar pranë ISSH-së në datën 14.12.2010; (iii) vendim nr. *** akti, datë 18.7.2011, me palë kërkuese I.B, person i tretë DRSSH Tiranë, me objekt “ndreqje gabimi material në vendimin nr. ***, datë 21.11.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”. Përmes këtij vendimi, gjykata ka vendosur pranimin e kërkesës dhe korrigjimin e gabimit material, për sa i përket momentit të fillimit të llogaritjes së interesave bankarë të shumës 842,990 lekë. Sipas shënimit përkatës rezulton se ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. **, datë 2.2.2012; (iv) vendim nr. ***, datë 22.4.2011, me palë kërkuese I.B, me objekt “lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë për të ndjerët N dhe F.B”. Gjykata ka përcaktuar si trashëgimtarë ligjorë të të ndjerëve fëmijët e tyre S, I e N. B; (v) vendim nr. ***, datë 4.9.2003, për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë për të ndjerën S.T, sipas të cilit trashëgimtar testamentar i saj është djali i saj M.T; (vi) deklaratë materiale nr. ***, datë 26.10.2022, përmes së cilës deklaruesi M.T (i biri i S.T) deklaron: “*Në prill të vitit 1965 daja im I.B u dëbua familjarisht nga Tirana për motive politike dhe gjyshja ime F.B shkoi me të birin në internim... Kam qenë gjithmonë në dijeni për pensionin e gjyshes time F.B, përfutur si e dëbuar politike në shumën 1,026,000 lekë, në momentin e ekzekutimit të këtij vendimi, unë si trashëgimtar testamentar i nënës time, pjesën time takuese nga nëna, në mënyrë të ndërgjegjshme dhe shpirtërore, e kam konsideruar si një dëmshpërblim që i takon dajës dhe familjes së tij që vuajtën 35 vjet burg dhe internim... ”; (vii) prokurë e posaçme nr. ***, datë 23.11.2010, përmes së cilës shtetasi M.T i jep tagra I.B për të kryer të gjitha*

*tregon llogaritjen e interesave të shumës 842,990 lekë, të përfituar dhe të marrë prej tij me vendimin gjyqësor nr. ***, datë 21.11.2007. Kjo shumë, së bashku me interesat, ka qenë 1,026,000 lekë... Babai ka çelur dëshminë e trashëgimisë ligjore me vendimin nr. ***, datë 22.4.2011, për nënën e tij F.B, ku trashëgimtar ligjor janë përcaktuar I, S dhe N.B. Në lidhje me pjesën takuese të znj. S.T, nga trashëgimtari i vetëm i saj z. M.T është lëshuar deklaratë noteriale datë 26.10.2022, që tregon se ai ka hequr dorë nga pjesa e tij takuese. Motra tjetër e babait N.T nuk ka pasur pretendim për këtë shumë sepse vetëm babai im ka vuajtur burgim dhe internim, duke sqaruar se ka qenë dëshira e saj që këtë shumë pensioni të nënës të saj ta përfitojë vetëm djali i saj. Nuk mund të siguroj dokumentacion për vullnetin e saj, pasi ajo ka ndërruar jetë dhe ka qenë e pamartuar”.*

91. DRSSH-ja²³ informon se vendimi gjyqësor nr. ***, datë 21.11.2007, i lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 2.12.2008, është ekzekutuar nëpërmjet zyrës përmbarimore të përmbaruesit A.S, në emër të kreditorit I.B. Ky institucion i ka bashkëlidhur përgjigjes së tij dokumentacionin e mëposhtëm:

- shkresë nr. ***prot., datë 5.12.2012, e përmbaruesit gjyqësor privat A.S “lajmërim për ekzekutim vullnetar” të urdhrit të ekzekutimit nr. *** akti, datë 23.11.2012;
- shkresë nr. *** prot., datë 4.1.2013, e “Raiffeisen Bank”, përmes së cilës kjo bankë informon zyrën përmbarimore për kryerjen e bllokimit të llogarisë së debitorit DRSSH në shumën e detyrimit prej 370,415 lekësh;
- shkresë nr. *** prot., datë 13.2.2013, e “Raiffeisen Bank”, përmes së cilës kjo bankë njofton kalimin e shumës së detyrimit prej 406,415 lekësh nga llogaria e debitorit DRSSH në llogarinë e zyrës përmbarimore.

92. Nga procesverbalet e administruara nga ILDKPKI-ja²⁴ evidentohet dokumentacioni i depozituar nga subjekti i rivlerësimit pranë këtij institucioni, si më poshtë:

- vendim nr. *** akti, datë 23.11.2012, për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për vendimin gjyqësor nr. *** akti, datë 18.7.2011;
- kërkesë e shtetasit I.B drejtuar përmbaruesit A. S, për vënien në ekzekutim të titullit ekzekutiv vendim gjykate, datë 18.7.2011;
- shkresë “lajmërim për ekzekutim vullnetar”, si dhe vendim për fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm të përmbaruesit gjyqësor A.S;
- aktekspertim kontabël, përgatitur nga ekspertja L. H gjatë procedurave përmbarimore, përmes të cilit janë përlllogaritur interesat bankare të ponderuara të Bankës së Shqipërisë për shumën 842,990 lekë, nga data 13.3.2003 deri më 20.11.2007, të cilat rezultojnë në vlerën 292,515 lekë.

93. Nga verifikimi i *statement*-it bankar të llogarisë së shtetasit I.B në BKT, rezulton se në datën 20.5.2011 ka kryer depozitimin *cash* të shumës 1,026,000 lekë, me komentin “derdhje në

procedurat në lidhje me tërheqjen e pensionit të shtetasit F.B; (viii) shkresë nr. *** prot., datë 9.11.2022, e Postës Shqiptare, përmes së cilës ky institucion informon se trashëgimtarët e F.B (I, S e N. B) kanë tërhequr vlerat monetare, në total 1,030,068 lekë, në Zyrën Postare nr. **, për pensionin e të ndjerës F. B. Bashkëlidhur kësaj shkrese janë paraqitur edhe urdhërpagesat për tërheqjen e shumave të pensionit.

²³ Shkresë nr. *** prot., datë 4.10.2022, drejtuar DRSSH-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 10.11.2022, e DRSSH-së.

²⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 18.9.2020, drejtuar ILDKPKI-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 5.9.2020, e ILDKPKI-së.

depozitë, shuma është dëmshtëpërblim si e përndjekur politike për nënën F.B”. Më tej, në datën 19.2.2013, llogaria e tij është kredituar me shumën 354,915 lekë nga përmbartuesi gjyqësor A. S, me komentin “ekzekutim i plotë vendim gjykate”.

Nga analizimi tërësor i dokumentacionit të administruar gjatë hetimit rezulton se shuma e ekzekutuar përmes përmbartimit gjyqësor privat i përket diferencave të pensionit të përlllogaritura dhe përfituara mbi bazë të vendimit gjyqësor nr. ** akti, datë 18.7.2011, me objekt “ndreqje gabimi material në vendimin nr. ***, datë 21.11.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

94. Referuar urdhërpagesave të ISSH-së rezulton se në datën 20.5.2011, në Zyrën Postare nr. ** janë kryer tërheqjet e pensionit të shtetases F.B, si më poshtë:

- tërheqja e shumës 62,359 lekë, kryer nga shtetasi I.B;
- tërheqja e shumës 280,997 lekë, kryer nga shtetasi I.B;
- tërheqja e shumës 280,997 lekë, kryer nga shtetasi I.B (për S.B/M.T);
- tërheqja e shumës 62,359 lekë, kryer nga shtetasi I.B (për S.B);
- tërheqja e shumës 62,359 lekë, kryer nga shtetasja N.B;
- tërheqja e shumës 280,997 lekë, kryer nga shtetasja N.B.

Nga sa më sipër, rezulton se në datën 20.5.2011 shtetasit I dhe N.B kanë kryer tërheqjet e pensionit të shtetases F.B në vlerën totale 1,030,041 lekë. Referuar dokumentacionit të administruar gjatë hetimit rezulton se mbi bazë të dëshmisë së trashëgimisë së shtetases F.B, djali i saj I.B, në cilësinë e njërit prej tre trashëgimtarëve të saj, do të duhet të përfitonte 1/3 pjesë takuese të pensionit të akorduar për nënën e tij, si pjesë e pasurisë trashëgimore.

95. Nga hetimi i Komisionit, ndryshe nga sa ka deklaruar subjekti, ka rezultuar se shuma prej 343,356 lekësh është tërhequr nga vetë znj. N.B dhe shuma prej 343,356 lekësh është tërhequr nga babai i subjektit, por për llogari të znj. S.B/M.T.

Për sa më sipër, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit, pasi dukej se ka mospërputhje midis deklaramëve të saj në deklaratën *Vetting* dhe dokumentacionit të administruar në lidhje me shumën 1,026,000 lekë, pasi nga hetimi rezultoi se babai i subjektit nuk e ka tërhequr të gjithë këtë shumë vetë, si dhe subjekti nuk provonte me dokumentacion provues të kohës dhënien e shumës 343,356 lekë babait të saj nga ana e dy trashëgimtarëve të tjerë të nënës së babait të saj.

Për rrjedhojë, shuma që do të përfshihet në analizë financiare do të jetë vetëm 1/3 e pensionit të tërhequr në shumën 343,356 lekë.

96. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti pretendoi se babai i saj ka çelur dëshminë e trashëgimisë ligjore me vendimin nr. ***, datë 22.4.2011, për nënën e tij F.B, ku trashëgimtarë ligjorë janë përcaktuar shtetasit I, S dhe N.B.

Në lidhje me pjesën takuese të shtetases S.T, nga trashëgimtari i vetëm i saj, z. M. T, është lëshuar deklarata noteriale datë 26.10.2022, që tregon se ai ka hequr dorë nga pjesa e tij takuese. Motra tjetër e babait, znj. N.B, nuk ka pasur pretendim për këtë shumë sepse vetëm babai i saj ka vuajtur burgim dhe internim, duke sqaruar se ka qenë dëshira e saj që këtë shumë pensioni të nënës ta përfitojë vetëm djali i saj. Kjo për arsye se vuajtjet e babait të saj nuk kanë qenë të lehta, ka qenë në burgim përgjatë asaj periudhe, si dhe familja e saj u internua për një kohë

shumë të gjatë dhe ky kompensim është menduar nga motrat e babait, i ka takuar moralisht personit i cili ka përjetuar vuajtjet më të mëdha të atij sistemi. Në kohën kur janë kryer tërheqjet trashëgimtar ligjor i vetëm i shtetasës S.T ka qenë i biri i saj M.T, i cili kishte lënë një prokurë për babain e saj dhe ky ka qenë një amanet i nënës së tij që të gjithë shumën e plotë të marrë si dëmshpërblim për gjyshen e tyre F.B ta përfitonte vetëm babai i saj I.B. Nëse do kishte pasur pretendime mbi këtë shumë, shtetasi M.T nuk do mund të deklaronte një fakt të tillë në deklaratën noteriale dhe as nuk ka pretenduar ndonjëherë nëpërmjet ndonjë veprimi të caktuar juridik.

97. Lidhur me shtetasen N.B, duke pasur parasysh moshën dhe marrëdhëniet e ngushta familjare, si dhe kohën e gjatë të kaluar, ajo e ka të pamundur të provojë me dokumentacion mënyrën e kalimit të shumave nga halla e saj tek babai. Një dokument i tillë, së pari, nuk është i detyrueshëm për të vërtetuar ekzistencën e faktit, pasi dhurimi i parave nuk kërkon domosdoshmërinë e një akti shkresor dhe, së dyti, marrëdhëniet e tilla janë të posaçme, ngushtësisht familjare dhe nuk janë të tilla që të detyrojnë dy familjarë motër e vëlla për të kryer këto veprime nëpërmjet një akti shkresor. Por fakti që këto shuma përputhen saktësisht me shumat e depozituara në llogari janë deklaruar të tilla nga momenti kur janë krijuar në DPV-të periodike, si dhe në deklaratën *Vetting* nuk mund të vihet në dyshim ekzistenca e tyre.

98. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, konstaton se:

- i. Në datën 20.5.2011, shtetasit I dhe N.B kanë kryer tërheqjet e pensionit të shtetasës F.B në vlerën totale 1,030,041 lekë.
- ii. Nga verifikimi i *statement*-it bankar të llogarisë së shtetasit I.B në BKT, rezulton se në datën 20.5.2011 ka kryer depozitimin *cash* të shumës 1,026,000 lekë, me komentin “Derdhje në depozitë, shuma është dëmshpërblim si e përndjekur politike për nënën F. B”.
- iii. Shtetasi M.T, me deklaratën noteriale nr. ***, datë 26.10.2022, ka pranuar që pjesën takuese të shtetasës S.T e ka përfituar daja i tij I.B.
- iv. Llogaria e krijuar është një llogari dyemërore dhe jo një llogari personale e subjektit të rivlerësimit.
- v. Nga analiza financiare në vitin 2011 subjekti ka të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për të mbuluar shumat e përfituar nga babai i saj, për rrjedhojë, nuk lindin dyshime për fshehje pasurie.

Për sa më sipër, duke marrë në konsideratë faktin që kemi të bëjmë me një marrëdhënie ngushtësisht familjare motër e vëlla, si dhe në vlerësim të faktit se subjekti ka aftësi financiare me burime të ligjshme, Komisioni krijoi bindjen se këto të ardhura duhet të përfshihen në analizë financiare.

Lidhur me të ardhurat e shtetasës N.B, ato nuk do të përfshihen në analizë financiare, pasi nga ana e saj nuk është depozituar asnjë dokumentacion provues.

c. Të ardhurat e përfituara nga pensioni i shtetasës L.B për periudhën maj 2004 e në vijim, të menaxhuara nga babai i subjektit mbi bazën e prokurës së lëshuar prej saj, në shumën 1,200,000 lekë, depozituar prej tij në BKT në datën 13.2.2012

99. Në lidhje me përfitimin e pensionit të shtetasës L.B, subjekti ka paraqitur gjatë hetimit:

- i. Prokurën e përgjithshme nr. *** kol., datë 4.2.2004, përmes së cilës shtetasja L.B rezulton të ketë emëruar si përfaqësues të saj shtetasit Fahrije Budo dhe I.B, duke u dhënë tagra për ta përfaqësuar atë së bashku ose veç e veç pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore për ndjekjen e procedurës për marrjen e pensionit, si dhe tërheqjen e tij mujore. Në funksion të këtij tagri, përfaqësuesit kanë të drejtë të paraqiten pranë çdo institucioni apo gjykate për mbrojtjen e interesave të të përfaqësuarës.
- ii. Vërtetimin nr. *** prot., datë 19.1.2017, nga DRSSH Tiranë, në përmbajtje të së cilit citohet se e ndjera L.I.B, e datëlindjes 18.5.1954, është trajtuar me pension pleqërie me nr. dosje ***. Të ardhurat e pensionit nga data e fillimit 18.5.2004 – 31.12.2012 janë në total 1,521,465 lekë.
- iii. Vërtetimin nga Posta Shqiptare, në përmbajtje të të cilit citohet se pagesat e pensionistes L.B janë kryer nëpërmjet prokurës së përgjithshme nr. *** kol., datë 4.2.2004, të shtetasit I.B, pranë Zyrës Postare nr. **. Bashkëlidhur ky institucion ka paraqitur edhe mandatpagesat për vitet 2010, 2011, 2012, 2013, 2014 dhe 2015.

100. Posta Shqiptare²⁵ ka vënë në dispozicion dokumentacionin e mëposhtëm:

- kopje të prokurës së përfaqësimit nr. ***, datë 4.2.2004;
- kopje të urdhërpagesës datë 11.1.2010, që vërteton tërheqjet e pensionit të përfitueses L.B për periudhën janar 2010 - dhjetor 2011, në shumën totale 202,200 lekë;
- mandat datë 12.12.2012, që vërteton tërheqjet e pensionit për periudhën janar 2012 - dhjetor 2012, në shumën totale 210,066 lekë;
- mandat datë 23.12.2013, që vërteton tërheqjet e pensionit për periudhën janar 2013 - dhjetor 2013, në shumën totale 219,550 lekë;
- mandat datë 19.11.2014, që vërteton tërheqjet e pensionit për periudhën janar 2014 - nëntor 2014, në shumën totale 205,314 lekë;
- mandat datë 19.5.2015, që vërteton tërheqjet e pensionit për periudhën dhjetor 2014 - maj 2015, në shumën totale 115,364 lekë.

101. Bazuar në përgjigjen e Postës Shqiptare, si dhe duke konsideruar faktin që babai i subjektit ka depozituar në bankë shumën 1,200,000 lekë në datën 13.2.2012, në analizën financiare për krijimin e depozitës janë përfshirë të ardhurat e pensionit të shtetasës L.B, të tërhequra deri në shkurt të vitit 2012, në vlerën totale 431,180 lekë.

102. Komisioni kreu një analizë financiare²⁶ në lidhje me mundësinë e babait të subjektit për të krijuar depozitën në BKT, duke përfshirë në momentin e dërgimit të rezultateve të hetimit:

- i. të ardhurat e babait dhe nënës së subjektit nga pensioni në shumën 1,998,792 lekë;
- ii. të ardhurat nga shtetasja F.B në shumën 343,347 lekë, pasi për pjesën tjetër nuk provohet përfitimi i tyre nga shtetasi I.B;
- iii. të ardhurat nga shtetasja L.B në shumën 431,180 lekë, pasi kjo është shuma që është tërhequr deri në vitin 2012.

103. Nga analiza financiare rezultoi se babai i subjektit të rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për furnizimin me fonde të depozitës në vitin 2011, në vlerën totale

²⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 13.10.2022, drejtuar Postës Shqiptare; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 9.11.2022, e Postës Shqiptare.

²⁶ Shihni tabelën nr. 4 të rezultateve të hetimit.

289,629 lekë dhe në vitin 2012 në vlerën totale 381,652 lekë, duke i kaluar barrën e provës subjektit. Gjithashtu, subjektit i kaloi barra e provës edhe për deklarim të pasaktë të burimit të kësaj pasurie.

104. Pas kalimit të barrës së provës, subjektit pretendoi se motra e saj vendosi të hartonte një prokurë të përgjithshme me nr. *** kol., datë 4.2.2004, përmes së cilës emëroi si përfaqësues të saj shtetasit F.B dhe I.B, duke u dhënë tagra për ta përfaqësuar së bashku ose veç e veç pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore për ndjekjen e procedurës për marrjen e pensionit, si dhe tërheqjen e tij mujore. Motra e saj është trajtuar me pension pleqërie nga data 8.5.2004 deri në datën 20.5.2015. Ndërsa shuma totale e këtij pensioni, nga data 8.5.2004 deri në datën 13.2.2012, referuar dokumentacionit të DRSSH-së Tiranë, përkon me shumën 1,521,465 lekë. Këto shuma janë tërhequr pranë Postës Shqiptare, sipas mandatpagesave përkatëse të çdo viti. Nëna e saj ka ndërruar jetë në maj të vitit 2011, ndaj për këtë arsye duhen zbritur si të ardhurat e saj nga pensioni, ashtu edhe shpenzimet jetike për periudhën maj 2011 - dhjetor 2012.

Bashkëlidhur parashtrimeve të saj subjekti ka depozituar shkresën nr. *** prot., datë 3.4.2023, të Postës Shqiptare, e cila ka mundësuar dokumentacionin e tërheqjes së pensionit të shtetas L.B në Zyrën Postare nr. 21 të vlerave monetare 155,680 lekë, tërhequr në datën 28.12.2008 dhe 186,400 lekë, tërhequr në datën 29.12.2009.

105. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit dhe provat e paraqitura prej saj, konstaton se informacioni i vënë në dispozicion të subjektit rezulton të mos jetë përfshirë në përgjigjen që Posta Shqiptare ka vënë në dispozicion të Komisionit përmes shkresës nr. *** prot., datë 9.11.2022. Për pasojë, Komisioni do të përfshijë vlerat e tërhequra nga shtetasi I.B në vitet 2008 dhe 2009, në vlerën totale 343,347 lekë. Gjithashtu, Komisioni pranoi edhe pretendimin tjetër të subjektit në lidhje me kohën e vdekjes së nënës, duke bërë ndryshimet përkatëse në analizë financiare, për sa i përket saktësisimit të shpenzimeve jetike.

106. Analiza financiare për krijimin e depozitave

Tabela nr. 4

	Viti 2010	Viti 2011	Viti 2012
Pasuria	415,332.00	1,026,000.00	1,200,000.00
<i>Ndryshim likuiditeti</i>	<i>415,332.00</i>	<i>1,026,000.00</i>	<i>1,200,000.00</i>
Detyrime	0.00	0.00	0.00
Pasuria neto	415,332.00	1,026,000.00	1,200,000.00
Të ardhura	1,081,596.00	1,280,204.00	1,606,732.00
Të ardhurat e babait të subjektit I.B nga pensioni	418,140.00	418,140.00	418,140.00
Të ardhurat e nënës së subjektit M.B nga pensioni	248,124.00	103,385.00	
Të ardhurat e motrës së subjektit L.B nga pensioni			
Të ardhurat e babait të subjektit I.B nga dëmshpërblimet e përfituara si i përndjekur politik nga MF	415,332.00	415,332.00	415,332.00
Të ardhurat e nënës së z. I.B nga diferencat e pensionit		343,347.00	
Të ardhurat e motrës së subjektit L.B për dep. 1.2 milion			773,260.00
Shpenzime	273,240.00	193,545.00	139,548.00
Mundësia për kursime	393,024.00	60,659.00	267,184.00

107. Komisioni kreu një analizë të re financiare, nga e cila rezulton se babai i subjektit ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e depozitave. Komisioni vlerëson të ndalet edhe në faktin se nëse në këtë analizë nuk përfshihen të ardhurat e përfituara nga shtetasi M. T, rezultati negativ do të ishte rreth 110,000 lekë, i cili duke marrë në konsideratë edhe faktin se babai i subjektit mund të ketë tërhequr pensionin e motrës së saj edhe për vitet e mëparshme, nuk mund të përbëjë shkak për t'u konsideruar si deklaram i pamjaftueshëm.

Në përfundim në lidhje me këtë depozitë, Komisioni konkludon se subjekti ka kryer deklaram të saktë, si dhe babai i saj ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e saj.

108. Depozitë me afat në “ProCredit Bank”²⁷, krijuar në datën 21.4.2014, në shumën 36,000 euro dhe gjendje në shumën 38,167.87 euro, në datën 19.1.2017, në emër të bashkëshortit të subjektit R.S. Subjekti ka deklaruar: *“Në këtë llogari depozitë, në datën 15.9.2014, më ka përfshirë edhe mua si bashkëshorten e tij, me dëshirën e tij. Në bashkëpronësi të pandarë”*.

Burimi i krijimit sipas deklaratës Vetting: *“a) Bashkëshorti im R.S ka pasur në pronësi të tij një apartament të ndodhur në Tiranë me sip. 101.4 m², në rrugën ‘I. D’, Tiranë, të blerë prej tij, para njohjes dhe martesës me mua. Mbi këtë pasuri ka pasur edhe një kontratë hipotekimi datë 16.5.2000, për shlyerjen prej tij të një huaje në shumën 1,900,000 lekë, për shkak të së cilës kjo pronësi është regjistruar në regjistrin e inskriptimeve nr. ***, datë 6.7.2000, në Zyrën e Hipotekës Tiranë.*

Pas rivlerësimit, ky apartament është shitur nga bashkëshorti im R.S, në vlerën 53,000 euro/7,592,440 lekë, që është diferenca ndërmjet vlerës reale të apartamentit prej 9,592,440 lekësh dhe shumës së marrë hua së bashku me interesat 2,000,000 lekë, për të cilën është inskriptuar kjo pronë në hipotekë. Nga kjo shumë e mësipërme e përfitur nga shitja e pronës së tij, bashkëshorti im R.S, në datën 21.4.2014, ka depozituar në ‘ProCredit Bank’ shumën 36,000 euro, të cilën e ka shtuar në datën 25.7.2014 në shumën 500 euro.

Nga kjo shumë e mësipërme, bashkëshorti im, në datën 22.4.2014, ka depozituar në bono thesari shumën e këmbyer në lekë prej 1,400,000 lekë/10,000 euro, duke përfitur interes në vlerën 45,519 lekë.

*b) Në ‘ProCredit Bank’ bashkëshorti im R.S ka hapur në datën 15.9.2014 një llogari rrjedhëse në euro, për depozitim në këtë llogari të pjesës takuese të qirasë që ai e përfiton si bashkëpronar në pasurinë godinë 3 kate në Rr e D, pronë në bashkëpronësi, përfitur si njëri nga dy trashëgimtarët ligjorë të nënës së tij G.S(A), pronë e dhënë me qira shoqërisë ‘***’ sh.p.k., për ta përdorur për mësimdhënie.*

²⁷ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) nxjerrje llogarie datë 19.1.2017, nga “ProCredit Bank”; (ii) certifikatë martesë datë 20.1.2017; (iii) kontratë dhurimi nr. ***, datë 16.2.1999, planimetria dhe harta treguese; (iv) kontratë shitjeje nr. ***, datë 20.8.2013, e lidhur midis shitësit R.S dhe blerësit A.B; (v) deklaratë noteriale nr. ***, datë 20.8.2013, me deklarues A.B, V.B dhe R.S; (vi) kontratë hipotekimi nr. ***, datë 16.5.2000, e lidhur midis huadhënësit A.B dhe huamarrësit R.S; (vii) kontratë qiraje datë 4.6.2014; (viii) kontratë qiraje nr. ***, datë 6.7.2015; (ix) nxjerrje llogarie datë 18.10.2016, nga “ProCredit Bank”, në emër të shtetasit R.S, për periudhën 15.9.2014 – 18.10.2016; (x) nxjerrje llogarie datë 11.12.2015, nga “ProCredit Bank”, në emër të shtetasit R.S për periudhën 1.1.2015 - 11.12.2015; (xi) kartela e klientit R.S nr. ***, e lëshuar nga Banka e Shqipërisë, datë 11.10.2016, për periudhën 1.1.2006 – 8.1.2015; (xii) kartela e klientit R.S nr. ***, datë 11.10.2016, e lëshuar nga Banka e Shqipërisë, për periudhën 1.1.2006 – 8.1.2015; (xiii) kartela e klientit R.S nr. ***, datë 11.10.2016, nga Banka e Shqipërisë, për periudhën 1.1.2006 – 8.1.2015.

Në datën 11.12.2015 bashkëshorti im R.S e ka mbyllur këtë llogari rrjedhëse në 'ProCredit Bank', duke e depozituar pjesën e tij takuese të qirasë në vlerën 7,602 në llogarinë në euro, kontratë/llogari kursime individuale të 'ProCredit Bank', duke rezultuar llogaria në vlerën progresive (36,500 + 7,602) 44,102 euro.

Nga kjo llogari janë tërhequr 3,000 euro në datën 23.9.2016 dhe 3,000 euro në datën 4.10.2016, për probleme shëndetësore, duke rezultuar gjendje së bashku me interesat në datën 19.1.2017 prej 38,168.87 euro".

Konstatimi i ILDKPKI-së

- Është e paqartë marrëdhënia që bashkëshorti i subjektit R.S ka me shtetasin M.S dhe arsyeya që ka shtyrë këtë të fundit t'i dhurojë apartamentin me sip. 101.4 m², të ndodhur në Tiranë.
- Bashkëshorti i subjektit në deklaratat e interesave privatë periodikë vjetorë 2013 ka deklaruar shitjen e apartamentit me sip. 101.4 m², në vlerën 53,000 euro. Shuma e përfutur nga shitja nuk është deklaruar në gjendje cash, për t'u pakësuar në vijim për hapjen e depozitës në shumën 36,000 euro në vitin 2014.
- Në deklaratën e interesave privatë periodikë vjetorë 2003, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar apartament me sip. 101.4 m² në Tiranë, mbi të cilin ka një kontratë hipoteke në shumën 1,900,000 lekë. Rrjedhimisht, rezulton mosdeklarimi i detyrimit financiar prej 1,900,000 lekësh në deklaratat e interesave privatë 2004 – 2012.
- Rezulton se në deklaratën e interesave privatë periodikë vjetorë 2013, shitja e apartamentit me sip. 101.4 m² në Tiranë deklarohet në shumën 53,000 euro dhe jo në vlerën reale rreth 9,592,440 lekë. Nga kjo vlerë është mbajtur shuma 2,000,000 lekë, si detyrim i pashlyer ndaj blerësit, detyrim i cili nuk është deklaruar i shlyer në këtë deklaratë.

Hetimi²⁸/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

109. Nga nxjerrja e llogarisë së bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në "ProCredit Bank" rezulton se në datën 15.9.2014 ai ka çelur llogarinë rrjedhëse nr. ***, në të cilën depozitohen vlerat e qirave mujore për vitet 2014 - 2015, në total 12,074 euro. Në datën 6.12.2015 gjendja e llogarisë është 7,602.48 euro. Në vijim, bashkëshorti i subjektit ka çelur llogari depozitë nr. *** në euro, në të cilën ka kryer depozitimet si vijon:

- i. në datën 21.4.2014 ka depozituar shumën 36,000 euro, nën komentin "dep. R.S të ardhura nga shitja e pronës cash deposit";
- ii. në datën 25.7.2014 bashkëshorti i subjektit ka depozituar cash 500 euro;
- iii. në datën 11.12.2015 shtetasi R.S transferon nga llogaria nr. *** shumën 7,602.18 euro;
- iv. në datat 23.9.2016 dhe 4.10.2016 ka kryer tërheqje, përkatësisht nga 3,000 euro;
- v. pas veprimeve bankare të mësipërme gjendja e depozitës në datën 1.1.2017 është 38,167.87 euro.

²⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 18.9.2020, drejtuar bankave të nivelit të dytë; shkresë kthim përgjigjeje nr. OP-*** prot., datë 30.9.2020, e "ProCredit Bank"; shkresë nr. *** prot., datë 18.9.2020, drejtuar ASHK-së; shkresë kthim përgjigjeje nr.*** prot., datë 13.10.2020, e ASHK-së; shkresë nr. *** prot., datë 21.9.2022, drejtuar ASHK-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 6.10.2022, e ASHK-së.

Në lidhje me burimin e krijimit të depozitës

110. Si burim për krijimin e depozitës, subjekti ka deklaruar:

- a) të ardhurat e krijuara nga bashkëshorti i saj, përmes shitjes së apartamentit me sip. 101.4 m², në rrugën “I. D”, Tiranë, në vlerën 36,000 euro;
- b) gjendjen e depozitës bankare të hapur nga shtetasi R.S pranë “ProCredit Bank” në datën 15.9.2014, me vlerë 7,602 euro.

Në lidhje me të ardhurat e krijuara nga shitja e pasurisë apartament, nga hetimi i kryer nga Komisioni ka rezultuar:

111. Me kontratë dhurimi nr. ***, datë 16.2.1999, shtetasi M.S i ka dhuruar bashkëshortit të subjektit pasurinë apartament me sip. 101.4 m², në rrugën “I. D”. Mbi bazën e kësaj kontrate apartamenti është regjistruar në pronësi të shtetasi R.S, i cili është pajisur fillimisht me vërtetim hipotekor datë 26.5.2000, e në vijim me certifikatë pronësie datë 18.7.2013. Në lidhje me këtë pasuri, Komisioni nuk ka hetuar, pasi është krijuar para detyre dhe para martesës së subjektit.

112. Mbi këtë apartament është vendosur barrë hipotekore në favor të shtetasit A.B, sipas kontratës së hipotekimit nr. ***, datë 16.5.2000. Referuar përmbajtjes së kësaj kontrate, huadhënësi A.B ka dhënë hua në favor të huamarrësit R.S shumën 1,900,000 lekë, me interes për të gjithë periudhën 100,000 lekë. Huamarrësi angazhohet t’i shlyejë huadhënësit shumën e dhënë së bashku me interesat në vlerën totale prej 2,000,000 lekësh në datën 16.11.2001. Referuar vërtetimit të hipotekimit, kjo kontratë është regjistruar në ZVRPP në datën 6.7.2000.

113. Në vijim, me kontratë shitjeje nr. ***, datë 20.8.2013, bashkëshorti i subjektit dhe subjekti, në cilësinë e “dhënësit të pëlqimit”, kanë shitur këtë apartament në favor të blerësit (dhe përfituesit të hipotekës) A.B për çmimin 9,592,440 lekë, vlerë e cila deklarohet e likuiduar jashtë zyrës noteriale. Referuar kartelës së pasurisë që i bashkëlidhet kontratës së shitblerjes, rezulton se ky apartament është rivlerësuar me vlerën 9,592,440 lekë, vlerë për të cilën bashkëshorti i subjektit ka paguar edhe detyrimet tatimore për rivlerësimin e pasurisë.

Nga dokumentacioni i ASHK-së evidentohet gjithashtu edhe pagimi i detyrimeve tatimore për shitjen e kësaj pasurie, kryer nga blerësi A. B në datën 22.8.2013.

114. Bashkëlidhur kontratës së shitblerjes është depozituar deklarata noteriale nr. ***, datë 2.8.2013, nënshkruar nga deklaruesit R.S dhe A.B. Në përmbajtje të këtij akti, bashkëshorti i subjektit deklaroi: *“Me deklaratën nr. ***, datë 16.5.2000, redaktuar nga notere K.P, kam dhënë²⁹ në formë huaje një shumë prej 1,900,000 lekësh, me garanci apartamentin e ndodhur në Tiranë në rr. ‘I. D’, me sip. 101.4 m². Ky apartament do t’i kalojë në pronësi z. A.B. Meqenëse aktualisht vlera e apartamentit me çmimet e tregut sot e kalon në masë të konsiderueshme shumën e marrë hua, sipas kontratës së mësipërme, nisur nga marrëdhëniet e afërsisë familjare me njëri-tjetrin, z. R.S dhe z. A.B kanë rënë dakord si më poshtë: z. A.B t’i kthejë z. R.S shumën prej 53,000 euro, që del nga diferenca e vlerës reale të apartamentit, sot me çmimet e tregut dhe shumës së marrë hua + interesat prej 2,000,000 lekësh, për të cilën u*

²⁹ Nga përmbajtja e deklaratës duket se togfjalëshi “kam dhënë në formë huaje” është lapsus në formulim, pasi në vijim të dokumentit, si dhe bazuar në kontratën e hipotekimit datë 16.5.2000, qartësohet se kemi të bëjmë me “huamarrje” të shtetasit R.S.

bllokua prona. Z. S deklaron se e ka marrë këtë shumë dhe nuk ka asnjë pretendim dhe detyrim të mëtejshëm financiar”.

115. Komisioni ka pyetur subjektin lidhur me arsyen e huamarrjes së shumës 1,900,000 lekë nga bashkëshorti i saj, përdorimin e kësaj shume, si dhe burimin e ligjshëm të të ardhurave të huadhënësve. Në përgjigje të pyetësorit datë 19.10.2022, subjekti ka deklaruar: *“Nga bashkëshorti jam vënë në dijeni se në kushtet kur prindërit e A.B mbetën të pastrehë, bashkëshorti dhe nëna e tij, për shkak të marrëdhënieve të ngushta (motra) në këtë moment të vështire për ta i ka ofruar që të banonin në shtëpinë pronë e bashkëshortit. Disa muaj pasi filluan të jetonin në këtë shtëpi djali i tezes së bashkëshortit A.B ka shprehur dëshirën që kjo banesë të blihej për familjen e tij. Duke qenë se teza znj. V.B me bashkëshortin e saj dispononin afërsisht 2,000,000 lekë për të siguruar blerjen e saj në të ardhmen, bashkëshorti dhe A.B lidhën një kontratë huaje në shumën 1,900,000 lekë, e cila në datën 16.5.2000 u vendos si kontratë hipotekimi. Kjo shumë është konsideruar gjithmonë një kapar për blerjen që do të bëhej prej tyre në të ardhmen. Kjo pronësi është regjistruar në regjistrin e inskriptimeve nr. ***, datë 6.7.2000 (bashkëlidhur dokumentet). Ata nuk kanë mundur që të finalizonin shitjen e apartamentit, për shkak të problemeve të pronësisë me truallin mbi të cilin është ndërtuar pallati. Me zgjidhjen e këtij problemi (problem prej të cilit bashkëshorti nuk mund të pajisej me certifikatë pronësie) bashkëshorti u pajis me certifikatën e pronësisë në datën 18.7.2013 dhe u vijua me procedurat e shitjes. Dua të theksoj se të gjitha veprimet e kryera për pagesën e kaparit janë bërë nga bashkëshorti im para njohjes dhe martesës me mua”.* Subjekti në përgjigje të këtij pyetësi nuk ka deklaruar se për çfarë është përdorur shuma 1,900,000 lekë.

116. Nga shqyrtimi i deklarimeve periodike të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj, rezulton se:

i. Në DPV/2003 bashkëshorti i subjektit ka deklaruar: *“Apartament banimi ndërtuar në vitin 1990, me sip. 101.4 m², me pjesë zotëruese 100%. Burimi i krijimit: kontratë dhurimi nr. ***, datë 16.2.1999, me dhurues M.S, apartament mbi të cilin ka kontratë hipotekimi nr. ***, datë 16.5.2000, për shlyerjen e huas prej 1,900,000 lekësh kushëririt tim A.B, banues në B, Gjermani”.*

ii. Në rubrikën “ndryshimet e pasurive dhe krijimi i tyre”, në DPV/2013, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar: *“Shitje e një apartamenti të ndodhur në z. k. ***, me nr. pasurie ***, vol. **, f. ***, me sip. 101.4 m², në rrugën ‘I. D’, me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 20.8.2013, në shumën 53,000 euro”.*

117. Në lidhje me këtë shumë, subjekti, në deklaratën *Vetting*, ka deklaruar: *“Pas rivlerësimit ky apartament është shitur nga bashkëshorti im R.S me kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.8.2013 dhe deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.8.2013, në vlerën 53,000 euro/7,592,440 lekë, që është diferenca ndërmjet vlerës reale të apartamentit prej 9,592,440 lekësh dhe shumës së marrë hua së bashku me interesat 2,000,000 lekë, për të cilën është inskriptuar kjo pronë në hipotekë”.*

118. Komisioni ka konstatuar se deklarimi i subjektit gjatë hetimit administrativ nuk përputhet me deklaratimet e saj në deklaratën *Vetting*, por edhe me deklaratat periodike. Subjekti nuk ka dhënë shpjegime në lidhje se për çfarë është përdorur shuma 1,900,000 lekë, e pretenduar si e marrë hua. Në lidhje me këto dy konstatime subjektit iu kalua barra e provës. Subjekti

shpjegimet në lidhje me këtë barrë prove i ka dhënë të përbashkëta me barrën e provës për gjendjen *cash* në shumën 50,000 euro.

119. Në kushtet kur nga subjekti është deklaruar në deklaratën *Vetting* një hua e marrë nga bashkëshorti i saj, pavarësisht formës së saj, ajo kishte detyrimin ligjor për të justifikuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të familjes B për dhënien e shumës 1,900,000 lekë, duke marrë në konsideratë edhe faktin që kjo shumë ka shërbyer për krijimin e depozitave të bashkëshortit pas martese. Nga ana e subjektit nuk është depozituar dokumentacion provues për të ardhurat e ligjshme të z. B, por ka deklaruar se nëna e tij ka të njëjtat të ardhura nga qiraja si nëna e bashkëshortit të saj, znj. G.S.

120. Nga verifikimi i të ardhurave nga qiraja rezulton se shtetasja V.B ka përfituar deri në prill të vitit 2000 shumën 1,493,549.85 lekë, e cila është e pamjaftueshme për të mbuluar dhënien e huas në shumën 1,900,000 lekë. Në analizë nuk janë përfshirë shpenzimet jetike, por edhe shpenzimet e tjera të familjes B.

Për sa më sipër, duket se shtetasi A.B nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për t'i dhënë hua bashkëshortit të subjektit në shumën 406,451 lekë. Për këtë subjektin iu kalua barra e provës. Subjekti shpjegimet në lidhje me këtë barrë prove i ka dhënë të përbashkëta me barrën e provës për gjendjen *cash* në shumën 50,000 euro.

121. Nga analizimi i dokumentacionit të mësipërm rezulton se nga shitja e apartamentit me sip. 101.4 m², në rrugën "I. D", subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë përfituar jashtë sistemit bankar vlerën 53,000 euro. Nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore të subjektit konstatohet se bashkëshorti i subjektit në vitin 2013 ka deklaruar shitjen e këtij apartamenti në shumën 53,000 euro. Nga ana e subjektit, por edhe e bashkëshortit të saj, nuk rezulton që këtë vit të jetë deklaruar gjendje *cash* në shumën 53,000 euro.

122. Në DPV/2014 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: "*Bashkëshorti im R.S ka shitur apartamentin sipas kontratës së datës 20.8.2013, në shumën 53,000 euro, të cilën e ka deklaruar në deklaratën e vitit 2014. Nga kjo shumë e mësipërme R.S ka depozituar në 'ProCredit Bank' shumën 36,000 euro në datën 21.4.2014. Në këtë llogari ka shtuar në datën 25.7.2014 shumën 500 euro dhe në datën 25.7.2014 më ka përfshirë edhe mua, si bashkëshorten e tij. Nga kjo shumë e mësipërme ai ka depozituar më 22.4.2014 në bono thesari shumën 1,400,000 lekë...*".

123. Në shpjegimet e dhëna pranë ILDKPKI-së më 2.7.2015, në lidhje me shitjen e apartamentit me sip. 101.4 m² dhe gjendjen *cash* në fund të vitit 2013, subjekti ka deklaruar: "*Gjendja cash deri në datën 31.12.2013 është në vlerën 50,000 euro, të përfituara nga shitja e apartamentit. Lidhur me këtë vlerë një pjesë e tyre janë depozituar në vitin 2014, fakt të cilin e kam pasqyruar në DPV/2014*".

124. Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar pasaktësitë në deklarimin e gjendjes *cash* në fund të çdo viti, duke theksuar se ka qenë e paqartë për deklarimin e tyre. Në lidhje me vlerën e përfituar nga shitja e pasurisë apartament me sip. 101.4 m², subjekti ka sqaruar: "*Në DPV/2014 kam deklaruar se nga shuma 53,000 euro nga shitja e apartamentit më 20.8.2013, bashkëshorti ka depozituar në 'ProCredit Bank' shumën 36,000 euro në datën 21.4.2014*".

125. Komisioni, bazuar në:

- a. deklarinimet kontradiktore të subjektit të rivlerësimit në lidhje me marrëdhënien juridike të pasurisë apartament midis bashkëshortit të saj dhe z. B;
- b. përcaktimin në kontratë se shuma 53,000 euro është likuiduar jashtë zyrës noteriale, duke mos u cilësuar koha e kryerjes së pagesës;
- c. kryerjen e pagesës *cash*, ndërkohë që kjo pagesë duhej të bëhej nëpërmjet sistemit bankar;
- d. mungesën e dokumentacionit provues bankar/jobankar për pagesën e shumës 53,000 euro nga z. B;
- e. kohën e gjatë (më shumë se 10 vjet) të kaluar nga marrja në përdorim e banesës nga z. B dhe lidhjes së kontratës së shitjes;
- f. mosdeklarimin e shumës 53,000 euro si kursim *cash* në DPV/2013;
- g. deklarinimet e subjektit se huaja në fakt ishte një kapar për blerjen e apartamentit,

– ka ngritur dyshime se apartamenti mund të jetë shitur *de facto* në vitin 2000, duke u kryer edhe likuidimi i tij dhe në vitin 2013 është lidhur kontrata e shitblerjes me qëllim kalimin e pronësisë tek z. B.

Për rrjedhojë, shuma 53,000 euro nuk është përfshirë në analizë financiare, duke mos u konsideruar as si kursim *cash*.

126. Nga analiza financiare³⁰ duket se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e kësaj depozite në shumën 5,860,171 lekë. Në këtë analizë nuk janë përfshirë kursimet *cash* në shumën 50,000 euro. Për këtë subjektit iu kalua barra e provës.

127. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti fillimisht ka analizuar veprimet e shitjes së kësaj pasurie, duke vijuar më tej për të dhënë shpjegime në lidhje me mosdeklarimin e destinacionit të shumës 1,900,000 lekë. Subjekti sqaron se kjo shumë është përdorur nga bashkëshorti dhe familja e tij në vitin 2000, në një kohë kur ajo nuk ka qenë jo vetëm subjekt deklarimi i ligjit, por as e martuar me të, çfarë nuk mund ta bëhet objekt i hetimit të këtij procesi, pasi nuk ndikon në analizën financiare të periudhës të rivlerësimit dhe as nuk është përdorur për krijimin e ndonjë pasurie. Këtë përgjigje e ka sqaruar edhe në pyetësonin nr. 1, datë 19.10.2022, depozituar pranë Komisionit më 1.11.2022, ku ka sqaruar: “*Dua të theksoj se të gjitha veprimet e kryera për pagesën e kaparit janë bërë nga bashkëshorti im para njohjes dhe martesës me mua*”. Për këtë arsye, subjekti deklaroi se nuk është e detyruar të deklarojë përdorimin e të ardhurave të familjes së bashkëshortit të saj përpara martesë, pasi nuk i shërben këtij procesi rivlerësimit dhe as nuk ndikon në analizën financiare të të ardhurave të familjes.

128. Shuma prej 1,900,000 lekësh, për sa kohë nuk është deklaruar si e ardhur apo si burim për krijimin e depozitave, duhet t’i jetë bashkuar të ardhurave të tjera të familjes së bashkëshortit. Duke qenë se në atë periudhë nuk njihet me të dhe ai nuk ka pasur detyrim për deklarim, ai nuk kujton me ekzaktësi çfarë ka bërë me këtë shumë, por shprehet se me siguri është bashkuar me kursimet e tjera të familjes të menaxhuara nga nëna e tij G.S.

129. Në kontratën e vitit 2000 përcaktohet se shtetasi R.S do të merrte hua shumën prej 1,900,000 lekësh dhe si pasojë e kësaj, për sigurimin e kësaj shume, është inkskriptuar si hipotekim apartamenti me sip. 101.4 m². Ndërkohë, duke qenë se ka pasur probleme të pronësisë me truallin mbi të cilën ishte ndërtuar pallati, nuk u bë i mundur tjetërsimi i plotë i apartamentit në fjalë. Pas zgjidhjes së problematikës së truallit dhe në momentin kur

³⁰ Shihni tabelën nr. 5 të rezultateve të hetimit.

bashkëshorti u pajis me certifikatë pronësie, u bë i mundur kalimi i pronësisë dhe likuidimi i vlerës së mbetur nga çmimi total i apartamentit.

130. Neni 601 i Kodit Civil përcakton se kapar quhet shuma në të holla që njëra nga palët i jep tjetrës për llogari të shumës që do t'i paguhet në bazë të kontratës, me qëllim që të vërtetojë lidhjen e kontratës dhe të sigurojë ekzekutimin e saj dhe, ndërkohë, kontrata e huas, e cila u lidh në vitin 2000, sikurse rezulton nga aktet, u inskriptua pranë hipotekës, me qëllim sigurimin e zbatimit të kontratës. Pavarësisht titullit në hyrje të kontratës, kjo marrëveshje në thelb përbën kontratë kapari, pasi:

- *Shtetasit V dhe Sh.B, si dhe djali i tyre A.B, kanë jetuar në këtë banesë që në vitin 2000.*
- *Kontrata është finalizuar në datën 20.8.2013, pas daljes së certifikatës së pronësisë dhe rivlerësimit të kësaj prone.*
- *Kjo pasuri, nga viti 2000 e deri tani, nuk është poseduar asnjëherë nga bashkëshorti dhe aq më pak nga subjekti.*
- *Këtë pasuri e ka deklaruar rregullisht duke filluar që nga DPV/2003, sikurse edhe në deklaratën Vetting dhe asnjëherë nuk ka ndryshuar rrjedhën e veprimeve juridike të kryera, por i ka deklaruar saktësisht ato.*

131. Lidhur me likuidimin e kësaj shume, sikundër del qartë në kontratë, kjo pagesë është kryer përpara nënshkrimit të kontratës, pak ditë përpara, ku më pas janë kryer veprimet për regjistrimin e këtij akti noterial në regjistrat publikë të pasurive të paluajtshme. Çmimi i kësaj pasurie është përlllogaritur pas kryerjes së rivlerësimit të kësaj pasurie, ku, po t'i referohesh udhëzimit nr. 362, datë 17.7.2000, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB-ja të vlerave mesatare të tregut të lirë të banesave dhe të koeficientit ‘K’ datë...”, vlera mesatare e apartamenteve tip, tregu i lirë, për qytetin e Tiranës është 53,400 lekë/m², shumëzuar me sipërfaqen e pasurisë 101.4 m², vlera totale e apartamentit, vetëm në vitin 2000, shkonte në shumën 5,414,760 lekë, pra dukshëm shumë më lart se shuma e parë e dhënë në vlerën 1,900,000 lekë. Nisur vetëm nga ky fakt, nuk përbën sens financiar dhe logjik që kjo shumë prej 1,900,000 lekësh të ketë shërbyer si shumë e vetme për pagimin e çmimit të tjetërsimit të kësaj pasurie.

132. Lidhur me mungesën e dokumentacionit bankar për pagimin e çmimit, subjekti sqaron se në vitin 2013, sikundër njihet botërisht edhe nga praktikat e mëparshme, transaksionet e pasurive mund të kryheshin edhe jashtë sistemit bankar, pra nuk ka qenë kusht i domosdoshëm kalimi i shumës nëpërmjet një transaksioni bankar. Detyrimi për krijimin e një llogarie të posaçme përpara noterit ka hyrë në fuqi vetëm pas miratimit të udhëzimit të ministrit të Drejtësisë nr. 16, datë 30.7.2020, “Për përcaktimin e rregullave për trajtimin e transaksioneve financiare të noterit dhe të fondeve të një klienti ose të një pale të tretë”, pra shumë vite më vonë nga hartimi i këtij akti noterial.

133. Kontrata e shitblerjes është regjistruar në regjistrat publikë të pasurive të paluajtshme; janë paguar të gjitha detyrimet tatimore në lidhje me çmimin e paguar; janë kryer veprimet e kalimit të pronësisë nga pala shitëse tek pala blerëse dhe është lëshuar certifikata e pronësisë në emër të palës blerëse. Po kështu, pala blerëse ka pasur burime mëse të mjaftueshme financiare për ta blerë këtë pasuri, për shkak të argumenteve që do të paraqiten përmes parashtrimeve.

Pra, analiza e rrethanave të faktit tregon se nuk ka qenë e nevojshme mbulimi i ndonjë veprimi juridik me ndonjë veprim tjetër fiktiv apo të simuluar, në kushtet kur kontrata e shitblerjes së apartamentit në Tiranë ishte e mbuluar dhe tërësisht e justifikuar.

Logjika e mësipërme në arsyetim gjen bazë dhe konfirmohet edhe në praktikën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit për çështje të ngjashme, si në rastin e vendimit nr. 22 datë 16.9.2019.

134. Shtetasi A.B është në cilësinë e blerësit të apartamentit të shitur nga bashkëshorti i saj, pozitë e cila nuk e ngarkon me detyrimin për të provuar ligjshmërinë e burimit të të ardhurave që ai i ka dhënë bashkëshortit, pasi shuma përkatëse nuk është as e dhuruar dhe as hua, por është dhënë si çmim për blerjen e pasurisë. Ky konkluzion gjen pasqyrim edhe në praktikën e unifikuar të Kolegjit³¹.

135. Lidhur me konstatimin e Komisionit se shtetasi A.B nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për t'i dhënë hua bashkëshortit të subjektit shumë 406,451 lekë, subjekti pretendon se nga analiza e të ardhurave nga qiratë, kryer nga Komisioni, vë re se në analizë janë përfshirë të ardhurat nga dy kontratat, por nuk janë përfshirë të ardhurat për qiratë e tjera, për të cilat Komisioni ka vërtetuar pagimin e tatimeve të familjes A. Shuma e të ardhurave të qirasë së familjes së shtetasit R.S është 5,847,547 lekë. Kjo shumë është e njëjtë edhe për familjen e shtetasit A.B, të cilët përfitojnë njëloj mbi këtë pasuri në bashkëpronësi. Pra, është e qartë që shtetasi A.B ka pasur të ardhura të mjaftueshme për dhënien e kësaj shume prej 1,900,000 lekësh.

136. Në lidhje me të ardhurat e shtetasit A.B për pagesën e shumës 53,000 euro për blerjen e pasurisë apartament, subjekti ka paraqitur bashkëlidhur parashtrimeve të saj dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Deklaratë noteriale datë 29.3.2023, e hartuar në B, Gjermani, nga shtetasi A.B, i cili deklaron se apartamenti është përdorur nga prindërit e tij nga viti 2000 e në vijim, falë ndihmës së ofruar nga shtetasi R.S. Ai deklaron se prindërit e tij kanë pasur shumën 1,900,000 lekë, që e siguruan për blerjen e apartamentit, vlerë të cilën deklaruesi shprehet se ia ka dhënë hua shtetasit R.S, duke e konsideruar si kapar për blerjen e apartamentit në të ardhmen. Ai ka sqaruar se në vitin e blerjes së apartamentit, 2013, kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e apartamentit, të siguruara nga qiradhënia nga godina dhe dyqanet nga viti 1994 e në vijim; të ardhurat nga shitja e tokës me sip. 500 m² në vitin 2007, në vlerën 80,000 euro; të ardhurat e krijuara nga kthimi i vlerës 12,000 euro nga shtetasi R.S në Gjermani në vitin 2011. Ai thekson se si shtetas i punësuar në Gjermani nga viti 1989 ka pasur gjithnjë mundësi financiare.
- b) Vërtetim datë 28.3.2023, i Universitetit B, Gjermani, lidhur me punësimin e shtetasit A. B si drejtues i grupit kërkimor dhe pedagog pranë këtij universiteti prej vitit 2010.
- c) Shkresë datë 13.11.1997, e O.E të M.M, ku citohet transferimi i kësteve tremujore të bursës së shtetasit A. B në Deutsche Bank.
- d) Shkresë datë 3.11.1997, e Deutsche Bank, lidhur me transferimet e fondeve nga urdhërpagesat e ***-s.

³¹ Në vendimin nr. 21, datë 10.9.2020, që i përket subjektit të rivlerësimit R.J.

- e) Vërtetim datë 24.5.2002, i “C.N”, përmes të cilit vërtetohet se shtetasi A. B ka qenë student post doktoral në laboratorin e kësaj qendre në periudhën 1.5.1996 – 31.1.1999, si dhe *curriculum vitae* i këtij shtetasi.
- f) Shkresë nr. *** prot., datë 28.3.2023, e ASHK Drejtoria Vendore Tirana Rurale 1, të cilës i bashkëlidhet kontrata e shitjes nr. *** lidhur në nëntor të vitit 2007, përmes së cilës shtetasi A.B ka shitur pasurinë tokë arë me sip. 500 m², ndodhur në Sauk, Tiranë, kundrejt çmimit 80,000 euro.
- g) Pasqyrim i veprimeve bankare dhe certifikatë regjistrimi për sigurimet shoqërore e shtetasit A.B në shtetin gjerman.

137. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti, konstaton se:

- i. Familja B ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për dhënien e huas në vlerën 1,900,000 lekë, pasi nga vlera e tatimit të paguar, por edhe nga kontratat e qirave të depozituara nga subjekti, rezulton se familja B ka përfituar shumën 4,545,630.38 lekë deri në vitin 2000.
- ii. Huaja është marrë në një kohë kur subjekti nuk ka qenë e martuar me z. S, për rrjedhojë, Komisioni nuk mund të vlerësojë këtë hua në procesin e rivlerësimit të subjektit, duke marrë në konsideratë edhe faktin që ajo nuk është deklaruar si burim për asnjë pasuri të subjektit.
- iii. Apartamenti i shitur nga subjekti është rivlerësuar me vlerën e tij në vitin 2013 dhe jo me vlerën që ka pasur në vitin 2000, duke rënë në këtë mënyrë dyshimi për një pagesë të plotë në këtë vit.
- iv. Pagesa e këtij apartamenti është konfirmuar me deklaratën noteriale nr. ***, datë 2.8.2013. Në përmbajtje të këtij akti bashkëshorti i subjektit deklaron: *“Ky apartament do t’i kalojë në pronësi z. A.B. Meqenëse aktualisht vlera e apartamentit me çmimet e tregut sot e kalon në masë të konsiderueshme shumën e marrë hua, sipas kontratës së mësipërme, nisur nga marrëdhëniet e afërsisë familjare me njëri-tjetrin, z. R.S dhe z. A. B kanë rënë dakord si më poshtë: z. A.B t’i kthejë z. R.S shumën prej 53,000 euro, që del nga diferenca e vlerës reale të apartamentit, sot me çmimet e tregut dhe shumës së marrë hua + interesat prej 2,000,000 lekësh”*.
- v. Subjekti e ka deklaruar shumën 50,000 euro si burim për krijimin e kësaj depozite në vitin 2014, si dhe në procesverbalin e ILDKPKI-së, duke korrigjuar në këtë mënyrë pasaktësinë e vitit 2013.
- vi. Subjekti rezulton me një bilanc pozitiv në vitin 2013, në shumën 8,600,000 lekë, e cila është e konsiderueshme dhe nuk mund të jetë shpenzuar nga subjekti brenda këtij viti. Për më tepër, në këtë periudhë subjekti nuk ka kryer blerje të ndonjë pasurie të luajtshme apo të paluajtshme apo ndonjë investim/shpenzim tjetër.

138. Për rrjedhojë, Komisioni, duke marrë në konsideratë faktet e analizuara më sipër, arsyeton se kemi të bëjmë me një pasaktësi, e cila nuk shoqërohet me mungesë burimesh të ligjshme për krijimin e saj, që është korrigjuar nga subjekti në deklaratimet e saj si në DPV, ashtu edhe në ILDKPKI, si dhe është deklaruar si burim në krijimin e pasurisë (llogarisë bankare) nga bashkëshorti i saj. Gjithashtu, ky burim lidhet me një pasuri të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit të krijuar para martesës, e cila ka prodhuar këtë situatë disa vite me vonë për shkak

një marrëdhënieje të posaçme mes palëve. Trupi gjykues, në vlerësim të fakteve dhe rrethanave, ku subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë likuiditete dhe mjete financiare që kënaqin kërkesat e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, nuk rezulton të kenë kryer shpenzime apo krijuar pasuri të paluajtshme, krijojnë bindjen se pasaktësitë e krijuara për shkak të deklarimeve ndër vite mbeten shkaqe të veçuara të cilat, megjithëse përsëriten, nuk krijojnë dyshime për qëllime të tjera si fshehje pasurie apo deklarime të rreme dhe, për pasojë, vlerëson se nuk mund të përbëjnë shkak të mjaftueshëm për aplikimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Në këtë vlerësim, trupi gjykues ka pranuar të konsiderojë shumën 50,000 euro si kursim *cash* të subjektit në vitin 2013, duke e përfshirë atë në analizën financiare të subjektit. Ky qëndrim i Komisionit mbështet edhe në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit³².

139. Në vijim të përfshirjes së shumës 50,000 euro si kursim *cash*, Komisioni ka ribërë analizën për krijimin e depozitës në shumën 36,000 euro.

Analiza financiare

Tabela nr. 5

	Prill 2014
Pasuria	-471,040.00
<i>Ndryshim likuiditeti</i>	<i>-471,040.00</i>
Detyrime	0.00
Pasuria neto	-471,040.00
Të ardhura	803,786.29
Të ardhurat e subjektit Fahrije Stringa Budo	468,514.33
Të ardhurat nga qiratë	201,395.08
Të ardhura nga interesat e depozitave	133,876.87
Shpenzime	146,665.33
Shpenzime jetike	146,665.33
Mundësia për kursime	1,128,160.95

140. Nga analiza financiare rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e kësaj depozite.

Në lidhje me të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti i subjektit nga fondet e akumuluar në llogarinë rrjedhëse në “ProCredit Bank” deri në datën e mbylljes së llogarisë 11.12.2015

141. Nga nxjerrja e llogarisë nr. ***, të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në “ProCredit Bank”, rezulton se vlera 7,602.48 euro është krijuar nga të ardhurat e qirave, vërtetuar nga kreditimet e evidentuara në këtë llogari. Komisioni nuk evidentoi paqartësi në lidhje me këtë burim të depozitës bankare.

✓ Në përfundim konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë depozitë, si dhe subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e saj.

³² Vendimet: nr. 9/2020 (JR); nr. 16/2022 (JR); nr. 37/2021 (JR); nr. 20/2022 (JR); nr. 33/2021 (JR); nr. 1/2022 (JR); nr.27/2022.

142. Depozitë me afat në Bankën Kombëtare Tregtare³³, në emër të bashkëshortit të subjektit, z. R.S, e krijuar në maj të vitit 2010 në vlerën 20,000 euro dhe gjendje së bashku me interesat në datën 19.1.2017 në shumën 36,160.68 euro. Subjekti ka deklaruar: “Në këtë depozitë, më ka përfshirë edhe mua si bashkëshorten e tij, me dëshirën e tij”.

Burimi i krijimit sipas deklaratës Vetting: “Kjo shumë, sipas statement-it bankar të Bankës së Shqipërisë, është tërheqja në datën 7.5.2010 nga bashkëshorti im R.S prej llogarisë së tij në bono thesari, në shumën 1,983,306 lekë, e konvertuar në euro në vlerën përkatëse prej 14,546 euro.

Kësaj shume i ka shtuar edhe shumën 5,454 euro, me të ardhura nga tërheqja e interesave në bono thesari, datë 5.11.2009, në total në vlerën 458,091 lekë/rreth 3,360 euro, si dhe të ardhura nga qiratë e dy dyqaneve dhe godinës në Rr e D, Tiranë, rreth 2,000 euro (gusht 2009 - prill 2010/9 muaj x 337.5 USD/muaj = 3,000 USD).

Kjo llogari depozite është shtuar në 10 maj 2012 në vlerën 13,000 euro, që përbëhet nga: të ardhurat nga qiratë e vitit 2010 (maj 2010 - shtator 2010/5 muaj x 337.5 = 1,700 USD/rreth 1,370 euro) nga shitja e autoveturës në vlerën 5,000 euro (shihni kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.2.2012) dhe shuma e mbetur prej 6,630 euro, e cila rezulton nga tërheqja pranë bankës ‘S.G.A’.

Në këtë llogari bankare bashkëshorti im R.S në datën 14.5.2015 më ka përfshirë edhe mua si bashkëshorte e tij, me dëshirën e tij. Vlera: 36,160.68 euro. Pjesa takuese: në bashkëpronësi të pandarë”.

Hetimi³⁴/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

143. Nga nxjerrja e llogarisë bankare të bashkëshortit të subjektit në BKT, rezulton se:

i. Në datën 7.5.2010 bashkëshorti i subjektit nëpërmjet transfertës bankare kalon fondet e bonove të thesarit në vlerën 1,983,305 lekë në llogarinë rrjedhëse të tij, të cilat i ka konvertuar në euro në shumën 14,546.02 euro. Gjithashtu, në të njëjtën datë bashkëshorti i subjektit depoziton *cash* shumën 5,454 euro, nën komentin “derdhje në depozitë”.

ii. Në datën 10.5.2012, pas maturimit të depozitës, bashkëshorti i subjektit ka depozituar shumën 13,000 euro, nën komentin “derdhje në depozitë”.

iii. Në datën 11.5.2012, gjendjen prej 33,962.29 euro të llogarisë e kalon në depozitë me afat, e cila pas maturimit në datën 14.5.2015 merr gjendjen 36,007.80 euro.

iv. Në datën 14.5.2015 shuma 36,007.80 euro ka kaluar në llogarinë dyemërore dhe po në këtë datë është mbyllur në depozitë me afat.

³³ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) nxjerrje llogarie datë 25.1.2017, lëshuar nga BKT-ja, e regjistruar në emër të shtetasit R.S për periudhën 1.5.2010 – 25.1.2017; (ii) nxjerrje llogarie datë 13.10.2016, lëshuar nga BKT-ja, e regjistruar në emër të shtetasve R dhe Fahrije Stringa për periudhën 14.5.2015 – 13.10.2016; (iii) transaksion datë 10.5.2012, i lëshuar nga BKT-ja, për depozitimit e shumës 13,000 euro; (iv) kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.2.2012, e lidhur midis palës shitëse R.S dhe palës blerëse N.B e K.Sh; (v) nxjerrje llogarie e lëshuar nga SGA Bank, e regjistruar në emër të shtetasit R.S për periudhën 1.1.2004 – 13.10.2016.

³⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 18.9.2020, drejtuar bankave të nivelit të dytë; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 5.10.2020, e BKT-së; shkresë nr. *** prot., datë 30.9.2020, e “Intesa Sanpaolo Bank”; shkresë nr. *** prot., datë 1.10.2020, e OTP Bank; shkresë nr. *** prot., datë 18.9.2020, drejtuar DPSHTRR-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 28.9.2020, e DPSHTRR-së.

Kjo depozitë vjen në deklaratën *Vetting* në gjendjen 36,007.80 euro.

144. Nga verifikimi i deklarimeve vjetore rezulton se bashkëshorti i subjektit ka deklaruar si vijon:

i. Në DPV/2009: *“Nga bonot e thesarit në nëntor 2009, për shumën 4,000,000 lekë, kam tërhequr si interes shumën 339,952 lekë, si dhe shumën 119,940 lekë mbi shumën fikse 4,000,000 lekë”.*

ii. Në DPV/2010: *“Nga bonot e thesarit kam tërhequr shumën 1,983,306 lekë dhe transferuar në BKT në maj 2010, i kam këmbyer në 14,546 euro. Kësaj shume i kam shtuar 5,454 euro të ardhura nga bonot dhe qiratë. Depozituar në BKT në shumën 20,000 euro”.*

iii. Në DPV/2012: *“Shitjen e automjetit tip ‘Ford’ me kontratë shitjeje nr. ***, datë 21.2.2012, në shumën 5,000 euro; në maj 2012 është shtuar në depozitën në BKT shuma 13,000 euro, e përbërë nga shuma 5,000 euro nga shitja e automjetit dhe shuma e mbetur prej 6,630 euro nga tërheqja në bankën ‘Societe Generale Albania’ në tetor 2011, si dhe të ardhurat nga qiratë”.*

Komisioni ka analizuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të deklaruara nga ana e subjektit për krijimin e depozitës, si vijon:

145. Në lidhje me të ardhurat e krijuara nga tërheqjet në llogarinë e bonove të thesarit dhe interesave të tyre: *tërheqja e fondeve në datën 7.5.2010 nga shtetasi R.S prej llogarisë së tij në bono thesari në shumën 1,983,306 lekë, e konvertuar në euro në vlerën përkatëse prej 14,546 euro.*

146. Nga nxjerrja e llogarive bankare rezultoi se:

i. Në datën 11.10.2007, në llogarinë e tij nr. *** në OTP Bank³⁵, bashkëshorti i subjektit depoziton shumën 80,000 euro, nën komentin *“derdhje cash R.S, derdhje për çelje depozite”.* Kjo shumë e ka burimin nga shitja e një sipërfaqe toke prej 500 m², trajtuar në pikat 214-215 të vendimit.

ii. Në datën 13.10.2008 bashkëshorti i subjektit konverton me kurs preferencial 123.3 shumën 50,767 euro, të cilën e investon në bono thesari në vlerën 6,000,000 lekë. Diferencën e mbetur prej 30,000 euro e mbyll në depozitë me afat në OTP Bank.

iii. Pas maturimit të bonove të thesarit prej 6,000,000 lekësh në datën 16.10.2008, bashkëshorti i subjektit ka tërhequr interesin e gjeneruar prej tyre në shumën 206,887 lekë.

iv. Bashkëshorti i subjektit, fondet prej 6,000,000 lekësh i ka riinvestuar në bono thesari, përkatësisht në datën 14.4.2009 në shumën 4,000,000 lekë dhe në datën 5.5.2009 në shumën 2,000,000 lekë.

v. Gjatë vitit 2009, për bonot e thesarit në vlerën 4,000,000 lekë, bashkëshorti i subjektit ka tërhequr interesat në vlerën 459,902.00 lekë dhe për bonot thesarit në vlerën 2,000,000 lekë ka tërhequr interesat në vlerën 166,974.00 lekë.

vi. Në datën 6.5.2010, pas maturimit, bashkëshorti i subjektit ka tërhequr vlerën 2,000,000 lekë, të investuar në bono thesari dhe së bashku me interesat e përfituara prej tyre, në datën 7.5.2010,

³⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 1.10.2020, e OTP Bank.

i ka konvertuar në shumën 14,546 euro. Në po këtë datë, kësaj shume bashkëshorti i subjektit i ka shtuar vlerën 5,454 euro dhe totalin prej 20,000 euro e depoziton me afat 12-mujor në BKT.

147. Nga analiza financiare³⁶ rezultoi se subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme për krijimin e depozitave të sipërcituara.

148. Në lidhje me shumën 5,454 euro, të deklaruar me të ardhura nga tërheqja e interesave në bono thesari, datë 5.11.2009, në total në vlerën 458,091 lekë/rreth 3,360 euro, si dhe të ardhura nga qiratë e dy dyqaneve dhe godinës në Rr e D, Tiranë, rreth 2,000 euro (gusht 2009 - prill 2010/9 muaj x 337.5 USD/muaj = 3,000 USD) konstatohet se, megjithëse janë deklaruar si burim në deklaratën *Vetting*, rezulton se në DPV/2009 subjekti nuk ka deklaruar kursime *cash*.

149. Nga hetimi ka rezultuar se:

i. Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti, në lidhje me vitin 2009, ka deklaruar gjendje *cash* 1,688 USD + 459,000 lekë, duke sqaruar se: “Në DPV/2010 deklaroj: shumës 15,546 euro i kam shtuar edhe 5,454 euro me të ardhurat nga qiratë dhe bonot dhe në deklaratën *Vetting* deklaroj: ...kësaj shume i shtoj edhe 5,454 euro me të ardhurat nga bonot dhe qiratë e dy dyqaneve (gusht 2009 - prill 2010, 9 muaj x 337.5 USD/muaj). Pra gusht - dhjetor 5 x 337.5 = 1,688 USD ka qenë gjendje *cash* më 31.12.2008.

*Në DPV/2010 deklaroj: kam tërhequr bonot e thesarit dhe transferuar në BKT dhe në *Vetting* deklaroj: me të ardhura nga tërheqja e interesave të bonove të thesarit, datë 5.11.2009, në vlerën 458,901 lekë, shtoj shumën në BKT. Pra shuma 458,901 lekë ka qenë gjendje *cash* më 31.12.2009”.*

ii. Nga verifikimi i DPV/2010 rezulton se në vitin 2010 bashkëshorti i subjektit deklaruar: “Nga bonot e thesarit kam tërhequr shumën 1,983,306 lekë dhe e kam transferuar në BKT. Në maj 2010 i kam këmbyer në 14,564 euro. Kësaj shume i kam shtuar 5,454 euro të ardhura nga bonot dhe qiratë”.

iii. Nga shqyrtimi i *statement*-it bankar të BKT-së rezulton se në datën 7.5.2010 (pra rreth 6 muaj pas tërheqjes së interesave) bashkëshorti i subjektit ka depozituar *cash* në llogari shumën 5,454 euro.

iv. Gjatë vitit 2010 deri në datën 7.5.2010 bashkëshorti i subjektit ka tërhequr të ardhura nga interesat e depozitave në vlerën 184,474.96 lekë.

v. Gjatë vitit 2010 deri në datën 7.5.2010 bashkëshorti i subjektit ka pasur të ardhura nga qiratë në vlerën 2,325 USD.

150. Në përfundim, duke konsideruar faktet dhe rrethanat e mëposhtme:

- a) në DPV/2009 subjekti nuk ka deklaruar gjendje *cash*;
- b) në DPV/2010 bashkëshorti i subjektit nuk ka specifikuar të ardhurat nga qiraja dhe bonot e vitit 2009;
- c) bashkëshorti i subjektit gjatë vitit 2010 ka përfituar të ardhura nga interesat në shumën 184,474.96 lekë dhe nga qiraja në shumën 2,325 USD;
- d) kohën e gjatë nga tërheqja e interesave dhe përfitimit të qirave gjatë vitit 2009 dhe depozitimit të tyre në llogari bankare (maj 2010),

³⁶ Shihni tabelën nr. 6 të rezultateve të hetimit.

– Komisioni vlerësoi të mos përfshijë në analizë financiare kursimet *cash* në vlerën 1,688 USD + 459,000 lekë, të pretenduara nga subjekti si të krijuara në vitin 2009.

151. Nga analiza financiare³⁷ duket se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e depozitës prej 20,000 euro, në vlerën 879,341.12 lekë. Për të qenë sa më ezaures, Komisioni konstatoi se, edhe sikur të përfshihen në analizë burimet e deklaruara nga subjekti, pra të ardhurat nga qiraja, interesat bankarë dhe kursimet *cash* në vlerën 5,454 euro, sërish rezultati do të ishte negativ në vlerën -122,271.38 lekë.

152. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti pretendoi se depozitën e mësipërme e ka deklaruar saktësisht në deklaratën Vetting dhe në DPV, duke sqaruar se kjo shumë, sipas statement-it bankar të Bankës së Shqipërisë, është tërheqja në datën 7.5.2010 nga bashkëshorti i saj R.S prej llogarisë së tij në bono thesari në shumën 1,983,306 lekë, të konvertuara në euro në vlerën përkatëse 14,546 euro. Kësaj shume i ka shtuar edhe shumën 5,454 euro, me të ardhura nga tërheqja e interesave në bono thesari, datë 5.11.2009, në total në vlerën 458,091 lekë/rreth 3,360 euro, si dhe të ardhura nga qiratë e dy dyqaneve dhe godinës në Rr e D, Tiranë, rreth 2,000 euro (gusht 2009 - prill 2010/9 muaj x 337.5 USD/muaj = 3,000 USD).

Kjo llogari depozite është shtuar në 10 maj 2012 në vlerën 13,000 euro, që përbëhet nga: të ardhurat nga qiratë e vitit 2010 (maj 2010 - shtator 2010/5 muaj x 337.5 = 1,700 USD/rreth 1,370 euro) nga shitja e autoveturës në vlerën 5,000 euro (shihni kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.2.2012) dhe shuma e mbetur prej 6,630 euro, e cila rezulton nga tërheqja pranë bankës “Societe Generale Albania”. Lidhur me mosdeklarimin e gjendjes *cash* në vitin 2009 të tërheqjeve të interesave dhe të të ardhurave nga qiraja, njëjloj si në situatën e viteve 2010 2011 - 2012, ajo ka menduar se fakti i deklarimit të krijimit të kësaj të ardhure në formën e likuiditeteve, e presupozonte të deklaruar dhe pasqyruar saktë këtë të ardhur në deklarimin periodik vjetor. Bashkëshorti i saj, si person i lidhur me të, nuk e ka pasur të qartë plotësimin e deklaratave periodike, duke sjellë edhe pasaktësi në deklarimin e kursimeve *cash* ndër vite, sikundër edhe në rastin në fjalë. Siç lehtësisht vihet re, nga ana e tij, por edhe nga ana e saj, në asnjë prej deklaratave periodike nuk janë deklaruar kursime *cash*, pavarësisht se nga ana e tyre janë përfituar të ardhura të konsiderueshme nga qiratë apo tjetërsimi i pasurive, ku më pas, në periudha shumë të shkurtra kohore, janë depozituar në llogari rrjedhëse apo llogari depozitë.

153. Për sa i përket analizës, subjekti ka pretenduar se:

- Komisioni ka llogaritur gabimisht pakësimin e likuiditeteve, duke e konsideruar depozitën 30,000 USD dhe jo 30,000 euro. Duke qenë se kursi i USD-së është rritur shumë gjatë vitit 2010, nga 1 USD = 93.98 lekë në datën 31.12.2009 në 1 USD = 104.95 lekë në datën 31.12.2010, në ndryshim nga rritja e euros, ku në datën 31.12.2009 1 euro = 137.17 dhe në datën 31.12.2010 1 euro = 138.81, impakti i llogaritjes me kursin e USD-së është 279,900 lekë më shumë.
- Gjendja *cash* në datën 31.12.2009 ka qenë në shumat 1,688 USD dhe 458,901 lekë.
- Shpenzimet e jetesës që nga maji 2008 – 2016 (kohë kur ka ndërruar jetë nëna e bashkëshortit) janë llogaritur për 3 persona kur duhet të llogariten për 2 persona.

³⁷ Shihni tabelën nr. 7 të rezultateve të hetimit.

154. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson të marrë në konsideratë pretendimet e saj në lidhje me gabimin material në likuiditete, duke e korrigjuar kursin nga USD në euro, duke përfshirë në analizë shumën 279,900 lekë si pakësim në likuiditetet e përdorura për krijimin e kësaj depozite, si dhe reflektimet në shpenzimet jetike. Komisioni evidenton se subjekti nuk ka deklaruar kursime *cash* ndër vite, pavarësisht faktit se nga analiza financiare ajo ka pasur mundësi për të krijuar këto gjendje. Në kushtet kur nga ana e subjektit janë korrigjuar vetëm disa nga gjendjet *cash* në deklaratat periodike dhe në rastin konkret këto gjendje nuk gjejnë pasqyrim të qartë dhe të mirëfilltë në deklaratën periodike respektive sikundër ka ndodhur me korrigjimet e gjendjes vash në deklaratat e tjera, Komisioni vlerëson të mos i marrë në konsideratë. Komisioni konstaton se subjekti nuk i ka kushtuar kujdesin e duhur deklaramit të gjendjes *cash* ndër vite, duke sjellë si pasojë edhe pamundësinë e një analize të saktë për krijimin e kësaj gjendjeje *cash* ndër vite, pavarësisht të ardhurave të konsiderueshme të subjektit. Në këto kushte, Komisioni ka marrë për bazë deklaramit e subjektit në deklaratat periodike, duke i konsideruar si korrigjim të deklarimeve të mëparshme të saj, për sa kohë nga analiza financiare ato nuk shoqërohen me mungesë burimesh të ligjshme dhe subjekti i ka specifikuar saktë. Në rastin e kursimeve të vitit 2009, nga ana e bashkëshortit të subjektit në DPV/2010 nuk është specifikuar se burimi kanë qenë të ardhurat nga qiraja apo interesat e vitit 2009.

155. Analiza financiare

Tabela nr. 6

	Maj 2010
Pasuria	895,690.88
Depozitë	2,776,200.00
<i>Ndryshim likuiditeti</i>	<i>-1,880,509.13</i>
Detyrime	0.00
Pasuria neto	895,690.88
Të ardhura	835,182.88
Të ardhurat e subjektit Fahrije Stringa (Budo)	406,699.17
Të ardhurat nga qiratë	244,008.75
Të ardhurat e bashkëshortit R.S	0.00
Të ardhurat e nënës së bashkëshortit G.S	0.00
Të ardhura nga interesat e depozitave	184,474.96
Shpenzime	113,850.00
Shpenzime jetike	113,850.00
TIMS	
Mundësia për kursime	-174,358.00

Nga analiza financiare e kryer, pasi janë marrë në konsideratë disa prej pretendimeve të subjektit, rezulton se ajo nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme në vlerën 174,358.00 lekë.

Në lidhje me shtesën në depozitë në datën 10.5.2012, në vlerën 13,000 euro

156. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka pretenduar se vlera 13,000 euro ka si burim:

- a) të ardhurat nga shitja e automjetit në vlerën 5,000 euro;
- b) të ardhurat nga qiratë e vitit 2010 (maj 2010 - shtator 2010/5 muaj x 337.5 = 1700 USD/rreth 1,370 euro;

- c) shumën e mbetur prej 6,630 euro, e cila rezulton nga tërheqja pranë bankës “Societe Generale Albania”.

157. Nga hetimi, Komisionit i ka rezultuar se me kontratën e shitblerjes datë 13.8.2002, lidhur në K, Gjermani, me shitësin P.D, bashkëshorti i subjektit ka blerë automjetin tip “Ford Escort”, vit prodhimi 1995, për çmimin 1,500 euro. Referuar deklaratës doganore Import 4, blerësi ka paguar detyrimet doganore në vlerën 141,650 lekë³⁸. Pra, në total, bashkëshorti i subjektit ka paguar vlerën 351,920 lekë³⁹ për blerjen e automjetit tip “Ford Escort”.

Me kontratën e shitblerjes datë 21.2.2012, bashkëshorti i subjektit e ka shitur këtë automjet në favor të blerësve N.B (djali i vëllait të subjektit) dhe K.Sh, për çmimin 5,000 euro, shumë e cila sipas deklarimit të palëve është likuiduar plotësisht jashtë zyrës noteriale. Vlera e shitjes e konvertuar në lekë sipas kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë në vitin 2012 është 698,600 lekë.

Për sa më sipër, rezulton se bashkëshorti i subjektit e ka shitur automjetin tip “Ford Escort” në një vlerë rreth dy herë më të lartë se vlera e blerjes së tij, pas 10 vitesh përdorim.

158. Lidhur me këtë konstatim, subjekti është pyetur edhe në përgjigje të pyetësorit të datës 19.10.2022, ku ka deklaruar: *“Mjeti ka qenë i vitit 1995 dhe çmimi i fabrikës për një automjet të kësaj kategorie ka qenë 15,670 euro... arsyeja përse është blerë me vlerë më të ulët ka qenë se mjeti, edhe pse kishte kryer një numër kilometrash shumë më të ulët se mesatarja evropiane, në kohën e blerjes kishte hasur një problem në motor dhe me klimatizatorin dhe shpenzimet për riparimin e tyre shkuan rreth 1,400 euro. Më pas, për të ulur shpenzimet e konsumit të karburantit është montuar një impiant gazi, që kushtoi rreth 1,500 euro. Gjithashtu, ndër vite janë kryer edhe riparime të tjera të nevojshme të cilat shtuan vlerën reale të mjetit... Duke qenë se vlera reale e blerjes ka qenë pothuaj e barabartë me vlerën e shitjes, ne nuk kemi paguar detyrime tatimore, por jemi në pamundësi për shkak të kohës së largët për të vërtetuar shpenzimet që kemi bërë për përmirësimin e automjetit”.*

159. Subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion për të provuar investimet e kryera nga bashkëshorti i saj mbi automjetin tip “Ford”, në mënyrë që ta shiste për një çmim rreth dy herë më të lartë se çmimi i blerjes, pas 10 vitesh përdorim. Gjithashtu, nga analizimi i deklarimeve vjetore të subjektit, nuk rezulton të jenë deklaruar shpenzime të kryera për përmirësimet e kushteve teknike të këtij automjeti.

160. Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë nuk ka përcjellë asnjë informacion lidhur me pagesën e ndonjë tatimi mbi këtë shitje. Gjithashtu, vetë subjekti ka deklaruar se nuk ka paguar tatim fitimi mbi këtë shitje, siç parashikohet në ligjin e kohës nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

161. Për sa më sipër, në kushtet kur:

- a) automjeti është shitur në një vlerë dyfish më të lartë se çmimi i blerjes pas 10 vjetësh përdorimi;
- b) automjeti është shitur tek djali i vëllait të subjektit të rivlerësimit,

³⁸ Vlerë e korigjuar, reflektuar në deklaratën doganore të depozituar nga subjekti së bashku me deklaratën *Vetting*.

³⁹ Kursi i këmbimit të monedhës euro në lekë, sipas deklaratës doganore, është përllogaritur 135.28.

– duket se:

- Ngrihen dyshime për një vlerë fiktive të çmimit të shitjes së këtij automjeti.
- Nga hetimi ka rezultuar se subjekti nuk ka paguar detyrimet tatimore për të ardhurat e përfituara nga shitja e këtij automjeti mbi çmimin e blerjes, për rrjedhojë, diferenca e shumë çmim shitje/çmim blerje e automjetit nuk do të përfshihet në analizë financiare.

162. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti pretendoi se duke e pasur detyrim ligjor (por edhe moral) për dhënien e këtij sqarimi, megjithëse nuk disponon dokumentacion, nga ana e bashkëshortit i është dhënë opinioni i tij teknik, referuar literaturës, si për çmimin e blerjes, ashtu edhe për çmimin e shitjes, si vijon:

“Për të dhënë një opinion teknik për blerjen e automjetit të markës ‘Ford’, modeli ‘Ecsort’, duhet të mbahen parasysh disa momente kryesore: mjeti ka qenë i vitit 1995, me vëllim të cilindrates 1796 cm³ (1,8 benzinë 16 V); në bazë të personit që e ka shitur makinën (e porositur në fabrikë, me shtesë disa elemente të veçanta, duke përmendur njësinë e klimatizimit, disqe speciale, kroskot mobilje etj.); çmimi i fabrikës për një automjet në bazë të kësaj kategorie ka qenë 15,670 euro. Duke shtuar edhe porositë e veçanta të klientit kjo vlerë rritet, por nuk i kanë marrë të dhënat se sa vlenin në atë periudhë... Duke pasur parasysh se automjeti është blerë në vitin 2002, pra 3 vjet më parë, duke marrë për analogji një automjet të vitit të prodhimit 1998, i blerë në vitin 2005 (pra 3 vjet nga prodhimi më i ri dhe 3 vjet i shitur më vonë). Vlera e një automjeti të tillë në shitje ka qenë 4,590 euro. Arsyet përse është blerë me vlerë më të ulët ka qenë se mjeti, edhe pse kishte kryer një numër kilometrash shumë më të ulët se mesatarja evropiane (23.000 km/vit), në kohën e blerjes kishte konsumuar në total ndër vite afërsisht 66.000 km, sipas pronarit të makinës vitet e fundit kishte hasur me një problem në motor, kryesisht në kokën elektronike (njësia bazë e shpërndarjes së karburantit). Po ashtu, kishte pasur probleme me klimatizatorin, që sipas logjikës ekonomike në RFGJ shpenzimet që duheshin kryer për riparimin e tyre e kalonin gjysmën e vlerës së mjetit në atë kohë. Për ardhjen e mjetit në Shqipëri (me rrugë tokësore) u desh dyfishi i kohës, për shkak të problemit në motor. Në kushtet e Shqipërisë shpenzimet e riparimeve të këtyre problemeve kryesore shkuan rreth 1,400 euro. Më pas, për të ulur shpenzimet e konsumit të karburantit është montuar një impiant gazi, që në atë kohe kanë qenë të rralla dhe vinin kryesisht nga Italia (firma ‘L’) dhe pajisja e mjetin me këtë impiant kushtoi një vlerë të përafërt 1,500 euro. Vendosja e impiantit të gazit, duke pasur parasysh diferencën e lartë të çmimit të benzines me çmimin e gazit, natyrisht rriti performancën e mjetit me shpenzimet për karburant. Gjithashtu, duhet thënë se ndër vite janë kryer edhe riparime të tjera të nevojshme për ta pasur mjetin në gjendjen e parë. Pra, vlera e mjetit me riparimet e domosdoshme dhe adaptimet për rritjen e performancës e shtuan vlerën reale të tij”.

163. Lidhur me paraqitjen e dokumentacionit për investimet e kryera, në kushtet kur ajo nuk ka pasur detyrim ligjor të deklarojë investimet e kryera, nuk ka mbajtur dokumentacion, pasi ka menduar se nuk do t’i nevojitet ndonjëherë.

Në momentin që është shitur automjeti kishte në kroskotin e tij një vlerë rreth 100.000 km. Duke qene se nipi i saj e dinte se çfarë automjeti zotëronte bashkëshorti i saj dhe që ishin kryer investime kapitale të rëndësishme në të, i kërkoi që t’ia shiste. Pavarësisht vlerës fillestare dhe

shpenzimeve të kryera në të, vlera e një mjeti është edhe se sa i kujdesshëm është poseduesi i tij.

164. Referuar ligjit të kohës, individ i privat nuk paguante dhe nuk kishte detyrim ligjor për pagimin në burim (tatim-fitimi) mbi vlerën e shitjes së automjetit dhe se nuk ka pasur asnjë rast në Republikën e Shqipërisë që të kishte paguar një pagesë për raste të ngjashme. Përcaktimi kushtetues lidhur me pasuritë e ligjshme duhet të interpretohet drejt, në kuadër të detyrimit për të paguar detyrimet tatimore, kur vetë legjislacioni i posaçëm parashikon detyrimin për deklarimin e të ardhurave dhe pagimin e detyrimeve tatimore. Por, edhe praktika e Kolegjit të Posaçëm të Apelit në raste të ngjashme ka mbajtur të njëjtin qëndrim lidhur me detyrimin për pagimin e detyrimeve tatimore⁴⁰.

165. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato mund të jenë bindëse vetëm për vlerën fiktime të çmimit të shitjes, ndërkohë, për sa i përket detyrimeve tatimore, bazuar edhe në vendimin nr. 41/2002 të Kolegjit, të cituar nga vetë subjekti, rezulton se ajo kishte detyrimin për të paguar këto detyrime tatimore. Kolegji, në vendimin nr. 41, shprehet se: *“Në vështrim të këtij qëndrimi, Kolegji vëren se në rastin konkret, ashtu si dhe është shprehur subjekti i rivlerësimit në ankim, legjislacioni tatimor ka qenë i paqartë nëse të ardhurat nga shitja e automjetit ishin të ardhura të tatueshme, si dhe për autoritetin pranë të cilit do të kryhej pagesa e detyrimeve tatimore. Nga dispozitat e ligjit nr. 8438 ‘Për tatimin mbi të ardhurat’, konkretisht të nenit 8 të tij, në të cilin listohen të ardhurat e tatueshme, nuk rezulton që të ketë një parashikim të qartë për të ardhurat e krijuara nga shitja e pasurive të luajtshme, ku përfshihen edhe automjetet. Kjo paqartësi e dispozitës ka sjellë si pasojë mosveprimin e subjektit të rivlerësimit për pagesën e tatimit në kohën e krijimit të të ardhurave nga shitja. Në këndvështrim të këtyre parashikimeve ligjore, të cilat nuk rezultojnë të kenë një parashikim eksplisit për detyrimin tatimor që lind në raste të tilla, as për agjentin tatimor dhe as për procedurën tatimore, por edhe në konsideratë të rrethanave faktike të rastiit objekt gjykimi, në të cilat subjekti, pavarësisht këtij ambiguiteti ligjor, është ofruar dhe ka paguar vullnetarisht detyrimin tatimor të supozuar, Kolegji çmon se duhen konsideruar si të ardhura të ligjshme, të ardhurat e krijuara nga shitja e automjeteve të mësipërme, pavarësisht diferencës mes çmimeve të blerjes dhe shitjes së tyre. Për sa më sipër, Kolegji, nisur nga rrethanat konkrete dhe në respektim të standardit kushtetues të parashikuar nga neni 155 i Kushtetutës, çmon se të ardhurat e realizuara nga shitja e dy automjeteve, me targa {***} dhe {***}, të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore, duhen të konsiderohen se plotësojnë kriterin e së ardhurës së ligjshme, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016 dhe, si të tilla, duhet të përfshihen në analizën financiare të vitit 2009, për të ardhurat nga shitja e automjetit me targë {***}, sipas kontratës së datës 15.7.2009, me vlerë prej 1,000,000 lekësh dhe të vitit 2014 për të ardhurat nga shitja e automjetit me targë {***}, sipas kontratës së datës 14.6.2014, me vlerë prej 5,500 eurosh ose ekuivalenti prej 770,605 lekësh”.*

Për sa më sipër, për sa kohë subjekti nuk ka paguar detyrimet tatimore, qoftë edhe me vonesë, Komisioni nuk mund të përfshijë në analizë financiare diferencën e çmimit të blerjes me atë të shitjes, bazuar edhe në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit⁴¹.

⁴⁰ Vendimi nr. 41/2022 i Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

⁴¹ Vendim nr. 11/2019; nr. 23/2019; nr. 34/2019.

166. Në lidhje me burimet nga të ardhurat nga qiratë e vitit 2010 dhe shumën 6,630 euro, e cila rezulton nga tërheqja pranë bankës “Societe Generale Albania”⁴², nga hetimi ka rezultuar se:

- Në DPV/2012 bashkëshorti i subjektit ka deklaruar: *“Në maj 2012 shtuar në depozitën në BKT shumën 13,000 euro, e përbërë nga shuma 5,000 euro nga shitja e autoveturës dhe shuma e mbetur prej 6,630 euro nga tërheqja në bankën ‘Societe Generale Albania’ në tetor 2011, si dhe të ardhura nga qiratë”*.

167. Subjekti, në pyetësin standard në lidhje me gjendjen *cash*, ka deklaruar si vijon:

a. Viti 2010 – 2,000 USD

Në DPV/2011 deklarohet: në janar 2011 kam depozituar në “Intesa Sanpaolo Bank” shumën 2,000 USD”.

b. Viti 2011 – 5,100 USD + 6,630 euro + 1, 500,000 lekë

- *Në DPV/2014 dhe në deklaratën Vetting kam deklaruar: shuma 16,000 USD është vlera e të ardhurave të përfituara të bashkëshortit nga qiratë mujore për vitet 2011, 2012 dhe 2013 në vlerën 5,100 USD/vit. Pra, gjendja cash në fund të vitit 2011 ka qenë 5,100 USD dhe është përdorur në vitin 2014.*
- *Në DPV/2012 dhe në deklaratën Vetting deklarohet: shuma 13,000 euro derdhur në BKT e përbërë nga... dhe shuma e mbetur prej 6,630 euro nga tërheqja në bankën “Societe Generale” në tetor 2011 (18,630 euro), pas blerjes së automjetit 12,000 euro. Pra, 6,630 euro kanë qenë gjendje cash në shtëpi.*
- *Në DPV/2011 deklarohet: në dhjetor 2011 në bankën “Societe Generale” kam mbyllur llogarinë dhe tërhequr shumën 1,254,879 lekë, në nëntor 2011 kam rifitur bono thesari shumën 4,000,000 lekë, nga e cila kam tërhequr në nëntor 2011 shumën 275,928 lekë. Në janar 2012 të dy këto shuma i kam futur në bono thesari. Pra, shuma 1,500,000 lekë ka qenë gjendje cash në shtëpi më 31.12.2011.*

168. Referuar këtij deklarimi të subjektit, rezulton se në vitin 2011 ka pasur gjendje *cash* në shumën 5,100 USD + 6,630 euro + 1,500,000 lekë.

Për sa më sipër, duket se deklarimi i subjektit në pyetësin standard nuk përputhet me deklaratimet e saj në deklaratën *Vetting*, për sa i përket kursimeve *cash* të vitit 2010, pasi në pyetësin standard deklarohet se ka pasur 2,000 USD, që i ka përdorur për depozitën në janar, ndërsa në deklaratën *Vetting* deklarohet se kursimet nga të ardhurat nga qiraja në vitin 2010, në shumën 1,700 USD, i ka përdorur si burim për depozitim në datën 10.5.2012.

169. Pas kalimit të barrës së provës në lidhje me këtë konstatim të Komisionit, subjekti pretendoi se të ardhurat nga qiraja gjatë vitit 2010 kanë qenë në shumën 5,895 USD, pra nuk ka mospërputhje në deklaratimet e saj. Një pjesë e qirave janë përdorur për shtesën e depozitave dhe shuma 2,000 USD ka qenë gjendje *cash*. Subjekti i rivlerësimit deklarohet: *“Thëksoj sërish që kjo situatë e krijuar mbi të ardhurat e qirave, të cilat kanë qenë tërësisht të ligjshme, janë paguar rregullisht detyrimet tatimore, është një situatë e cila duhet të vlerësohet drejt dhe objektivisht, pasi deklarimi i tyre ka qenë i rregullt në çdo DPV, thjesht ka munguar formalisht*

⁴² Shkresë nr. *** prot., datë 1.10.2020, e OTP Bank.

në rubrikën e likuiditeteve cash, çka nuk mund të përbëjë shkak për penalizimin e situatës sime në këtë proces rivlerësimi”.

170. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit dhe deklarimet në DPV/2011, ku bashkëshorti i saj shprehet se ka depozituar shumën 2,000 USD, me burim nga qiratë, por duke mos specifikuar se kishim të bënim me gjendje *cash* të vitit 2010 apo me qira të përfituar në vitin 2010, vlerëson se shuma 2,000 USD nuk mund të konsiderohet si kursim *cash* i vitit 2010.

171. Komisioni, pavarësisht deklarimeve të subjektit, për të qenë sa më e zaurues, ka kryer një analizë financiare⁴³ për mundësinë e kursimeve *cash* në vitin 2011, sipas deklarimeve të saj në pyetësin standard, nga ku ka rezultuar se subjekti nuk ka të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e kësaj gjendjeje *cash* në shumën 1,211,049.17 lekë.

172. Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, pretendoi se në analizën e Komisionit ndryshimi i likuiditeteve është në shumën 1,680,552 lekë, që ka ardhur si diferencë e gjendjeve në datën 31.12.2010 në shumën 21,601,251 lekë dhe në datën 31.12.2011 në shumën 20,328,966 lekë. Në këtë analizë Komisioni depozitën e saj pranë OTP Bank në euro e ka llogaritur gabimisht në dollar. Diferenca nga kjo llogaritje e gabuar është 1,053,887 lekë. Gjithashtu, gjendja e likuiditeteve *cash* në datën 31.12.2010 ka qenë 2,000 USD = 209,900 lekë.

173. Si rezultat i këtyre ndryshimeve, gjendja e likuiditeteve në datën 31.12.2010 ka qenë 22,865,038 lekë (21,601,251 lekë + 1,053,887 lekë + 209,900 lekë) dhe jo 21,601,251 lekë, siç është llogaritur nga Komisioni. Në datën 31.12.2011 gjendja e likuiditeteve e llogaritur nga Komisioni ka qenë 20,328,966.54 lekë. Po t'i shtohen kësaj shume likuiditete *cash*, të cituara më sipër në relacion (5,100 USD, 6,630 euro dhe 1,500,000 lekë), ekuivalenti në lekë i të cilave është në shumën 2,952,837 lekë, totali i likuiditeteve në datën 31.12.2011 rezulton 23,281,803 lekë. Diferenca nga data 31.12.2010 deri më 31.12.2011 është shtesë 416,765 lekë.

174. Gjatë vitit 2011 Komisioni vazhdon të llogarisë shpenzime jetese për 3 persona, ndërkohë që nëna e bashkëshortit është ndarë nga jeta në maj të vitit 2008. Këto shpenzime të llogaritura sipas standardit të përdorur nga Komisioni për dy persona kanë qenë në vlerën 273,240 lekë.

175. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, e vlerëson të drejtë konstatimin e saj mbi gabimin material në likuiditete të ndodhur si pasojë e trajtimit të depozitës prej 30,000 USD dhe jo 30,000 euro, ka kryer sistemimin e kursit të këmbimit për këto 2 vite, për vitin 2011 kjo depozitë është trajtuar në euro, për rrjedhojë, nuk ka mospërputhje në kursin e këmbimit. Në analizën financiare për mundësinë e krijimit të gjendjes *cash* në vitin 2011 janë kryer edhe reflektimet në shpenzimet jetike për 2 persona.

Në lidhje me pretendimin e subjektit mbi gjendjen e likuiditeteve *cash* në datën 31.12.2010, në vlerën 2,000 USD, Komisioni është shprehur në pikën 170 të këtij vendim.

176. Komisioni ka kryer sërish analizën financiare për krijimin e gjendjes *cash* sipas deklarimeve të subjektit në vitin 2011, prej nga ku rezulton se subjekti ka një mungesë burimesh të ligjshme në shumën 20,542 lekë.

Analiza financiare sipas deklarimeve të subjektit gjatë hetimit

Tabela nr. 7

⁴³ Shihni tabelën nr. 8 të rezultateve të hetimit.

	Viti 2011
Pasuria	1,986,421.51
Automjet tip "Toyota R 4", blerë në shtator 2011	1,359,755.92
Ndryshim likuiditeti	626,665.59
<i>Total likuiditeti</i>	20,328,966.54
<i>Gjendje cash (5,100 USD + 6,630 euro + 1,500,000 lekë)</i>	2,952,837.00
Detyrime	0.00
Pasuria neto	1,986,421.51
Të ardhura	2,902,852.51
Të ardhurat e subjektit Fahrije Stringa (Budo)	1,008,262.00
Të ardhurat e babait të subjektit I.B nga dëmshpërblimet e përfituara si i përndjekur politik nga MF	415,332.00
Të ardhurat e nënës së shtetasit I.B nga diferencat e pensionit	343,356.00
Të ardhurat nga qiratë	527,711.76
Të ardhura nga interesat e depozitave	608,190.75
Shpenzime	936,973.43
Shpenzime jetike	273,240.00
TIMS	383,221.43
Shpenzime doganore për automjetet	280,512.00
Mundësia për kursime	-20,542.42

Analiza financiare sipas deklarimeve të subjektit në deklaratat periodike

Tabela nr. 8

	Viti 2011
Pasuria	1,986,421.51
Automjet tip "Toyota R **", blerë në shtator 2011	1,359,755.92
Ndryshim likuiditeti	626,665.59
<i>Total likuiditeti</i>	20,328,966.54
<i>Gjendje cash (5,100 USD + 1,500,000 lekë)</i>	2,952,837.00
Detyrime	0.00
Pasuria neto	1,986,421.51
Të ardhura	2,035,908
Të ardhurat e subjektit Fahrije Stringa (Budo)	1,008,262.00
Të ardhurat e babait të subjektit I.B nga dëmshpërblimet e përfituara si i përndjekur politik nga MF	415,332.00
Të ardhurat e të nënës së shtetasit I.B nga diferencat e pensionit	343,356.00
Të ardhurat nga qiratë	527,711.76
Të ardhura nga interesat e depozitave	608,190.75
Shpenzime	936,973.43
Shpenzime jetike	273,240.00
TIMS	383,221.43
Shpenzime doganore për automjetet	280,512.00
Mundësia për kursime	896,386.58

177. Në përfundim të hetimit, duke konsideruar faktet dhe rrethanat si më poshtë:

- i. në DPV/2010 - 2011 subjekti nuk ka deklaruar gjendje *cash*;
- ii. nga analiza financiare duket se subjekti nuk ka të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e kursimeve *cash* të deklaruara prej saj në shumën 5,100 USD + 6,630 euro + 1,500,000 lekë;

- iii. deklarimeve kontradiktore të subjektit të rivlerësimit në lidhje me kursimet *cash*;
- iv. mundësisë së subjektit dhe bashkëshortit të saj për të përdorur shumat e mësipërme për mbulimin e shpenzimeve të tyre gjatë kësaj periudhe;
- v. kohës së gjatë nga tërheqja dhe përfitimit të qirave dhe depozitimit të tyre në llogari bankare (maj 2012),

– Komisioni nuk ka përfshirë në analizë financiare si kursime *cash* shumat e pretenduara nga subjekti. Në lidhje me shumën 1,500,000 lekë, nga analiza financiare rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e saj, si dhe është deklaruar si burim për krijimin e depozitës në vitin 2012, por në kushtet kur deklaratimet e saj në lidhje me gjendjen *cash* janë kontradiktore dhe ajo është në pamundësi për krijimin e gjendjes *cash* sipas deklarimeve të saj, kjo shumë nuk është përfshirë në analizë financiare. Në lidhje me këto konstatime subjektit iu kaluar barra e provës, për të cilën ka dhënë shpjegime, të cilat janë trajtuar më lart, por edhe që do të trajtohen në vijim së bashku me analizën për shtesën e depozitës në shumën 13,000 euro.

178. Komisioni ka kryer një analizë financiare⁴⁴ për shtesën në depozitë, në vlerën 13,000 euro, pa përfshirë si gjendje *cash* shumën 1,500,000 lekë, pavarësisht faktit se subjekti e ka deklaruar si burim në DPV/2012, pasi nga analiza financiare subjekti nuk kishte të ardhura të mjaftueshme të ligjshme. Nga analiza financiare duket se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e shtesës në depozitë në vlerën 748,262.63 lekë. Nëse në analizë financiare përfshihen vetëm burimet e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting*, duket se ajo dhe bashkëshorti nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e shtesës në depozitë në vlerën 1,411,081.63 lekë.

179. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti prapësoi se nga parashtrimet e saj duket qartë që në vitin 2011 ka pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për kursimet e deklaruara në shumat 5,100 USD, 6,630 euro dhe 1,500,000 lekë. Mungesa e deklaratimit vetëm në rubrikën e *cash*-it nuk e bën atë një të ardhur të paligjshme, pasi subjekti ka deklaruar saktësisht në rubrikën e likuiditetit se nuk i ka shpenzuar dhe as përdorur ato për krijimin e ndonjë pasurie, ndaj dhe vlerëson se kjo e ardhur duhet përfshirë në analizë si një e ardhur e ligjshme.

- Në DPV/2012 dhe në deklaratën *Vetting* deklaroi: “*Shuma 13,000 euro derdhur në BKT, e përbërë nga... dhe shuma e mbetur prej 6,630 euro nga tërheqja në bankën ‘Societe Generale’ në tetor 2011 (18,630 euro), pas blerjes së automjetit 12,000 euro. Pra, 6,630 euro kanë qenë gjendje cash në shtëpi*”.
- Në DPV/2011 deklaroi: “*Në dhjetor 2011 në bankën ‘Societe Generale’ kam mbyllur llogarinë dhe tërhequr shumën 1,254,879 lekë. Në nëntor 2011 kam rifitur bono thesari shumën 4,000,000 lekë, nga e cila kam tërhequr në nëntor 2011 shumën 275,928 lekë. Në janar 2012 të dy këto shuma i kam futur në bono thesari. Pra, shuma 1,500,000 lekë ka qenë gjendje cash në shtëpi më 31.12.2011*”.

180. Në përfundim, subjekti, duke konsideruar faktet dhe rrethanat, deklaroi: “*Unë dhe bashkëshorti im kemi deklaruar çdo të ardhur të krijuar në deklaratimet periodike vjetore dhe të*

⁴⁴ Shihni tabelën nr. 9 të rezultateve të hetimit.

gjitha veprimet e kryera nga ana jonë janë të gjurmueshme dhe dalin qartë nga transaksionet bankare të kryera.

Në këtë periudhë kam deklaruar si pasuri të krijuar, si në DPV, edhe në deklaratën Vetting, vetëm blerjen e pasurisë së luajtshme automjet dhe s'kam krijuar asnjë pasuri tjetër, ndaj dhe çdo e ardhur që krijohet nga qiratë apo interesat e depozitave është kursyer nga ana jonë.

Shuma prej 1,500,000 lekësh në vitin 2011 është tërhequr në nëntor 2011 dhe është futur në bono thesari në janar 2012, pra brenda një periudhe shumë të shkurtër, ku konsiderohet e pamundur që të shpenzohet një vlerë e tillë vetëm nga unë dhe bashkëshorti im”.

181. Në këtë analizë subjekti kërkon nga Komisioni të marrë në konsideratë sa më poshtë vijon:

“Siç kam deklaruar dhe shpjeguar në lidhje me kursimet cash, edhe në këtë analizë do të kërkoja njohjen e gjendjes cash më 31.12.2011 në shumën 6,630 euro, pakësuar gjatë vitit 2012, deklaruar si burim për shtesën e depozitës në shumën 13,000 euro.

- Të ardhurat nga shitja e automjetit në shumën 691,500 lekë.

- Shpenzimet jetike duhet të llogariten për dy persona 113,850 lekë, pasi në atë periudhë kemi qenë vetëm unë dhe bashkëshorti im në familje.

- Siç shihet nga analiza, sipas parashtrimeve të mia, analiza deri në 10 maj 2012 rezulton me balancë pozitive në shumën 568,831 lekë”.

182. Në lidhje me konstatimin se nëse në analizë financiare përfshihen vetëm burimet e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën Vetting duket se ajo dhe bashkëshorti i saj nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e shtesës në depozitë në vlerën 1,411,081.63 lekë, subjekti sqaron se në deklaratën Vetting ka deklaruar si burim:

- të ardhurat nga shitja e automjetit në vlerën 5,000 euro;*
- të ardhurat nga qiratë e vitit 2010 (maj 2010 - shtator 2010/5 muaj x 337.5 = 1,700 USD, rreth 1,370 euro;*
- shuma e mbetur prej 6,630 euro, e cila rezulton nga tërheqja pranë bankës “Societe Generale Albania”.*

Pra, shuma e tri burimeve të deklaruara përbën vlerën prej 13,000 euro, që përmbush shtimin e depozitës prej 1,411,081.63 lekësh. Por Komisioni nuk duhet të kufizohet vetëm në të ardhurat e deklaruara si burim, për sa kohë nga analiza, edhe nëse nuk marrin në konsideratë të ardhurat nga shitja e automjetit përtej vlerës se blerjes, përsëri analiza do të dilte pozitive.

183. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, ka marrë në konsideratë analizën e kryer në pikën 175-176 dhe tabelën nr.7 të këtij vendimi, nga ku rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e shumave 1,500,000 lekë dhe 5,100 USD. Komisioni gjithashtu ka marrë në konsideratë edhe faktin se bashkëshorti i subjekti ka deklaruar saktësisht përdorimin e shumës 1,500,000 lekë në DPV/2011, ku deklaroi: *“Në dhjetor 2011 në bankën ‘Societe Generale’ kam mbyllur llogarinë dhe tërhequr shumën 1,254,879 lekë, në nëntor 2011 kam rifitur bono thesari shumën 4,000,000 lekë, nga e cila kam tërhequr në nëntor 2011 shumën 275,928 lekë. Në janar 2012 të dy këto shuma i kam futur në bono thesari”.* Pra, shuma 1,500,000 lekë ka qenë gjendje cash në banesë më 31.12.2011. Të njëjtin deklaram bashkëshorti i subjektit ka bërë edhe në DPV/2012.

Për këto arsye, Komisioni vendosi të përfshijë në analizë financiare si kursim *cash* për vitin 2011, përveç shumës 5,100 USD, edhe shumën 1,500,000 lekë. Pavarësisht faktit se bashkëshorti i subjektit në vitin 2011 nuk e ka deklaruar si kursim *cash* këtë shumë, në këtë DPV ai e ka deklaruar si burim të llogarisë së krijuar në fillim të vitit 2012, të cilën kishte detyrimin ligjor ta deklaronte në DPV/2012. Bashkëshorti i subjektit edhe në DPV/2012 ka kryer të njëjtin deklaram si në DPV/2011, në lidhje me krijimin e bonove të thesarit në vitin 2012. Në këtë rast jemi përpara një pasaktësie në deklaram, e cila nuk shoqërohet me mungesë burimesh të ligjshme. Pasaktësia konsiston në faktin se bashkëshorti i subjektit duhej të deklaronte në DPV/2011 jo vetëm të ardhurat, por edhe gjendjen e tyre *cash* dhe në DPV/2012 pakësimin e tyre, ndërkohë që në DPV/2011 ai ka deklaruar si burim të një depozite të krijuar në vitin 2012 shumën 1,500,000 lekë. Në këto kushte, duket qartë që bashkëshorti ka pasur gjendje *cash* në banesë shumën 1,500,000 lekë në fund të vitit 2011, për sa kohë e ka deklaruar si burim të një depozite të krijuar në vitin 2012.

184. Për sa i përket shumës 6,630 euro, ajo nuk do të konsiderohet si gjendje *cash* e subjektit, pavarësisht faktit se subjekti në DPV/2012 e ka deklaruar si burim të depozitës sepse nga analiza financiare rezulton me një rezultat negativ në vlerën 20,542 lekë, si dhe nuk është deklaruar si kursim *cash* në vitin 2011. Ky rezultat negativ do të mbahet në konsideratë nga Komisioni në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë, si dhe vlerësimin e rezultatit negativ të shtesës së kësaj depozite. Për sa i përket të ardhurave nga shitja e automjetit, Komisioni është shprehur në pikën 165 të këtij vendimi.

185. Komision ka korrigjuar analizën financiare në lidhje me shpenzimet jetike.

Tabela nr. 9

	10 maj 2012
Pasuria	1,816,360.00
Shtesa 13,000 euro	1,816,360.00
<i>Ndryshim likuiditeti</i>	0.00
Detyrime	0.00
Pasuria neto	1,816,360.00
Të ardhura	1,242,532.38
Të ardhurat e subjektit Fahrije Stringa (Budo)	443,768.00
Të ardhurat nga qiratë deri në muajin maj	227,793.38
Të ardhurat e bashkëshortit R.S	0.00
Të ardhurat e nënës së bashkëshortit G.S	0.00
Të ardhura nga interesat e depozitave	219,051.00
Të ardhura nga shitja e pasurive të luajtshme	351,920.00
Shpenzime	116,290.00
Shpenzime jetike	116,290.00
TIMS	
Mundësia për kursime	-690,117.63

186. Nga analiza financiare, pas prapësimeve në lidhje me këtë pasuri, subjekti dhe personat e lidhur me të nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të krijuar shtesën prej 13,000 euro në vlerën 690,117.63 lekë.

187. Në lidhje me rezultatin negativ të llogaritur për burimet e deklaruara nga subjekti, Komisioni vlerëson se duke marrë në konsideratë rezultatin e papërfillshëm negativ në lidhje me mundësinë e krijimit të kursimeve *cash* të subjektit, deklarimin e shumës 6,630 euro si burim për këtë depozitë, përfshirjen e çmimit të blerjes së automjetit, si dhe mbulimin e shpenzimeve me të ardhurat e tjera, konstaton se ky rezultat është në vlerën -701,746 lekë, e cila është e njëjta vlerë përafërsisht si më lart. Në këto kushte, Komisioni nuk mund të rëndojë dy herë pozitën e subjektit, për rrjedhojë, në përfundim në lidhje me shtesën në këtë depozitë, subjekti rezulton me një mungesë të ardhurash të ligjshme në vlerën 690,117.63 lekë.

Kjo shumë, duke marrë në konsideratë edhe pasaktësitë në deklaratimet e gjendjes *cash* të subjektit, si dhe të mundësisë së saj për krijimin e këtyre kursimeve, nuk përbën shkak autonom për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit për subjektin.

PASURITË E BASHKËSHORTIT TË SUBJEKTIT

188. Depozitë me afat në “Intesa Sanpaolo Bank”⁴⁵ në emër të bashkëshortit të subjektit, z. R.S, krijuar më 31.10.2000, në vlerën 7,000 USD, në Bankën Amerikane të Shqipërisë, sot “Intesa Sanpaolo Bank”, gjendje së bashku me interesat në datën 13.10.2016, në shumën 56,319.89 USD. Pjesa takuese e bashkëshortit: 100%.

Burimi i krijimit sipas deklaratës *Vetting*: *“Kjo shumë është vlera e të ardhurave të përfituara nga qiratë mujore të dy dyqaneve në pronësi të G.S, nëna e bashkëshortit tim R.S, për periudhën korrik 1994 – korrik 2004, në vlerën 20,000 USD (1,100 + 1,200 = 2,300 USD/muaj - 230 USD tatim qiraje = 2,070 USD neto/12 pjesëtarë = 172.5 USD/muaj x 120 muaj = 20,700 USD), depozituar në Bankën Amerikane të Shqipërisë.*

Më 10.1.2005, shtuar 1,000 USD (6 muaj x 172.5 = 1,000 USD/korrik 2004 - dhjetor 2004), po nga të ardhurat e qirave të dy dyqaneve deri në korrik 2005.

*Duke filluar nga muaji korrik 2005, kjo llogari është shtuar edhe me të ardhurat nga qiratë mujore të godinës së ish-gjykatës/pronësi të G.S/nëna e bashkëshortit tim R.S, dhënë me qira universitetit *** për mësimdhënie, si dhe interesat në vlerën totale prej 7,000 USD (pasi më 11.7.2005 llogaria rezulton në vlerën totale 28,262 USD, sipas statement), shtuar më 11.1.2006*

⁴⁵ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) nxjerrje llogarie datë 13.10.2016 nga Tirana Bank, në emër të shtetasve R dhe G.S; (ii) nxjerrje llogarie datë 25.10.2016 nga Tirana Bank, në emër të shtetasve R dhe G.S për periudhën 1.10.2000 – 25.10.2016; (iii) kontratë qiraje nr. ***, datë 24.5.2005; (iv) kontratë qiraje datë 4.6.2014; (v) kërkesë nr. *** prot., datë 28.10.2016, nga gjyqtarja Fahrije Stringa, drejtuar shoqërisë “***” sh.p.k.; (vi) kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 2.11.2016, nga shoqëria “***” sh.p.k., drejtuar gjyqtarës Fahrije Stringa; (vii) njoftim datë 24.10.2016, i lëshuar nga Bashkia Tiranë, ku konfirmohet se shtetasi R.S nuk ka detyrime tatimore për vitin 2016; (viii) fotokopje e pagesave bankare të kryera, me objekt “likuidimi i tatimit mbi qiranë për periudhat 1995 – 2001 dhe 2003 – 2005; (ix) kontratë qiraje datë 8.3.1999; (x) kontratë qiraje e lidhur midis palës qiradhënëse, pjesëtareve të familjes A, D, S, dhe palës qiramarrëse shoqërisë “B” sh.p.k.; (xi) kontratë qiraje nr. ***, datë 4.4.2006; (xii) kontratë qiraje e lidhur midis palës qiradhënëse A. A dhe palës qiramarrëse Sh.G; (xiii) kontratë qiraje nr. ***, datë 27.2.2014; (xiv) prokurë e përgjithshme nr. ***, datë 23.1.2006 dhe prokurë e përgjithshme nr. ***, datë 9.10.2007; (xv) prokurë e përgjithshme nr. ***, datë 31.7.2013; (xvii) prokurë e përgjithshme nr. ***, datë 27.7.1999; (xviii) kontratë qiraje datë 1.11.2014; (xix) aktmarrëveshje datë 1.11.2014, për të mos ndërprerë kontratën e qiradhënies datë 29.2.2014; (xx) aktmarrëveshje datë 2.6.2015, për ndërprerjen e kontratën me mirëkuptim; (xxi) kontratë qiraje nr. ***, datë 4.4.2006; (xxii) kontratë qiraje datë 1.3.2013; (xxiii) shkresë nr. *** prot., datë 17.1.2017, e lëshuar nga DRT-ja Tiranë; (xxiv) kërkesë nr. *** prot., datë 20.1.2017, e lëshuar nga gjyqtarja Fahrije Stringa për DRT-në Tiranë; (xxv) kontratë qiraje datë 1.3.2014; (xxvi) kontratë qiraje datë 1.3.2015; (xxvii) fotokopje e pagesave bankare të kryera, me objekt “likuidimi i tatimit mbi qiranë për periudhën 1998 – 2002”.

në vlerën 2,000 USD, shtuar më 12.6.2006 prej 3,000 USD, shtuar qira dhe interesa depozite në vlerën 13,000 USD (nga e cila 6,500 qira), duke rezultuar në vlerën totale në datën 15.1.2009 në vlerën 46,000 USD, shtuar në datën 30.7.2009 vlera e qirave edhe me 6,000 USD (vlera e qirave periudha janar 2008 - maj 2008 është 675 USD neto/muaj; periudha qershor 2008 - korrik 2009 është 337.5 USD neto/muaj), duke rezultuar në vlerën 52,000 USD më 30.7.2010, shtuar qira 1,000 USD më 31.1.2011. Vlera totale, së bashku me interesat më 31.1.2011, rezulton 53,722 USD.

Më 13.10.2016 kjo vlerë është shtuar vetëm nga interesat bankare, duke rezultuar në vlerën totale prej 56,319.89 USD”.

Konstatimi i ILDKPKI-së

- Dokumentacion jo i plotë ligjor në lidhje me likuidimin e të gjitha detyrimeve tatimore që lindin për pagesën e tatim-fitimit mbi të ardhurat nga qiratë, përdorur si burim financiar për krijimin e depozitës në shumën 56,319 USD në ISP Bank.
- Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me burimin financiar për krijimin e depozitës me vlerë 20,000 USD në Bankën Amerikane të Shqipërisë. Në deklaratën e interesave privatë “Para fillimit të detyrës 2003” deklarohen si burim të ardhura nga emigracioni i bashkëshortit në Itali dhe Greqi për periudhën 1991 dhe 1996 – 1998.

Hetimi⁴⁶/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

189. Nga nxjerrja e llogarive bankare rezulton se në datën 31.10.2000 bashkëshorti i subjektit, së bashku me nënën e tij, kanë hapur një llogari dyemërore nr. ***, në USD, pranë BIA Bank, në të cilën evidentohen depozitimet si vijon:

- i. Në datën 31.10.2000 është depozituar *cash* shuma 7,000 USD, e cila mbyllet në depozitë. Kjo depozitë ka qëndruar e pandryshuar deri në datën 1.4.2004, kur është tërhequr shuma e plotë 7,126.42 USD.
- ii. Në datën 9.7.2004 çelet depozitë në vlerën 20,000 USD, e cila është shtuar vit pas viti me depozitime *cash*. Në datën 1.2.2016 gjendja e saj është 56,319.89 USD, vlerë e cila deklarohet nga subjekti në deklaratën *Vetting*.
- iii. Në datën 30.3.2017 shuma 56,400 USD kalon në llogarinë dyemërore të subjektit dhe bashkëshortit të saj e hapur në “Intesa Sanpaolo Bank” dhe së bashku me shumën 16,000 USD të depozituar *cash*, nën komentin “Kursime tërhequr nga bankë tjetër”, krijohet një depozitë me vlerë 72,400 USD.

190. Bashkëshorti i subjektit në DPV/2003 ka deklaruar: “Depozitë në dollarë në emrin tim dhe të nënës time G.S, me burim nga të ardhurat e qirave të dy dyqaneve në katin e parë të godinës trekatëshe në Rr e D, rreth 180 USD/muaj për periudhën nga viti 1994 e në vazhdim, si dhe nga puna në emigracion Itali dhe Greqi në vitet 1991, 1996 – 1998, rreth 80 euro/muaj”.

191. Komisioni ka konstatuar se burimi i deklaruar në deklaratën *Vetting* është i ndryshëm nga ai i deklaruar në deklarimin vjetor të vitit 2003. Në lidhje me këtë konstatim, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Duke qenë se bashkëshorti dhe nëna e tij, të ardhurat i kanë pasur

⁴⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 18.9.2020, drejtuar bankave të nivelit të dytë; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 30.9.2020, e “Intesa Sanpaolo Bank”.

si nga emigracioni, edhe si nga qiratë, por nuk mund të identifikonim sa nga shumat e kursimeve ka qenë nga secili burim, i kanë përmendur të dyja burimet në mënyrë të përgjithshme, ndërkohë që unë sipas llogaritjeve të sakta të burimeve nga qiraja kam saktësuar dhe pasqyruar në deklaratën e rivlerësimit të ardhurat nga qiraja”.

192. Komisioni ka analizuar në cilësinë e burimit për krijimin e kësaj depozite, të ardhurat nga qiraja të përfituara nga shtetasit G e R.S, referuar deklaramentit të subjektit në deklaratën *Vetting*. Nga analiza financiare⁴⁷ duket se bashkëshorti i subjektit dhe nëna e tij nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e depozitës prej 7,000 USD në vitin 2000, në vlerën 1,035,997 lekë.

193. Komisioni ka kryer edhe një analizë financiare për shtesat në këtë depozitë⁴⁸, ku duket se subjekti dhe bashkëshorti nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për furnizimin me fonde të depozitave gjatë periudhës 2003 – 2011, në vlerën totale -1,654,614.59 lekë.

194. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti pretendoi se këto të ardhura janë krijuar përpara se ajo dhe bashkëshorti të njiheshin dhe të martoheshin, si dhe i përkasin një periudhe kur nuk ka qenë as gjyqtare dhe as subjekt deklarues.

Për sa i përket analizës së shumës 7,000 USD në vitin 2000, nga analiza e Komisionit konstatohet që të ardhurat nga qiratë e godinës janë llogaritur vetëm për pjesën e dyqaneve, ndërsa shuma e të ardhurave të godinës për të cilat Komisioni ka vërtetuar pagesën e tatimeve nuk është përfshirë në analizë. Nisur nga sa më sipër, duke reflektuar ndryshimin e të ardhurave nga qiraja në analizën e Komisionit, analiza nuk duhet bërë vetëm për vitin 2000, por duke filluar që nga viti 1994. Sipas kësaj analize mundësia për kursime e familjes së bashkëshortit deri në vitin 2000 ka qenë 4,436,877 lekë, pra shumë më e lartë se depozita e krijuar këtë vit në shumën 7,000 USD.

195. Në lidhje me analizën e shtesës 20,000 USD në vitin 2003, subjekti deklaroi se *kjo shumë nuk është krijuar në vitin 2004, por ka qenë gjendje në vitin 2003, fakt i deklaruar prej saj që në DPV/2003. Nga personeli i “Intesa Sanpaolo Bank” është informuar që për periudhën deri në vitin 2003 banka nuk i kishte të evidentuara depozitat në llogari bankare, por ishin të paspecifikuara dhe sot është pothuaj e pamundur të nxjerrin gjendjen e saktë të depozitës në vitin 2003. Në DPV/2003 nëna e bashkëshortit ka deklaruar: “Depozitë në dollarë KIB nr. ***, në emër të djalit tim R.S dhe timin G.S - 20,000 USD, Banka Amerikane e Shqipërisë - të ardhura nga qiratë e dy dyqaneve... për periudhën nga 1994 e në vazhdim”. Është e qartë që kjo shumë nuk mund të krijohej brenda vitit 2004, siç e ka llogaritur Komisioni.*

196. Lidhur me analizën e shtesës 8,000 USD, më 11.7.2005, subjekti pretendoi se *në analizën e bërë në datën 11.7.2005 Komisioni ka bërë një gabim në llogaritjen e likuiditeteve. Në analizën e vitit 2004 nuk është përfshirë shuma 1,456,566 lekë, gjendje në llogarinë e R e G.S pranë “Raiffeisen Bank”. Kjo shumë sipas statement-it bankar bashkëngjitur është tërhequr në dhjetor të vitit 2005 dhe është derdhur në OTP Bank, pra ka qenë gjendje në bankë në datën 31.12.2004. Si rezultat ndryshimi i likuiditeteve për këtë periudhë ka qenë 942,536 lekë dhe jo sa në analizën e Komisionit 1,814,915 lekë.*

⁴⁷ Shihni tabelën nr. 10 të rezultateve të hetimit.

⁴⁸ Shihni tabelën nr. 11 të rezultateve të hetimit.

197. Në lidhje me shtesën 4,000 USD, subjekti pretendoi se më 14.1.2008, siç ka shpjeguar lidhur me gjendjet *cash* në fund të vitit 2007, ka pasur gjendje 4,000 USD, të cilat janë derdhur në janar 2008 në bankë. Nga analiza e vitit 2007 rezulton që ka pasur mundësi të kursejë shumën 4,000 USD, për shkak se këto janë të ardhurat e krijuara nga qiratë e bashkëshortit të saj dhe nënës së tij.

198. Në lidhje me shtesën 2,000 USD, datë 11.1.2011, subjekti pretendoi se, siç ka deklaruar në lidhje me kursimet *cash* në fund të vitit 2010, gjendja e kursimeve *cash* ka qenë 2,000 USD dhe kjo shumë në datën 11.1.2011 është derdhur në llogarinë e bashkëshortit pranë “Intesa Sanpaolo Bank”, sikurse është deklaruar saktësisht edhe në DPV-në e vitit 2011, në rubrikën “Përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit”.

199. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson si vijon:

i) Në lidhje me burimin e depozitës në shumën 7,000 USD, Komisioni pranoi shpjegimet e subjektit, duke përfshirë në analizë financiare edhe të ardhurat nga kontratat e tjera të depozituara⁴⁹ nga subjekti nëpërmjet të cilave përgjatë periudhës 1994 e në vijim bashkëshorti i subjektit dhe familjarët e tij kanë dhënë me qira përveç dyqaneve edhe godinën. Në lidhje me këto të ardhura, subjekti ka provuar edhe pagimin e detyrimeve tatimore⁵⁰. Të ardhurat nga qiraja janë trajtuar gjerësisht në pikën 266 e vijim të këtij vendimi.

200. Komisioni kreu sërish analizën financiare të krijimit të kësaj depozite, nga ku rezulton se bashkëshorti i subjektit dhe nëna e tij kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e kësaj depozite.

Analiza financiare

Tabela nr. 10

	Periudha 1994 – 2000
Pasuria	2,331,207.00
Tokë arë me sip. 500 m ²	744,650.00
<i>Ndryshim likuiditeti</i>	<i>1,586,557.00</i>
Detyrime	0.00
Pasuria neto	2,331,207.00
Të ardhura	4,580,029.38
Të ardhurat nga qiratë	4,545,630.38
Të ardhura nga interesat e depozitave	34,399.00
Shpenzime	1,013,862.00
Shpenzime jetike	1,013,862.00
TIMS	0.00
Mundësia për kursime	1,234,960.38

ii) Në lidhje me shtesat e kësaj llogarie në shumën 20,000 USD

201. Lidhur me këtë depozitë, referuar dokumentacionit bankar të administruar gjatë hetimit nga nxjerrjet e llogarive bankare të bashkëshortit të subjektit pranë “Intesa Sanpaolo Bank”, rezulton se ajo është e krijuar në datën 9.7.2004 në vlerën 20,000 USD.

⁴⁹ Shihni *footnote* nr.73.

⁵⁰ Shihni *footnote* nr.74.

202. Në lidhje me pretendimin e subjektit se kjo depozitë është deklaruar me numërtimin e saj që në deklaratën e vitit 2003, vërehet se deklarata e vitit 2003 është dorëzuar në ILDKPKI nga personat e lidhur të subjektit të rivlerësimit (bashkëshorti dhe nëna e tij) në datën 15.9.2004. Pra pretendimi i subjektit se nëna e bashkëshortit të saj nuk mund të dinte numërtimin e kësaj llogarie para çeljes së saj, nuk qëndron.

203. Komisioni kreu sërish analizën financiare të krijimit të kësaj depozite, duke konsideruar në analizë të gjitha të ardhurat nga qiraja, për të cilat është provuar pagesa e detyrimeve tatimore për periudhën 1994 e në vijim.

Tabela nr. 11

	Vitet 2001 – 2003
Pasuria	1,553,861.75
Apartament me sip. 63 m ² , përfituar me privatizim	20,000.00
Automjet tip “F.E”	210,270.00
Automjet tip “P”	25,000.00
<i>Ndryshim likuiditeti</i>	<i>-422,157.25</i>
Detyrime	0.00
Pasuria neto	1,553,861.75
Të ardhura	4,851,224.20
Të ardhurat e subjektit Fahrije Stringa (Budo)	1,579,762.00
Të ardhurat nga qiratë	995,668.71
Të ardhurat e nënës së bashkëshortit G.S	152,400.00
Të ardhura nga interesat e depozitave	352,644.49
Të ardhura nga shitja e pasurive të luajtshme	50,000.00
Shpenzime	987,574.00
Shpenzime jetike	887,574.00
TIMS	0.00
Shpenzime mobilimi	100,000.00
Mundësia për kursime	2,309,788.45

Nga analiza financiare rezulton se bashkëshorti i subjektit dhe personat e lidhur me të kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e depozitës 20,000 USD.

iii) Në lidhje me parashtrimet e paraqitura nga subjekti për pakësimin e gjendjes *cash* gjatë vitit 2008, Komisioni nuk i ka përfshirë në analizë, pasi subjekti nuk ka deklaruar as shtesa, por edhe as pakësime të gjendjes *cash*, pavarësisht faktit që ajo ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e këtyre kursimeve, i cili do të mbahet në konsideratë në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë.

iv) Në lidhje me shtesën e depozitës në vitin 2008, subjekti rezulton sërish me mungesë burimesh të ligjshme në shumën 577,708 lekë dhe në vitin 2011 në shumën 47,288 lekë. Në total në shumën 624,996 lekë.

204. Komisioni vlerëson se kjo shumë nuk mund të përbëjë shkak të vetëm për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit të subjektit, duke mbajtur në konsideratë edhe faktin se subjekti ka pasur të ardhur të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e kursimeve *cash*, të cilat nuk i ka deklaruar në deklaratat periodike ndër vite, por edhe nuk është shprehur qartësisht në momentin e krijimit të këtyre shtesave, duke mos specifikuar saktësisht burimin e tyre.

205. Bono thesari në Bankën e Shqipërisë⁵¹, në emër të bashkëshortit të subjektit R.S/kartela e klientit nr. *, e krijuar në datën 14.10.2008, në shumën 6,000,000 lekë, gjendje së bashku me interesat në datën 11.10.2016/balanca aktuale 7.190.000 lekë**

Burimi i krijimit sipas deklaratës Vetting: “Unë, R.S, kam pasur në pronësi një sipërfaqe toke 500 m² në Sauk, Tiranë, me nr. pasurie ***, e blerë me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 6.4.1996, para njohjes dhe martesës me bashkëshorten time Fahrije Stringa. Këtë pasuri e kam shitur me kontratën e shitjes nr. ***, datë 11.10.2007, në vlerën 80,000 euro, arkëtuar nga blerësi kontraktor në datën 11.10.2007 po këtë vlerë në bankën ‘Societe Generale Albania’. Nga kjo bankë, në datën 13.10.2008 është tërhequr nga unë vlera 50,767 euro, e konvertuar në lekë, nga e cila 6,000,000 lekë në datën 14.10.2008 është investuar bono thesari.

Në Bankën e Kursimeve nëna ime G.S dhe unë kemi pasur një llogari depozitë me gjendje në shumën 1,421,445 lekë, më 31.12.2003, deklaruar nga ana jonë në deklaratën e pasurisë së vitit 2004.

Burimi i të ardhurave janë qiratë e zyrave në godinën e ish-Gjykatës së Rrethit Tiranë. Në datën 23.1.2013 në llogarinë në bono thesari të Bankës së Shqipërisë kartela e klientit nr. *** është bërë hyrje 1,600,000 lekë.

Nga llogaria e depozitës në fund të vitit 2005 është tërhequr pranë ‘Raiffeisen Bank’ vlera totale së bashku me interesat 1,500,000 lekë. Kjo vlerë është transferuar në Bankën Popullore në datën 23.12.2005, në të cilën në datën 24.12.2007 është tërhequr vlera 674,891 lekë dhe vlera e mbetur prej 1,000,000 lekësh së bashku me interesat e saj rezulton më 26 dhjetor 2011 në vlerën totale 1,254,800 lekë, e cila është tërhequr në këtë datë prej kësaj banke, duke u mbyllur kjo llogari. Kësaj shume prej 1,254,800 lekësh i janë shtuar edhe interesat nga bonot e thesarit të muajit nëntor 2011, në vlerën përkatëse 275,928 lekë, interesin prej 98,757 lekësh të bonove, duke rezultuar në vlerën totale rreth 1,600,000 lekë, në datën 23.1.2012, e bërë hyrje në llogarinë e bonove të thesarit.

Në datën 22.4.2014 në llogari në bono thesari të Bankës së Shqipërisë është bërë hyrje 1,400,000 lekë. Burimi i të ardhurave të kësaj vlere është përfituar nga shitja e pronës time, deklaruar në rubrikën 4 të kësaj deklarate, në pjesën ku është përfshirë edhe bashkëshortja ime.

Gjatë periudhës janë bërë edhe tërheqje përkatëse të vlerës së investuar, e tillë në datën 7.5.2010, bërë dalje/tërheqje nga banka vlera 1,983,305 lekë (+ tatim 16,695) = 2,000,000 lekë kaluar në BKT (deklaruar në rubrikën 5 të kësaj deklarate në pjesën e bashkëshortes sime). Përfundimisht llogaria e bonove është 6,000,000 + 3,000,000 – 2,000,000 + interesa = 7,190,000 lekë”.

Konstatimi i ILDKPKI-së

⁵¹Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) nxjerrje llogarie datë 11.10.2016, nga Banka e Shqipërisë, e regjistruar në emër të shtetasit R.S për periudhën 29.1.2015 – 11.10.2016; (ii) kontratë shitjeje pasurie të paluajtshme nr. ***, datë 11.10.2007; (iii) kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 6.4.1996; (iv) kontratë pjesëtimi nr. ***, datë 31.5.1997; (v) kërkesë ankimore datë 9.1.2017, nga shtetasi R.S, drejtuar “Raiffeisen Bank” lidhur me informacionin për depozitën nr. ***, e hapur në emër të shtetasve R dhe G.S në Bankën e Kursimeve; (vi) nxjerrje llogarie datë 25.1.2017, e lëshuar nga SGA Bank në emër të shtetasve R dhe G.S, për periudhën 23.12.2005 – 25.1.2017.

- Rezulton se sipas kontratës nr. ***, datë 6.4.1996, pasuria tokë arë me sip. 3000 m², në Sauk, Tiranë, është blerë në shumën 3,000,000 lekë, ndërsa sipas kontratës nr. ***, datë 31.5.1997, vlera e vendosur është 30,000 USD, duke u shtuar si palë blerëse edhe shtetasi P.S.
- Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me të ardhurat nga emigracioni i bashkëshortit, deklaruar si burim në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës 2003, për blerjen e pasurisë tokë arë me sip. 500 m², në Sauk, Tiranë.

Hetimi⁵²/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

206. Nga nxjerrja e llogarive bankare të bashkëshortit të subjektit, rezultoi:

i. Në datën 11.10.2007 në llogarinë e tij në OTP Bank depoziton shumën 80,000 euro, nën komentin “derdhje cash R.S, derdhje për çelje depozite”.

Subjekti në DPV/2007 ka deklaruar: “Në datën 11.10.2007 bashkëshorti im R.S ka shitur një sipërfaqe toke 500 m² të ndodhur në Sauk, Tiranë, në vlerën 80,000 euro, me kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.10.2007. Shuma 80,000 euro është depozitë në Bankën Popullore në emër të R.S (bashkëshorti im)”.

ii. Në datën 13.10.2008 bashkëshorti i subjektit konverton me kurs preferencial 123.3 shumën 50,767 euro, duke i transferuar nga llogaria e tij në lekë për blerje bono thesari në vlerën 6,000,000 lekë. Diferencën e mbetur prej 30,000 euro e mbyll në depozitë me afat në OTP Bank. Pas maturimit të bonove të thesarit prej 6,000,000 lekësh, në datën 16.10.2008, bashkëshorti i subjektit ka tërhequr interesin e gjeneruar prej tyre në shumën 206,887 lekë.

iii. Në datën 14.4.2009 bashkëshorti i subjektit ka investuar në bono thesari shumën 4,000,000 lekë dhe në datën 5.5.2009 shumën 2,000,000 lekë.

iv. Në datën 14.4.2009 ka riinvestuar në bono thesari shumën 4,000,000 lekë, ndërsa fondet prej 2,000,000 lekësh të investuara në bono thesari i ka tërhequr pas maturimit në datën 6.5.2010 dhe pas konvertimit i ka përdorur për depozitën në vlerën 20,000 euro në BKT.

v. Në datën 30.1.2012 bashkëshorti i subjektit ka riinvestuar në bono thesari shumën 4,000,000 lekë dhe në datën 31.1.2012 shumën 1,600,000 lekë.

vi. Në datën 31.10.2013 bashkëshorti i subjektit ka riinvestuar në bono thesari shumën 4,000,000 lekë dhe në datën 31.10.2013 shumën 1,800,000 lekë.

vii. Në datën 28.10.2014 bashkëshorti i subjektit ka riinvestuar në bono thesari shumën 4,000,000 lekë, në datën 13.2.2014 shumën 1,790,000 lekë dhe në datën 29.4.2014 shumën 1,400,000 lekë.

Në lidhje me burimin e të ardhurave

i) Në lidhje me të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurisë arë me sip. 500 m²

⁵² Shkresë nr. *** prot., datë 18.9.2020, drejtuar bankave të nivelit të dytë; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 25.9.2020, e Bankës së Shqipërisë; shkresë nr. *** prot., datë 1.10.2020, e OTP Bank; shkresë nr. *** prot., datë 18.9.2020, drejtuar ASHK-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 13.10.2020, e ASHK Tirana Rurale 1; shkresë nr. *** prot., drejtuar “Raiffeisen Bank”; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 31.10.2022, e “Raiffeisen Bank”.

207. Në DPV/2003 bashkëshorti i subjektit ka deklaruar “tokë arë me sip. 500 m², në Sauk, Tiranë, blerë me kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 6.4.1996”. Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ASHK-ja, rezulton se me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 6.4.1996, bashkëshorti i subjektit, së bashku me shtetasit S.Sh, M.V e A.B, kanë blerë nga shitësit B⁵³ pasurinë tokë arë në vendin e quajtur S **, me sip. 3000 m², ndodhur në fshatin S të Tiranës, për çmimin 3,000,000 lekë. Në dosjen e pasurisë së paluajtshme evidentohet gjithashtu kontrata e shitblerjes nr. ***, datë 31.5.1997, me palë blerëse R.S, S.Sh, M.V e A.B dhe P.S, përmes së cilës këta shtetas kanë blerë pasurinë tokë arë, me nr. pasurie **, me sip. 3000 m², në fshatin S, për çmimin 30,000 USD.

208. Në lidhje me regjistrimin e këtyre dy kontratave në ASHK, në përgjigje të pyetësorit datë 19.10.2022, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar: “*Në dokumentacionin që dispononte bashkëshorti im ka qenë vetëm kontrata e shitblerjes nr. ***, datë 6.4.1996. Pasi u vura në dijeni nga ana juaj për kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 31.5.1997, konstatova se ky dokument na kishte munguar në të vërtetë fizikisht, por ky është dokumenti ligjor i kalimit të pronësisë, thënë ndryshe kontrata e shitjes së tokës nga shitësit tek blerësit, një ndër të cilët është edhe bashkëshorti im R.S.*”

*Për këtë situatë, konstatuar me të drejtë nga ana juaj, sqaroj se në datën 6.4.1996 është lidhur kontrata e shitjes nr. *** ndërmjet R, H, D dhe Dh.B, me cilësinë e shitësve, dhe S.Sh, M.V, R. S dhe A.B, me cilësinë e blerësve. Kjo kontratë është kryer vetëm referuar AMTP-së së shitësve, pronë e cila nuk ishte regjistruar në ZRPP-në Tiranë në momentin e lidhjes së kontratës së datës 6.4.1996. Kontrata e mësipërme nuk mund të regjistrohej pranë ZRPP-së sepse AMTP-ja që është akti mbi bazën e të cilit ishte kryer akti i shitjes nuk ishte regjistruar në ZRPP-në Tiranë. Në këto kushte i është kërkuar pronarëve shitës të sipërfaqes së tokës që fillimisht të aplikonin për regjistrimin e AMTP-së në ZRPP. Pas aplikimit të tyre për regjistrimin e AMTP-së dhe pajisjes së tyre me certifikatë për vërtetimin e pronësisë, datë 29.4.1997, për sip. 300 m², në z. k. ***, kjo pasuri është regjistruar me nr. pasurie *** (numri i saktë), volumi *, faqe *, në regjistrat e pasurive të paluajtshme.*

*Kështu, bazuar në dokumentacionin ligjor të mënyrës së fitimit të pronësisë është hartuar një kontratë e re para noteres me nr. ***, datë 31.5.1997, ndërmjet R, H, D e Dh.B dhe S.Sh, M. V, R.S, A.B e P.S për të njëjtën sipërfaqeje toke prej 300 m², të pasqyruar në kontratën e shitjes datë 6.4.1996. Në vijim, me kontratë pjesëtimi nr. ***, datë 31.5.1997, bashkëpronarët e kanë pjesëtuar këtë pasuri, nga e cila bashkëshorti im ka përfutur toke arë me sip. 500m²...”.*

209. Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ASHK-ja, rezulton se shitësit janë pajisur me dokumentacionin e pronësisë për pasurinë arë nr. **, me sip. 3000 m², në datën 25.4.1997. Duke konsideruar këtë element, si dhe faktin që transaksioni për blerjen dhe pjesëtimin e kësaj pasurie, është kryer nga bashkëshorti i subjektit para martesës, si dhe para fillimit të detyrës së subjektit, Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit pranohen me rezervë lidhur me ekzistencën e dy kontratave të shitjes. Pavarësisht këtij konstatimi, subjekti kishte detyrimin ligjor për të depozituar kontratën e shitblerjes të vitit 1997, në kuadër të procesit të rivlerësimit, për rrjedhojë, duket se ajo ka kryer deklarim të pasaktë.

⁵³ Shitësit L.B, H.B, D.B dhe Dh.B.

210. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti pretendoi se lidhur me kontratën e shitblerjes me nr. ** rep., nr. *** kol., datë 31.5.1997, këtë dokument e ka disponuar vetëm në momentin kur është konstatuar nga ana Komisionit. Në dokumentacionin që dispononte bashkëshorti i saj ka qenë vetëm kontrata e shitblerjes nr. ***, datë 6.4.1996. Pasi u vu në dijeni nga Komisioni për kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 31.5.1997, konstatoi se ky dokument i kishte munguar në të vërtetë fizikisht, por ky është dokumenti ligjor i kalimit të pronësisë, thënë ndryshe kontrata e shitjes së tokës nga shitësit tek blerësit, një ndër të cilët është edhe bashkëshorti i subjektit R.S. Ndërkohë, po t'i referohemi praktikës së hipotekës, vënë në dispozicion nëpërmjet shkresës nr. *** prot., datë 28.3.2023, edhe për shtetasin A.B, i cili është bashkëpronar në këtë pasuri, nuk ka të bashkëlidhur kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 31.5.1997. Gjithashtu, subjekti deklaroi: *“Dua të theksoj se këto veprime juridike nuk janë kryer nga unë, janë kryer nga bashkëshorti im në një kohë kur as unë as ai nuk njiheshim, ndaj dhe këto pasaktësi nuk mund të më atribuohen mua”*.

211. Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit në lidhje me këtë pasaktësi të saj nuk janë bindëse, por për sa kohë kemi të bëjmë me një pasuri të krijuar përpara martesë dhe përpara detyrë, si dhe për të cilën nuk lindin dyshime për fshehje pasurie apo të çmimit real të saj, si dhe kjo pasuri është deklaruar saktësisht në deklaratën *Vetting*, mosdepozitimi i kontratës së saktë për fitimin e kësaj pasurie nuk mund të klasifikohet si deklarim i pamjaftueshëm, në kuptim të nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016, për sa kohë nuk ka asnjë pasojë si në analizë financiare, por edhe në procesin e rivlerësimit të subjektit.

212. Nisur nga fakti që në ASHK u evidentuan dy kontrata shitblerjeje me vlera të ndryshme, subjekti është pyetur në lidhje me masën e kontributit financiar të dhënë prej bashkëshortit të saj në blerjen e pasurisë arë me sip. 3000 m², subjekti ka deklaruar se shuma e paguar nga bashkëshorti është 500,000 lekë në vitin 1996, për pjesën e tij prej 500 m². Subjektit nuk ka vënë në dispozicion asnjë dokumentacion për të provuar deklarin e saj, për rrjedhojë, Komisioni do të përfshijë në analizë financiare si shumë blerjeje shumë 5,000 USD, e cila bazohet në vlerën e kontratës së shitjes, nëpërmjet së cilës bashkëshortit të subjektit i ka kaluar pronësia mbi këtë pasuri.

213. Në vijim, me kontratë pjesëtimi nr. ***, datë 31.5.1997, bashkëpronarët S, Sh, V, B dhe S kanë vendosur të pjesëtojnë këtë tokë arë. Nga ky pjesëtim bashkëshorti i subjektit ka përfituar sipërfaqen 500 m² tokë arë, regjistruar me nr. pasurie ***.

214. Me kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 11.10.2007, bashkëshorti i subjektit ka shitur pasurinë tokë arë në vlerën 80,000 euro. Sipas dokumentacionit të administruar nga ASHK-ja rezultoi se bashkëshorti i subjektit ka paguar tatimin për shitjen e realizuar në vlerën 47,520 lekë, pasqyruar në dokumentin “veprim arke”, datë 15.10.2007, në “Raiffeisen Bank”.

215. Referuar *statement*-it bankar të llogarisë së bashkëshortit të subjektit pranë “Societe Generale Bank” (sot OTP), rezultoi se në datën 11.10.2007 ai ka depozituar *cash* në llogari vlerën 80,000 euro, nën komentin “derdhje për çelje depozite”.

ii) Në lidhje me shumën 1,421,445 lekë, gjendje në llogarinë e shtetasve R dhe G.S në Bankën e Kursimeve

216. “Raiffeisen Bank” informon se në datën 25.2.1998 shtetasit R e G.S kanë çelur pranë ish-Bankës së Kursimeve një depozitë kursimi dyemërore, me afat 3-mujor. Referuar kartelës së

kësaj depozite rezulton se gjatë periudhës 25.2.1998 – 16.3.2004 titullarët e saj kanë kryer në vazhdimësi depozitime dhe tërheqje në këtë depozitë. Në datën 31.12.2003 kjo depozitë rezulton me gjendje 1,291,032 lekë.

Në datën e mbylljes së saj, 16.3.2004, kjo depozitë rezulton me vlerë 1,356,709 lekë.

217. Në DPV/2003 bashkëshorti i subjektit ka deklaruar: *“Depozitë në lekë, nr. kartele ***, në vlerën 1,421,455.27 lekë, në Agjencinë Bankare nr. *, dega e Bankës së Kursimeve Tiranë. Kjo depozitë është në emrin tim dhe të nënës time G.S. Burimi i të ardhurave është nga qiratë e zyrave në godinën e ish-gjykatës në Rr e D, Tiranë, rreth 40,000 lekë në muaj nga viti 1996”.*

Referuar kartelës së kësaj depozite rezulton se në datën 31.12.2003 kjo depozitë rezulton me gjendje 1,291,032 lekë.

218. Nga analiza financiare⁵⁴ duket se subjekti dhe personat e lidhur me të kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për furnizimin me fonde të depozitës pranë Bankës së Kursimeve Tiranë.

Analiza financiare për bonot e thesarit në vlerën 6,000,000 lekë

219. Nga hetimi rezultoi se në datën 11.10.2007, në llogarinë nr. *** në OTP Bank, bashkëshorti i subjektit ka depozituar shumën 80,000 euro, nën komentin *“derdhje cash R.S, derdhje për çelje depozite”.* Më tej, në datën 13.10.2008, ai ka konvertuar me kurs preferencial 123.3 shumën 50,767 euro, duke i transferuar nga llogaria e tij në lekë për blerje bono thesari në vlerën 6,000,000 lekë.

✓ Për sa më sipër, nuk evidentohen paqartësi në lidhje me burimin e krijimit të bonove të thesarit në vlerën 6,000,000 lekë.

Analiza financiare për bonot e thesarit në vlerën 1,600,000 lekë

220. Nga hetimi rezultoi se në datën 30.1.2012 bashkëshorti i subjektit ka riinvestuar në bono thesari shumën 4,000,000 lekë dhe në datën 31.1.2012 shumën 1,600,000 lekë.

Në deklaratimet e tij subjekti ka pretenduar se *burimi i të ardhurave për krijimin e fondeve të investuara në bono thesari në vlerën 1,600,000 lekë janë fondet e tërhequra në datën 26.12.2011, në vlerën 1,254,800 lekë, nga llogaria dyemërore R dhe G.S, fondet nga interesat e bono të thesarit të muajit nëntor 2011 në vlerën 275,928 lekë, si dhe interesin e bono të thesarit 98,757 lekë.*

221. Nga nxjerrjet e llogarive bankare rezulton se:

i. Në datën 23.12.2005 shtetasja G.S depoziton *cash* shumën 1,500,000 lekë, të cilën i mbyll në depozitë me afat. Në datën 24.12.2007 bashkëshorti i subjektit tërheq *cash* shumën 674,890 lekë. Kjo llogari ka mbetur e pandryshuar deri në datën 26.12.2011, kur bashkëshorti i subjektit tërheq këto fonde nga kjo llogari në vlerën 1,254,800 lekë.

ii. Interesi i përfituar nga bonot e thesarit në vlerën 4,000,000 lekë për vitin 2011 është 275,928 lekë.

⁵⁴ Shihni tabelën nr. 12 të rezultateve të hetimit.

iii. Interesi i përfituar nga bonot e thesarit në shumën 98,757 lekë është tërhequr nga bashkëshorti i subjektit më 3.11.2011.

222. Bazuar në të dhënat e mësipërme duket se në fund të vitit 2011 bashkëshorti i subjektit ka pasur të tërhequr në total shumën 1,500,000 lekë, për të cilën nga analiza financiare rezulton se ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për kursimin e saj. Në kushtet kur nga subjekti i rivlerësimit gjendje *cash* e vitit 2011 është deklaruar në një shumë më të lartë se shuma 1,500,000 lekë, Komisioni nuk do ta përfshijë si kursim *cash* këtë shumë.

223. Në përfundim, nga analiza financiare⁵⁵, duket se bashkëshorti i subjektit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme në shumën 736,911.63 lekë për krijimin e bonove në vlerën 1,600,000 lekë.

224. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti ka pretenduar se ka dhënë të gjitha argumentet që provojnë se ka pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e gjendjes *cash* të deklaruar në shumat 5,100 USD, 6,630 euro dhe 1,500,000 lekë. Një pjesë e këtyre kursimeve *cash*, shuma 1,500,000 lekë duhet përfshirë si pakësim likuiditetesh në analizën e datës 31.1.2012, pasi është deklaruar prej subjektit si burim dhe po ashtu është vërtetuar që është me burime të ligjshme. Në mënyrë të detajuar shpjegimet e subjektit në lidhje me shumën 1,500,000 lekë janë trajtuar në pikën 179-182 të këtij vendimi.

225. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, mbështetur edhe në argumentimin në pikën 183 të këtij vendimi, vendosi të përfshijë në analizë financiare shumën 1,500,000 lekë.

Në përfundim rezulton se duke përfshirë në analizë financiare shumën 1,500,000 lekë bashkëshorti i subjektit ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e bonove të thesarit.

Në lidhje me krijimin e depozitës 1,500,000 lekë në OTP Bank, më 23.12.2005

226. Në DPV/2003 bashkëshorti i subjektit ka deklaruar: *“Depozitë në lekë, nr. kartele ***. Kjo depozitë është në emër të nënës G dhe timin, vlera e depozitës 1,421,445.27 lekë. Depozitë pranë Agjencisë Bankare nr. *, dega e Bankës së Kursimeve Tiranë. Burimi i të ardhurave: qiratë e zyrave në godinën e ish-gjykatës në Rr e D...”*.

Në DPV/2004 subjekti ka deklaruar: *“Në fund të vitit 2005 bashkëshorti im R.S dhe nëna e tij G.S kanë mbyllur depozitën e tyre në ‘Raiffeisen Bank’ dhe këtë shumë prej 1,500,000 lekësh e kanë depozituar në Bankën Popullore, dega Tiranë”*.

227. Nga nxjerrja e llogarive bankare pranë “Raiffeisen Bank” (shkresa nr. *** prot., datë 31.10.2022) rezulton se në datën 25.2.1998 shtetasit R e G.S kanë çelur pranë ish-Bankës së Kursimeve një depozitë kursimi dyemërore, me afat 3-mujor. Referuar kartelës së kësaj depozite rezulton se gjatë periudhës 25.2.1998 – 16.3.2004 titullarët e saj kanë kryer në vazhdimësi depozitime dhe tërheqje në këtë depozitë. Në datën e mbylljes së saj, 16.3.2004, kjo depozitë rezulton me vlerë 1,356,709 lekë.

Nga nxjerrja e llogarive bankare pranë OTP Bank rezulton se në datën 23.12.2005 shtetasja G.S depoziton *cash* shumën 1,500,000 lekë, të cilat i mbyll në depozitë me afat.

⁵⁵ Shihni tabelën nr. 13 të rezultateve të hetimit.

228. Nga verifikimi i deklarimeve të subjektit në DPV/2004 nuk konstatohet që nga ana e saj shuma prej 1,356,709 lekësh të jetë deklaruar si kursim *cash*. Kjo shumë nuk rezulton e deklaruar si kursim *cash* as në pyetësin standard të subjektit, pasi për vitin 2004 pretendon gjendje *cash* në shumën 1,000 USD. Komisioni, me qëllim realizimin e një analize financiare sa më shteruese për subjektin, ka kryer një analizë mbi mundësinë hipotetike të subjektit për kursimin e shumës 1,500,000 lekë *cash*, e cila sipas deklarimeve të saj në DPV/2005 ka shërbyer për krijimin e depozitës në fund të vitit 2005. Nga kjo analizë subjekti rezulton me një mungesë burimesh të ligjshme në shumën 312,244.97 lekë.

229. Komisioni, në lidhje me tërheqjen e shumës 1,357,709 lekë, e cila sipas deklarimeve të subjektit ka shërbyer si burim për shumën 1,500,000 lekë, vlerëson të mos e konsiderojë si kursim *cash*, pasi:

- a. subjekti nuk rezulton të ketë deklaruar si kursim *cash* në DPV/2004;
- b. subjekti, nëse hipotetikusht konsiderohet shuma 1,500,000 lekë, është në pamundësi financiare për krijimin e kësaj shume në vlerën 280,643.97 lekë;
- c. distanca kohore nga tërheqja e kësaj shume deri në rifutjen e saj në depozitë është 1 vit e 9 muaj;
- d. subjekti ka rritur likuiditetet bankare gjatë viteve 2004 - 2005.

Nga nxjerrja e llogarive bankare pranë OTP Bank rezulton se në datën 23.12.2005 shtetasja G. S depoziton *cash* shumën 1,500,000 lekë, të cilat i mbyll në depozitë me afat. Nga analiza financiare⁵⁶ duket se bashkëshorti i subjektit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme në shumën 342,089.56 lekë për krijimin e depozitës në vlerën 1,500,000 lekë.

230. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti pretendoi se sipas *statement*-it bankar bashkëngjitur këtij materiali bashkëshorti dhe nëna e tij kanë pasur gjendje në “Raiffeisen Bank” në vitin 2003, ashtu siç ka konstatuar edhe Komisioni, shumën prej 1,291,032 lekësh. Kjo shumë nuk është tërhequr në vitin 2004, por në datën 19.12.2005, tërhequr shuma 1,511,405 lekë, me përshkrimin “R.S sa tërheq nga llogaria”. Gjithashtu, shtetasja G.S në datën 19.12.2005 ka tërhequr nga llogaria e saj pranë “Raiffeisen Bank” shumën 1,511,405 lekë dhe në datën 23.12.2005 ka derdhur në “Societe Generale Albania” (sot OTP Bank) shumën 1,500,000 lekë.

Lidhur me këtë pretendim, subjekti, pas kalimit të barrës së provës, ka depozituar nxjerrje të llogarisë bankare të lëshuar nga “Raiffeisen Bank” në emër të bashkëshortit të saj, ku evidentohet se tërheqja e shumën prej 1,511,405.81 lekësh është kryer në datën 19.12.2005, sikurse është pretenduar nga subjekti.

231. Komisioni, pasi analizoi këtë provë të re, konstaton se ndryshe nga sa ishte informuar nga “Raiffeisen Bank” shuma prej 1,357,709 lekësh, bazuar në nxjerrjen e llogarisë të depozituar nga subjekti, ka vijuar të jetë në llogari bankare dhe në datën 15.12.2005 gjendja ka qenë në shumën 1,511,405 lekë dhe është tërhequr në datën 19.12.2005 nga bashkëshorti i subjektit. Në lidhje me këtë provë të re, Komisioni ka kryer rregullimet e nevojshme në analizë financiare, për rrjedhojë, duke marrë në konsideratë faktin se bashkëshorti i subjektit e ka tërhequr shumën 1,500,000 lekë në datën 19.12.2005 dhe nëna e bashkëshortit ka depozituar shumën 1,500,000 lekë në datën 23.12.2005, si dhe deklarin e subjektit në DPV/2005, ku deklaroi se në fund

⁵⁶ Shihni tabelën nr. 15 të rezultateve të hetimit.

të vitit 2005 bashkëshorti dhe nëna e tij kanë mbyllur depozitën në “Raiffeisen Bank” në shumën 1,500,000 lekë dhe këtë shumë e kanë depozituar në Bankën Popullore, rezulton se ata kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e kësaj depozite.

232. Nga dokumentacioni i administruar, si dhe nga nxjerrja e llogarisë për bono thesari nga Banka e Shqipërisë, rezulton se në datën 29.4.2014 bashkëshorti i subjektit ka investuar fonde në bono thesari në vlerën 1,400,000 lekë.

233. Në lidhje me burimin e të ardhurave për krijimin e bonove të thesarit në vlerën 1,400,000 lekë në DPV/2014, subjekti ka deklaruar: *“Nga shuma 53,000 euro nga shitja e apartamentit më 20.8.2013, bashkëshorti ka depozituar në ‘ProCredit Bank’ shumën 36,000 euro, datë 21.4.2014. Nga kjo shumë e mësipërme ai ka depozituar më 22.4.2014 bono thesari në shumën 1,400,000 lekë”.*

234. Në lidhje me këtë shumë, nga hetimi ka rezultuar se në BKT⁵⁷ rezulton i regjistruar transaksioni në arkë i kryer në datën 21.4.2014 nga bashkëshorti i subjektit në llogarinë “për bono thesari”, me përshkrim veprimi “derdhje për bono thesari” në vlerën 1,400,500 lekë.

235. Subjekti në DPV/2014 ka deklaruar: *“Bashkëshorti im R.S ka shitur apartamentin sipas kontratës së datës 20.8.2013, në shumën 53,000 euro, të cilën e ka deklaruar në DPV/2014. Nga kjo shumë e mësipërme R.S ka depozituar në ‘ProCredit Bank’ shumën 36,000 euro në datën 21.4.2014. Nga kjo shumë R.S ka depozituar në datën 22.4.2014 në bono thesari shumën 1,400,000 lekë, përfituar interes për këtë shumë 45,519 lekë në tetor 2014”.*

236. Komisioni, në lidhje me burimin e kësaj depozite, ka kryer një analizë financiare, duke mos përfshirë si kursim *cash* shumën 50,000 euro, , nga ku subjekti ka rezultuar me mungesë burimesh të ligjshme në shumën 5,860,171 lekë.

237. Në lidhje me shumën 50,000 euro, Komisioni e ka analizuar gjerësisht në pikat 137-139 të këtij vendimi.

Për sa më sipër, me përfshirjen në analizë financiare të shumës 50,000 euro si kursim *cash* për, rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e bonove.

238. Depozitë me afat në bankën “Societe Generale Albania”⁵⁸, çelur në datën 11.10.2007, në vlerën 80,000 euro, gjendje në datën 13.10.2016, në vlerën 13,408 euro, në emër të bashkëshortit të subjektit

Burimi i krijimit sipas deklaratës *Vetting*: deklaruar te rubrika 2 sa më sipër kësaj deklarate (shitja e pasurisë tokë arë me sip. 500 m², në vlerën 80,000 euro). Si rrjedhojë e veprimeve të kryera në llogari ajo rezulton në datën 13.10.2016 në vlerën 80,000 - 50,767 - 18,630 - 3,000 + interesa = 13,408 euro.

Hetimi⁵⁹/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

⁵⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 18.9.2020, drejtuar bankave të nivelit të dytë; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 5.10.2020, e BKT-së.

⁵⁸ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) kontratë për çelje depozite datë 13.10.2016, e lidhur midis *** Bank dhe shtetasit R.S, me afat 12 muaj, me vlerë 13,408 euro; (ii) nxjerrje llogarie datë 13.10.2016, e lëshuar nga *** Bank.

⁵⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 18.9.2020, drejtuar bankave të nivelit të dytë; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 1.10.2020, e OTP Bank; shkresë nr. *** prot., datë 18.9.2020, drejtuar ASHK-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 13.10.2020, e ASHK Tirana Rurale 1.

239. Nga nxjerrja e llogarive bankare të bashkëshortit të subjektit, rezultoi se:

i. Në datën 11.10.2007 në llogarinë e tij nr. *** në OTP Bank, bashkëshorti i subjektit ka depozituar shumën 80,000 euro, nën komentin “derdhje *cash* R.S, derdhje për çelje depozite”.

ii. Në datën 13.10.2008 bashkëshorti i subjektit ka konvertuar me kurs preferencial 123.3 shumën 50,767 euro, të cilën e ka investuar në bono thesari në vlerën 6,000,000 lekë. Diferencën e mbetur prej 30,000 euro e ka mbyllur në depozitë me afat në OTP Bank.

iii. Depozita 30,000 euro ka gjeneruar interesa dhe në datën 13.10.2011 bashkëshorti i subjektit ka tërhequr *cash* shumën 18,630 euro. Vlera e mbetur prej 15,000 euro ka kaluar në depozitë me afat, duke gjeneruar interesa periodikë. Në datën 13.10.2016 bashkëshorti i subjektit ka tërhequr nga llogaria shumën 3,000 euro dhe gjendja e llogarisë në këtë datë rezulton 13,407.23 euro, e cila mbetet e pandryshuar deri në deklaratën *Vetting*.

240. Në lidhje me burimin e të ardhurave, ai është trajtuar në pikën 214 të këtij vendimi.

✓ Në përfundim konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë pasuri të subjektit.

241. Llogari rrjedhëse në euro, pranë “Raiffeisen Bank”⁶⁰, çelur më 8.1.2016, për derdhjen e të ardhurave nga qiratë e godinës/Universiteti * për mësimdhënie, që rezulton nga këto të ardhura, në vlerën totale 5,883.25 euro, më 30.12.2016**

Burimi i krijimit sipas deklaratës *Vetting*: “Në datën 8.1.2016 kam hapur një llogari rrjedhëse në euro për depozitim në këtë llogari të pjesës takuese të qirasë që e përfitojmë të dy vëllezërit, E dhe R.S. Pjesa takuese e qirasë mujore sipas kontratës është 11,100 euro/muaj – 1,665 euro/muaj tatim qiraje = 9,435 euro/muaj qira neto totale/12 pjesëtarë = 786/2 = 393 euro/muaj x 12 muaj = 4,716 euro + 393 euro (+ 1 muaj paradhënie) = 5,109 euro. Konkretisht, sipas statement-it të ‘Raiffeisen Bank’, nr. klienti B*** euro, rezulton se nga derdhjet dhe tërheqjet pjesa takuese imja është: derdhjet për qiratë e 15 muajve; nëntor 2015 – dhjetor 2016 (+1 muaj paradhënie sipas kont.) = 786 euro / muaj x 15 muaj = 11,790 euro. Kësaj shume i zbritet 1,572 euro, pjesa takuese e vëllait tim, të cilën unë për efekt të mbylljes së llogarisë sime rrjedhëse në euro në ‘ProCredit Bank’ e kam kaluar në llogarinë e kursimit në emrin tim në ‘ProCredit Bank’, në datën 11.12.2015. Për rrjedhojë, pjesa takuese imja për vitin 2016 nga qiratë është (11,790 – 1.572/2 = 5,109 euro.

Vlera: 5,883.25 euro. Pjesa takuese: 100%. Vlera 5,109 euro është 100% e shtetasit R.S”.

Hetimi⁶¹/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

242. Nga nxjerrja e llogarive bankare të bashkëshortit të subjektit në “Raiffeisen Bank” rezultoi se në datën 8.1.2016 bashkëshorti i subjektit ka çelur llogari rrjedhëse nr. B*** pranë kësaj banke, në të cilën janë kredituar shuma të ndryshme nga një prej bashkëpronarëve të pasurive

⁶⁰ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 18.1.2017, e lëshuar nga “Raiffeisen Bank”, e cila konfirmon se në lidhje me kërkesën e shtetasit R.S kanë bashkëngjitur: pasqyrën e llogarisë në monedhën euro për periudhën 8.1.2016 – 1.1.2017, pasqyrën e llogarisë në monedhën USD për periudhën 27.3.2015 – 29.3.2016; (ii) nxjerrje llogarie datë 5.1.2017 nga “Raiffeisen Bank”, e regjistruar në emër të shtetasit R.S, për periudhën 5.1.2016 – 5.1.2017.

⁶¹ Shkresë nr. *** prot., datë 18.9.2020, drejtuar bankave të nivelit të dytë; Shkresë kthim përgjigjeje të “Raiffeisen Bank”, nr. *** prot., datë 30.10.2020.

të paluajtshme të dhëna me qira. Në datën 16.1.2017 gjendja e llogarisë rezulton në vlerën 5,881.25 euro.

243. Në lidhje me burimin e të ardhurave të kësaj llogarie, bashkëshorti i subjektit deklaron se ajo furnizohet nga të ardhurat e krijuara nga qiradhënia e godinës 3-katëshe në favor të Universitetit ***.

244. Nga analizimi i kontratave të qirave të këtij objekti rezulton se bashkëshorti i subjektit dhe 13 bashkëpronarët e tjerë të kësaj pasurie kanë lidhur kontratën e qirasë nr. ***, datë 6.7.2015, me qiramarrësin “****” sh.p.k., me afat 4-vjeçar, duke nisur nga data 1.7.2015 deri më 30.6.2019, me qira mujore në vlerën 11,100 euro. Referuar përmbajtjes së kontratës, qiraja do të paguhet në nr. e llogarisë *** në “ProCredit Bank”. Vlera totale e përfituar nga bashkëshorti i subjektit është 3/72 pjesë mbi qiranë vjetore, e cila rezulton në vitin 2015 – 1,965 euro, në vitin 2016 – 4,716 euro, në vitin 2017 – 4,716 euro.

245. Në përfundim, rezulton se depozitimet e kryera në këtë llogari bankare kanë si burim të ardhurat e përfituara nga kontrata e qirasë nr. ***, datë 6.7.2015, e lidhur me qiramarrësin “****” sh.p.k.

✓ Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar.

246. Bashkëpronar në pasurinë e paluajtshme godinë 3-katëshe, e ndodhur në Rr e D⁶², Tiranë dhe bashkëpronar në dy dyqanet që ndodhen në katin e parë të kësaj godine mbi një truall me sip. 670.25 m². Këto pasuri janë të regjistruara në ZVRPP-në Tiranë, si vijon:

1. me nr. pasurie ***, vol. **, f. ***, z. k. ***, apartament me sip. 338.06 m²;
2. me nr. pasurie ***, vol. **, f. ***, z. k. ***, apartament me sip. 336.06 m²;
3. me nr. pasurie ***, vol. **, f. ***, z. k. ***, apartament me sip. 85.44 m²;
4. me nr. pasurie ***-B, vol. **, f. ***, z. k. ***, bodrum me sip. 107.5 m²;
5. me nr. pasurie ***-N*, vol. **, f. ***, z. k. ***, njësi me sip. 64.6 m²;
6. me nr. pasurie ***-N*, vol. **, f. ***, z. k. ***, njësi me sip. 60.4 m².

Burimi i krijimit sipas deklaratës *Vetting*: godina 3-katëshe, e ndodhur në Rr e D, Tiranë dhe trualli prej 670.27 m², mbi të cilin ajo ndodhet, u është kthyer trashëgimtarëve ligjorë I, H dhe K.A, me vendimin nr. ***, datë 16.2.1995 të KKKPronave ish-pronarëve të Bashkisë Tiranë. Dy dyqanet e katit të parë të kësaj godine 3-katëshe, e ndodhur në Rr e D, Tiranë, janë kthyer me vendimin nr. ***, datë 5.12.1993, të KKKPronave ish-pronarëve të Bashkisë Tiranë. “Unë, R. S dhe E.S, jemi trashëgimtarë ligjorë të nënës sonë G(A) S, e cila është trashëgimtare ligjore

⁶² Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) kartelë të pronësisë për pasurinë apartament nr. ***, me sip. 338.06 m² – shtetasi R.S mbi këtë pasuri zotëron 3/72 pjesë takuese; (ii) kartelë të pronësisë për pasurinë apartament nr. ***, me sip. 338.06 m² – shtetasi R.S mbi këtë pasuri zotëron 3/72 pjesë takuese; (iii) kartelë të pronësisë për pasurinë apartament nr. ***, me sip. 285.44 m², mbi këtë pasuri zotëron 3/72 pjesë takuese; (iv) kartelë të pronësisë për pasurinë bodrum nr. ***-B, me sip. 107.5 m², mbi këtë pasuri zotëron 3/72 pjesë takuese; (v) kartelë të pronësisë për pasurinë njësi nr. ***-N*, me sip. 64.6 m², mbi këtë pasuri zotëron 3/72 pjesë takuese; (vi) kartelë të pronësisë për pasurinë njësi nr. ***-N*, me sip. 60.4 m², mbi këtë pasuri zotëron 3/72 pjesë takuese; (vii) vendim nr. ***, datë 16.2.1995, i lëshuar nga KKKPronave; (viii) vërtetim hipotekor nr. ***, datë 17.5.2000, për pasurinë nr. ***-N, e ndodhur në z. k. ***, Tiranë – shtetasja G.S mbi këtë pasuri zotëron 3/36 pjesë takuese; (ix) dëshmi trashëgimie nr. ***, datë 28.9.1993; (x) dëshmi trashëgimie nr. ***, datë 21.6.2013, e lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

e ish-pronarit K.A [bashkëpronësi në rrugë trashëgimie ligjore nga nëna G.S (A)]. Pjesa takuese: 1/24 pjesë ideale”.

Hetimi⁶³/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

247. Me vendimin nr. ***, datë 5.12.1993, KKKPronave ish-pronarëve ka vendosur:

a) Të miratojë kërkesën e pronarëve H, I e K.A⁶⁴ për kthimin e pronës së përbërë prej dy dyqaneve, që ndodhen në katin e parë të godinës 3-katëshe në Rr e D.

b) Të kalojë pronën e mësipërme nga pronësi shtetërore në pronësi të pronarëve H, I e K. A.

Bazuar në këtë vendim, këto pasuri kanë kaluar nga pronësi shtetërore në pronësi të bashkëpronarëve H, I e K.A.

248. Me vendimin nr. ***, datë 16.2.1995, KKKPronave ish-pronarëve ka vendosur:

a) Të njohë ish-pronarë H, I e K.A (trashëgimtarët e tyre) të pronës së tyre të përbërë prej një sipërfaqe truall prej 670.25 m², që ndodhet në Lagjen e Re të Tiranës, si dhe të godinës së ngritur brenda kufijve të këtij truall.

b) Prona kthehet dhe kompensohet si vijon:

- Një truall me sip. 670.25 m², në të cilin është ndërtuar pallat 3-katësh, që gjendet në Rr e D dhe u njihet pronarëve H, I e K.A (trashëgimtarëve të tyre) pronësia mbi truallin dhe ndërtesën.

- Shtesa e bërë në ndërtesën 3-katëshe, ngjitur me atë ekzistuese, u njihet pronarëve H, I e K. A (trashëgimtarëve të tyre), pasi t'i paguajnë arkës së shtetit kundërvleftën prej 591,071 lekësh.

Mbi bazë të këtij vendimi, pasuria u regjistrua në bashkëpronësi të 11 pronarëve A, C, D, B.

249. Me vendimin nr. ***, datë 28.9.1993, të noteres M.S, është vendosur lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë për trashëgimlënësin K.A dhe R.A, duke përcaktuar 6 trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë, ndër të cilët G.S⁶⁵, e cila trashëgoi 3/12 pjesë takuese të pasurisë trashëgimore.

250. Mbi bazë të vendimit noterial dhe atij të AKKP-së, pasuria truall 670.25 m² dhe godina 3-katëshe është regjistruar në regjistrin hipotekor, datë 13.4.1995, në pronësi të shtetasve M.A, G.S e V.B, secili nga 3/12 pjesë të pasurisë së K.S; D.A, K.A dhe D.A, secili nga 1/12 pjesë të pasurisë së K.A.

251. Me vendimin nr. *** akti, datë 21.6.2013, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë për të ndjerën G.S, duke përcaktuar si trashëgimtarë ligjorë të saj dy fëmijët E dhe R.S, të cilët trashëguan në mënyrë të barabartë ½ pjesë takuese të pasurisë trashëgimore.

252. Mbi bazë të këtij vendimi, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. R.S, përfitoi 3/72 pjesë takuese mbi pasuritë e ndodhura në godinën 3-katëshe, të ndodhur në Rr e D.

✓ Nuk ka dyshime apo paqartësi lidhur me këtë pasuri.

253. R.S, pronar i pasurisë së paluajtshme apartament banimi⁶⁶, i ndodhur në rrugën “Lidhja e Prizrenit”, Tiranë, me sipërfaqe 63 m². Kjo pasuri, sipas certifikatës për

⁶³ Shkresë nr. *** prot., datë 21.9.2022, drejtuar ASHK Veri; kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 10.10.2022, e ASHK Veri.

⁶⁴ Babai i shtetas G.A (S), nënës së bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

⁶⁵ Nëna e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

⁶⁶ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) certifikatë pronësie për pasurinë apartament nr. ***, me sip. 63 m², i ndodhur në z. k. ***, Tiranë, në pronësi të shtetasit R.S; (ii) certifikatë dhe kartelë të pronësisë për pasurinë apartament nr. ***, me sip. 63 m², i ndodhur në z. k. ***, Tiranë, në pronësi të shtetasve G.S dhe R.S; (iii) kontratë

vërtetim pronësie datë 11.2.2002, është e regjistruar në ZVRPP-në Tiranë me nr. pasurie * , z. k. ***.**

Burimi i krijimit sipas deklaratës *Vetting*: “Ky apartament është blerë nga Ndërmarrja Komonale Banesa me kontratën e shitjes nr. ***, datë 23.11.1994, bazuar në ligjin për privatizimin e banesave shtetërore, në bashkëpronësi me 1/2 pjesë të pandarë të nënës sime G. S dhe unë R.S, regjistruar në hipotekë me nr. *** regjistri hipotekor, datë 30.11.1994. Në datën 5.2.2002, nëna ime G.S më ka shitur pjesën e saj takuese në këtë pasuri me kontratën e shitjes nr. ***rep., nr. ** kol., datë 5.2.2002, në vlerën 20.000 lekë. Privatizuar nga Ndërmarrja Komonale Tiranë, pjesa takuese 100%”.

Hetimi⁶⁷/ analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

254. Me kontratë shitjeje datë 20.5.1994, bashkëshorti i subjektit dhe nëna e tij, znj. G.S, kanë blerë nga NKBanesa nr. * apartamentin me sip. 63 m², të ndodhur në rrugën “Lidhja e Prizrenit” për çmimin 1,618 lekë.

255. Me kontratë shitjeje nr. ***, datë 5.2.2002, shtetasja G.S ka shitur pjesën e saj takuese të këtij apartamenti në favor të djalit të saj R.S për çmimin 20,000 lekë. Si rrjedhojë, apartamenti është regjistruar në pronësi individuale të bashkëshortit të subjektit, i cili rezulton të jetë pajisur me certifikatë pronësie, datë 11.2.2002.

256. Nga viti 2003 e në vijim, ky apartament është deklaruar si adresë banimi e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj.

✓ Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar, si dhe nuk paraqiten paqartësi apo dyshime në lidhje me këtë pasuri.

257. Automjet tip “Toyota Rav 4”⁶⁸ me targa AA * HD, e blerë në Gjermani në vlerën 12,000 euro. Pjesa takuese: 100%.**

Burimi i krijimit sipas deklaratës *Vetting*: Lidhur me burimin e krijimit të kësaj vlere është sqaruar te rubrika 5 e deklaramit të subjektit Fahrije Stringa, e cila rezulton nga tërheqja pranë bankës “Societe Generale Albania” (sipas *statement*-it të kësaj banke, tërhequr në datën 13.10.2016 vlere 18,630 euro, nga e cila sipas D. Dog. Imp. nr. ***, datë 4.10.2011, paguar për blerje makine 12,000 euro, përfshirë TVSH).

Hetimi⁶⁹/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

258. Me faturë blerjeje datë 22.9.2011, nënshkruar në shtetin gjerman me shitësin W.H, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka blerë automjetin e tipit “Toyota Rav *”, në vlerën

shitjeje nr. ***, datë 23.11.1994; (iv) kontratë shitblerjeje për pjesë të pandarë të apartamentit nr. ***, datë 5.2.2002.

⁶⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 18.9.2020, drejtuar ASHK-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 20.10.2020, e ASHK-së.

⁶⁸ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) vërtetim nr. *** prot., datë 28.5.2012, i lëshuar nga DPSHTRR-ja; (ii) dosje të mjetit me targa AA *** BH, ku janë bashkëngjitur: deklaratë doganore për automjetin tip “Toyota”, në pronësi të shtetasit R.S, për të cilën është kryer zhdoganimi në shumën 280,512 lekë; (iii) lejeqarkullim e përkthyer e mjetit tip “Toyota”; (iv) faturë blerjeje e lëshuar në datën 22.9.2011 (në gjuhën gjermane), e lidhur midis palës shitëse W.H dhe palës blerëse R.S, me objekt “blerje e automjetit tip ‘Toyota Rav *’, me shasi nr. JTEGR***, në shumën 11,700 euro bruto, neto 9,831.93 euro, zbritje 1,868.07 euro”.

⁶⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 18.9.2020, drejtuar DPSHTRR-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 28.9.2020, e DPSHTRR-së; shkresë nr. *** prot., datë 21.9.2022, drejtuar DPSHTRR-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 6.10.2022, e DPSHTRR-së.

9,831.93 euro. Referuar deklaratës doganore Import *, datë 4.10.2011, ky automjet është zhdoganuar kundrejt vlerës 280,512 lekë nga importuesi R.S.

259. Bashkëshorti i subjektit e ka deklaruar blerjen e këtij automjeti në DPV/2011 me të njëjtin përshkrim si në deklaratën *Vetting*.

260. Si burim për blerjen e këtij apartamenti janë deklaruar fondet e tërhequra në datën 13.10.2011 nga llogaria e bashkëshortit të subjektit në bankën “Societe Generale Albania”.

Nga shqyrtimi i kësaj llogarie bankare konfirmohet tërheqja e vlerës 18,630 euro në datën 13.10.2011 në këtë bankë.

261. Duke konsideruar faktin se nga të dhënat e sistemit TIMS rezulton se bashkëshorti i subjektit ka dalë në datën 22.9.2011 dhe ka hyrë më 26.9.2011, fatura e blerjes së mjetit daton më 22.9.2011 dhe tërheqja e shumës 18,630 euro nga llogaria është kryer në datën 13.10.2011. Rezulton se kjo shumë nuk mund të ketë shërbyer si burim për pagesën e kryer për blerjen e mjetit.

262. Komisioni kreu analizën financiare⁷⁰ duke marrë në konsideratë të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj deri në datën e blerjes së automjetit. Nga analiza financiare duket se subjekti dhe bashkëshorti i saj nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e automjetit në vlerën -1,121,651.811 lekë.

Në përfundim, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit për mungesë burimesh të ligjshme të ardhurash dhe deklarim të pasaktë në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie.

263. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti pretendoi se kjo pasuri është krijuar nga të ardhurat e rezultuara nga tërheqja pranë bankës “Societe Generale Albania” (sipas *statement*-it të kësaj banke, *tërhequr në datën 13.10.2016 vlera 18,630 euro, nga e cila sipas D. Dog. Imp. nr. ***, datë 4.10.2011, paguar për blerje makine 12,000 euro, përfshirë TVSH*). Dokumenti që vërteton blerjen e këtij automjeti përmban datën 22.9.2011, nënshkruar në shtetin gjerman, dhe mban vlerën 9,831.93 euro. Referuar deklaratës doganore Import *, datë 4.10.2011, ky automjet është zhdoganuar kundrejt vlerës 280,512 lekë nga importuesi R.S. Shumën për pagimin e çmimit të këtij automjeti bashkëshorti i saj e ka marrë nga shtetasi A.B, kushëri i tij i cili jeton në Gjermani dhe i mundësoi qëndrimin atje dhe sigurimin e blerjes së një automjeti.

Fakti i pagimit të çmimit nga ky shtetas del edhe nga dokumenti i lëshuar nga banka “CommerzBank”, ku pasqyrohen veprimet bankare datë 9.9.2011, ku rezulton se ky shtetas ka tërhequr shumën 12,000 euro, shumë e cila përkon me vlerën e automjetit, dokument ky i noterizuar dhe i përkthyer nga gjuha gjermane në shqip, në formën e kërkuar nga ligji. Për më tepër që edhe lidhur me njoftimin e taksës për këtë mjet është përcaktuar kryerja e veprimeve drejtpërdrejt në llogarinë bankare të shtetasit A.B, sikurse del nga dokumenti “Njoftim i taksës së mjeteve motorike”, datë 18.10.2011, i zyrës së taksave K-M, drejtuar z. R.S. Këto dy dokumente përmbajnë të njëjtin nr. llogarie ***, me titullar shtetasin A.B.

Subjekti ka deklaruar: *“Pra, të gjitha veprimet e kryera në atë kohë provojnë plotësisht faktin se pagesa e kryer në shtetin gjerman është kryer nga z. A.B, dhe më pas kjo shumë i është kthyer sapo bashkëshorti im ka kryer tërheqjen në bankë, në datën 13.10.2011.*

⁷⁰ Shihni tabelën nr. 16 të rezultateve të hetimit.

Të gjitha argumentet e mësipërme vërtetojnë se si burim për pagesën e automjetit ka shërbyer tërheqja nga OTP Bank e shumës 18,630 euro, ndërsa shtetasi A.B e ka ndihmuar për një periudhë shumë të shkurtër kohore, brenda një afati 1-mujor (pra, brenda harkut 1-vjeçar të deklarimit periodik), pasi shuma i është kthyer menjëherë pasi bashkëshorti im ka mbërritur në Shqipëri dhe ka bërë të mundur tërheqjen e shumës”.

264. Subjekti u ka bashkëlidhur parashtrimeve të saj:

- *Deklaratë noteriale datë 29.3.2023, e hartuar në shtetin gjerman nga shtetasi A.B. Në përmbajtje të kësaj deklaratë, në lidhje me automjetin “Toyota”, deklaruesi shprehet se në shtator 2011 R. S ka qëndruar në shtëpinë e tij në B, pasi ishte i interesuar të blinte një makinë. Ai vendosi të blejë makinën “Toyota”, që kushtonte rreth 12,000 euro. Meqenëse R nuk e dispononte këtë shumë, ra dakord me B që t’ia huazojë këtë shumë dhe të cilën R. S ia ka kthyer nënës së tij pas kthimit në Tiranë. B deklaroi se përmes llogarisë së tij bankare është kryer edhe pagesa për targën e përkohshme të qarkullimit deri në mbërritjen në Tiranë.*
- *Lëvizje e llogarisë bankare të A.B pranë “CommerzBank” Gjermani, ku evidentohet tërheqja e vlerës 12,000 euro, e kryer prej tij në datën 19.8.2011.*
- *Njoftim i taksës së mjeteve motorike për z. B, vulosur nga zyra e menaxhimit financiar të landit N-W, ku evidentohet kërkesa për pagesë të taksës motorike 10 euro.*
- *Vërtetim datë 28.3.2023 i Universitetit B, Gjermani, lidhur me punësimin e shtetasit A. B si drejtues i grupit kërkimor dhe pedagog pranë këtij universiteti prej vitit 2010.*
- *Shkresë e O.E të M.M, datë 13.11.1997, ku citohet transferimi i kësteve tremujore të bursës së A. B në “Deutsche Bank”.*
- *Shkresë e “Deutsche Bank”, datë 3.11.1997, lidhur me transferimet e fondeve nga urdhërpagesat e ***.*
- *Vërtetim i “C.N”, datë 24.5.2002, përmes të cilit vërtetohet se A. B ka qenë student postdoktoral në laboratorin e kësaj qendre në periudhën 1.5.1996 – 31.1.1999, si dhe Curriculum Vitae i A. B.*
- *Shkresë nr. *** prot., datë 28.3.2023, e ASHK Drejtoria Vendore Tirana Rurale 1, së cilës i bashkëlidhet kontrata e shitjes nr. ***, lidhur në nëntor 2007, përmes së cilës A.B ka shitur pasurinë tokë arë me sip. 500 m², ndodhur në Sauk, Tiranë, kundrejt çmimit 80,000 euro.*
- *Pasqyrim i veprimeve bankare, si dhe certifikatë regjistrimi për sigurimet shoqërore e A. B në shtetin gjerman.*

265. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti, konstaton se:

- *Në datën 19.8.2011, shtetasi A.B ka kryer një transfertë/tërheqje në shumën 12,000 euro nga llogaria e tij në “CommerzBank”.*
- *Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka lidhur kontratë në gjuhën gjermane në shumën 11,700 euro, në datën 22.9.2011.*
- *Bashkëshorti i subjektit ka tërhequr shumën 18,600 euro në datën 13.10.2011.*

- Subjekti ka deklaruar si burim këtë tërheqje si në deklaratën *Vetting*, ashtu edhe në deklaratën periodike vjetore.
- Z. B ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme në lidhje me shumën 12,000 euro, pasi ai, përveç të ardhurave të përfituara nga shitja e një pasurie të paluajtshme, ka pasur të ardhura edhe nga puna e tij në Gjermani.
- Në njoftimin e taksës motorike datë 18.10.2011, për automjetin e blerë nga bashkëshorti i subjektit, depozituar nga subjekti pas kalimit të barrës së provës, evidentohet se taksa e mjetit është 10 euro dhe do të kryhet me debitim direkt nga llogaria në “CommerzBank” e z. B.

Komisioni, duke marrë në konsideratë deklaratimet e subjektit në deklaratën *Vetting*, vlerëson se ajo ka bërë deklaram të pasaktë në lidhje me burimin e kësaj pasurie, duke deklaruar tërheqjen e shumës 18,600 euro, ndërkohë që nga dokumentacioni i depozituar nga ana e saj pas kalimit të barrës së provës rezulton se si burim mund të kenë shërbyer të ardhurat e z. B në Gjermani. Në lidhje me këtë pasaktësi të subjektit, për sa kohë ajo nuk shoqërohet me mungesë burimesh të ligjshme referuar edhe jurisprudencës së Kolegjit⁷¹, Komisioni vlerëson se ajo nuk mund të përbëjë shkak për marrjen e masës disiplinore ndaj subjektit të rivlerësimit.

Në lidhje me analizën financiare, për sa kohë nga subjekti është provuar që burimi ka qenë shuma 12,000 euro e z. B, rezulton se ajo ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për blerjen e këtij automjeti.

KONSTATIME TË TJERA

266. Lidhur me të ardhurat e përfituara ndër vite nga qiradhënia e objekteve të ndodhura në Rr e D, Tiranë

Nga hetimi ka rezultuar se nëna e bashkëshortit të subjektit, znj. G.S, e më tej bashkëshorti i subjektit, z. R.S, janë trashëgimtarë ligjorë të pasurive godinë 3-katëshe, e ndodhur në Rr e D, Tiranë dhe dy dyqanet që ndodhen në katin e parë të kësaj godine. Për këto pasuri janë lidhur në vijimësi kontrata qiraje, të ardhurat e të cilave janë përfitur nga bashkëpronarët S dhe A⁷².

267. Për të vërtetuar qiradhënien dhe të ardhurat e ligjshme të krijuara nga marrëdhënia e qirasë ndër vite, subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting*:

- kopje të kontratave të qirasë⁷³;

⁷¹ Vendim nr. 31/2020.

⁷² Informacioni i administruar gjatë hetimit për këto pasuri është trajtuar në pikën 246-256 të vendimit.

⁷³ Kontratë qiraje nr. ***, datë 4.2.1994; kontratë qiraje nr. ***, datë 28.2.1994; kontratë qiraje jonoteriale e padatuar e vitit 1997, nënshkruar për 9 qiradhënësit A nga M.P dhe qiramarrësit Q.Gj; kontratë qiraje jonoteriale e padatuar e vitit 1998, nënshkruar për 9 qiradhënësit A nga R.S dhe qiramarrësit P.H; kontratë qiraje nr. ***, datë 5.9.1998; kontratë qiraje nr. ***, datë 12.5.1999; kontratë qiraje e padatuar, lidhur mes qiradhënësve S.A dhe K.A dhe qiramarrësit “B” sh.p.k.; kontratë qiraje datë 28.2.2002; kontratë qiraje, datë 24.12.2002; kontratë qiraje, datë 23.1.2004; kontratë qiraje nr. ***, datë 24.5.2005; kontratë qiraje jonoteriale, datë 8.3.1999; kontratë qiraje jonoteriale e padatuar, lidhur mes qiradhënësve S dhe K.A; kontratë qiraje nr. ***, datë 4.4.2006; kontratë qiraje jonoteriale e padatuar, lidhur mes qiradhënësit A.A dhe qiramarrësit Sh.G; kontratë qiraje jonoteriale e padatuar, lidhur mes 15 qiradhënësve A dhe qiramarrësit Sh.G; kontratë qiraje jonoteriale e padatuar, lidhur mes 15 qiradhënësve A dhe qiramarrësit Sh.G; kontratë qiraje jonoteriale e padatuar, lidhur mes 15 qiradhënësve A dhe qiramarrësit E.D; kontratë qiraje nr. ***, datë 27.2.2014; kontratë qiraje jonoteriale, datë 1.11.2014; kontratë qiraje nr. ***, datë 18.11.2015; kontratë qiraje nr. ***, datë 4.4.2006; kontratë qiraje nr. ***, datë 4.4.2006; kontratë qiraje lidhur mes qiradhënësit E.A dhe qiramarrësit E (D) D; kontratë qiraje datë 1.3.2013, lidhur mes 14 qiradhënësve R.S etj dhe qiramarrësit A.K; kontratë qiraje datë 1.3.2014, lidhur mes 14 qiradhënësve R.S etj dhe

- kopje të pagesave të kryera ndër vite, për tatimin në burim të të ardhurave të përfituara nga qiradhënia e këtyre pasurive⁷⁴;
- kopje të transaksioneve të kryera në BKT nga subjektet qiramarrëse për pagesat e kryera prej tyre;
- shkresë nr. *** prot., datë 22.12.2016, e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve në lidhje me pagesat e tatimit në burim për kontratat e qirasë të lidhura nga bashkëpronarët e pasurive.

268. Nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni rezulton se znj. G.S dhe/ose z. R.S, në cilësinë e qiradhënësve, kanë nënshkruar kontrata qiraje nga viti 1994 e në vijim për pasurinë “godinë trekatëshe” ndodhur në Rr e D dhe për dy dyqanet e ndodhura në katin e parë të kësaj godine.

269. Të ardhurat e përfituara nga qiradhënia pas tatimit për periudhën 1994 – 2017 janë në vlerën totale 13,119,644.39 lekë.

270. Nga dokumentacioni i administruar gjatë hetimit ka rezultuar se të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit nga kontratat e qirave klasifikohen si të ardhura të

qiramarrësit A.K; kontratë qiraje datë 1.3.2015, lidhur mes 14 qiradhënësve R.S etj. dhe qiramarrësit A.K; kontratë qiraje nr. ***, datë 7.6.2017.

⁷⁴ MA ***, datë 16.1.1995; MA ***, datë 26.7.1995; MA ***, datë 8.9.1995; MA ***, datë 12.10.1995; MA ***, datë 3.11.1995; MA ***, datë 7.12.1995; MA ***, datë 16.1.1996; MA ***, datë 5.3.1996; MA ***, datë 5.3.1996; MA ***, datë 16.1.1996; MA ***, datë 2.2.1996; MA ***, datë 5.2.1996; MA ***, datë 6.3.1996; MA ***, datë 5.3.1996; MA ***, datë 2.4.1996; MA ***, datë 9.7.1996; MA ***, datë 7.5.1996; MA ***, datë 2.5.1996; MA ***, datë 5.6.1996; MA **... datë 2.7.1996; MA ***, datë 15.8.1996; MA ***, datë 19.8.1996; MA ***, datë 3.9.1996; MA ***, datë 8.10.1996; MA... datë 25.11.1996; MA ***, datë 1.10.1996; MA ***, datë 13.6.1996; MA ***, datë 7.11.1996; MA ***, datë 9.12.1996; MA ***, datë 2.12.1996; MA ***, datë 5.2.1997; MA ***, datë 16.1.1997; MA ***, datë 13.1.1997; MA ***, datë 3.2.1997; MA ***, datë 5.2.1997; MA ***, datë 7.3.1997; MA ***, datë 4.3.1997; MA ***, datë 21.4.1997; MA ***, datë 2.4.1997; MA ***, datë 9.5.1997; MA ***, datë 6.5.1997; MA ***, datë 9.6.1997; MA ***, datë 2.6.1997; MA ***, datë 7.7.1997; MA ***, datë 10.7.1997; MA ***, datë 11.8.1997; MA ***, datë 5.8.1997; MA ***, datë 12.9.1997; MA ***, datë 1.9.1997; MA ***, datë 9.10.1997; MA ***, datë 6.11.1997; MA ***, datë 12.12.1997; MA ***, datë 3.3.1998; MA ***, datë 15.1.1998; MA ***, datë 10.4.1998; MA ***, datë 8.5.1998; MA ***, datë 9.6.1998; MA ***, datë 10.7.1998; MA ***, datë 12.8.1998; MA ***, datë 9.9.1998; MA ***, datë 9.10.1998; MA ***, datë 9.11.1998; MA ***, datë 14.12.1998; MA ***, datë 18.11.1998; MA ***, datë 23.4.1998; MA ***, datë 23.4.1998; MA ***, datë 13.7.1998; MA ***, datë 8.9.1998; MA ***, datë 8.9.1998; MA ***, datë 13.7.1998; MA ***, datë 7.1.1999; MA ***, datë 2.3.1999; MA ***, datë 9.2.1999; MA ***, datë 16.3.1999; MA ***, datë 14.6.1999; MA ***, datë 18.10.1999; MA ***, datë 1.11.1999; MA ***, datë 15.12.1999; MA ***, datë 9.11.1999; MA ***, datë 9.9.1999; MA ***, datë 30.3.1999; MA ***, datë 10.5.1999; MA ***, datë 16.7.1999; MA ***, datë 22.12.2000; MA ***, datë 15.1.2000; MA ***, datë 22.2.2000; MA ***, datë 13.4.2000; MA ***, datë 9.3.2000; MA ***, datë 13.7.2000; MA ***, datë 14.11.2000; MA ***, datë 18.9.2000; MA ***, datë 13.1.2000; MA ***, datë 15.9.2000; MA ***, datë 12.7.2000; MA ***, datë 8.11.2000; MA ***, datë 11.1.2000; MA ***, datë 30.3.2000; MA ***, datë 22.3.2000; MA ***, datë 10.1.2001; MA ***, datë 26.3.2001; MA ***, datë 13.12.2001; MA ***, datë 17.12.2001; MA ***, datë 30.5.2001; MA ***, datë 10.10.2001; MA ***, datë 21.1.2001; MA ***, datë 28.5.2001; MA ***, datë 11.9.2001; MA ***, datë 28.5.2001; MA ***, datë 13.3.2001; MA ***, datë 28.5.2001; MA ***, datë 11.9.2001; MA xxx datë 21.1.2002; MA xxx datë 23.9.2002; MA xxx datë 20.12.2002; MA ***, datë 27.3.2003; MA ***, datë 30.12.2003; MA ***, datë 6.10.2004; MA ***, datë 16.2.2004; MA ***, datë 16.3.2004; MA ***, datë 16.3.2004; MA xxx datë 2.3.2004; MA ***, datë 16.2.2004; MA ***, datë 2.4.2004; MA ***, datë 24.2.2004; MA ***, datë 3.4.2004; MA ***, datë 17.3.2004; MA xxx datë 17. 3.2004; MA ***, datë 5.4.2004; MA ***, datë 16.3.2004; MA ***, datë 16.3.2004; MA ***, datë 23.3.2004; MA ***, datë 28.5.2004; MA ***, datë 15.3.2004; MA ***, datë 10.3.2004; MA ***, datë 1.4.2004; MA ***, datë 13.3.2004; MA xxx datë 2.3.2004; MA ***, datë 20.3.2004; MA ***, datë 22.6.2005; MA ***, datë 29.4.2005; MA ***, datë 16.3.2006; MA ***, datë 17.4.2006; MA ***, datë 26.8.2006; MA ***, datë 3.11.2006; MA ***, datë 17.4.2006; MA ***, datë 26.8.2006; MA ***, datë 3.11.2006; MA ***, datë 17.11.2007; MA ***, datë 3.1.2008; MA ***, datë 17.11.2007; MA ***, datë 3.1.2008; MA ***, datë 7.3.2008; MA ***, datë 3.6.2008; MA xxx datë 16.5.2009; MA ***, data e palexueshme; MA xxx datë 17.12.2009.

ligjshme, për të cilat janë paguar detyrimet tatimore e, për pasojë, ato janë përfshirë në analizën financiare të subjektit.

Konstatim në lidhje me deklarimin e gjendjes *cash* në deklarimet vjetore

271. Komisioni ka konstatuar se subjekti nuk rezulton të ketë deklaruar kursime *cash* në deklaratat periodike ndër vite. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka ndryshuar deklarimet e saj, duke deklaruar si burim kursime të cilat nuk rezultonin të deklaruara në deklaratat periodike.

272. Në vijim të këtyre deklarimeve, subjekti në pyetësin standard ka deklaruar se: *“Në këtë pyetësor do të doja të sqaroja dhe pasaktësitë në deklarimin e gjendjeve cash në fund të çdo viti, duke qenë se kam qenë e paqartë për deklarimin e tyre. Unë nuk kam deklaruar në deklarata periodike vjetore gjendje cash, por duke u munduar për të qenë sa më e saktë në deklarimet e mia, kam sqaruar me detaje çdo transaksion të kryer, duke nënkuptuar gjendjet cash që kanë qenë në fund të çdo viti. Më poshtë jam munduar të paraqes në mënyrë sa më të saktë, nisur nga deklarimet periodike vjetore, gjendjet cash në fund të çdo viti. Megjithëse gjendjet cash mund të kenë qenë pak më të mëdha, unë do t’ju lutesha të merrnit në konsideratë ato shuma të cilat i kam deklaruar (jo ne rubrikën e likuiditeteve, por si transaksione të kryera) në DPV dhe në deklaratën e rivlerësimit”.*

Në mbështetje të këtij deklarimi, subjekti ka deklaruar shumat përkatëse të kursimeve *cash* për periudhën 2004 – 2013.

273. Në lidhje me këtë deklarim të subjektit, Komisioni, pasi e krahasoi me shpjegimet e saj në deklaratën *Vetting* dhe në deklarimet periodike të saj, konstaton se ai nuk përputhet dhe është kontradiktor, pasi në disa raste që janë trajtuar më lart: (i) subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e kursimeve të pretenduara; (ii) deklarimet e subjektit nuk përputhen me deklarimet e saj në ILDKPKI për sa i përket gjendjes *cash*; (iii) deklarimet e subjektit nuk përputhen me deklarimet e saj në deklaratën *Vetting* dhe në deklaratat periodike.

Për sa më sipër, Komisioni vlerëson të mos përfshijë në analizë financiare gjendjen *cash* të subjektit.

274. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti pretendoi se përgjatë hetimit administrativ, që në pyetësin standard, ka sqaruar me sinqeritet se ka pasur një pasaktësi në deklarimin e gjendjeve *cash* në fund të çdo viti, duke qenë se ka qenë e paqartë për deklarimin e tyre. Ajo nuk ka deklaruar në deklarata periodike vjetore gjendje *cash*, por duke u munduar të jetë sa më e saktë në deklarimet e saj, ka sqaruar me detaje çdo transaksion të kryer, duke nënkuptuar gjendjet *cash* që kanë qenë në fund të çdo viti: *“Megjithëse gjendjet cash mund të kenë qenë pak më të mëdha, unë do t’ju lutesha të merrnit në konsideratë ato shuma të cilat i kam deklaruar saktësisht në deklaratat periodike vjetore dhe në deklaratën e rivlerësimit”.*

Pretendimi i Komisionit se në procesverbalin e ILDKPKI-së nuk e ka deklaruar gjendjen *cash* që ka ardhur nga qiratë e godinave apo pasurive të bashkëshortit, ajo ka sqaruar qartë se ka menduar gjithmonë që deklarimi i të ardhurave të qirasë në rubrikën e të ardhurave kanë qenë të mjaftueshme për të deklaruar ekzistencën e saj. Këto të ardhura asnjëherë nuk i kanë shpenzuar, pasi nuk kanë pasur nevojë që t’i shpenzojnë, por gjithmonë i kanë futur në llogari rrjedhëse apo depozitë, sa herë prej bashkëshortit të saj konsideroheshin të arsyeshme, por gjithmonë brenda një harku kohor jo më të gjatë se 2 vjet. Këto të ardhura kanë ekzistuar nga

momenti i krijimit të tyre sipas kontratave përkatëse dhe kanë shërbyer vetëm për krijimin e depozitave bankare, sikundër edhe Komisioni ka analizuar në rezultatet e hetimit administrativ.

275. Në lidhje me këto pretendime të subjektit, Komisioni është shprehur më lart në pjesë të veçanta të vendimit, duke pranuar pjesërisht kursimet *cash* të subjektit të rivlerësimit, në ato vite kur ky deklaram i saj është në harmoni me deklaramin në deklaratat periodike, si dhe me mjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme për krijimin e këtyre kursimeve *cash*.

276. Në përfundim të analizës financiare prej fillimit të detyrës deri në deklaratën *Vetting*, rezulton se nëse analiza financiare do të bazohej pa përfshirë kursimet *cash*, subjekti dhe personat e lidhur me të kanë një pamundësi financiare në -14,958,089.60 lekë⁷⁵.

277. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti ka paraqitur një sërë pretendimesh, ku disa prej tyre janë trajtuar në pika të veçanta të këtij vendimi. Komisioni, për të mos rënë në përsëritje, do të analizojë vetëm ato pretendime të cilat nuk gjejnë trajtim më lart.

Më konkretisht, subjekti ka pretenduar:

- i. Në llogarinë e shtetasve R.S dhe G.S pranë Bankës së Kursimeve (sot “Raiffeisen Bank”), në datën 31.3.2003 gjendja e likuiditeteve ka qenë 1,291,032 lekë dhe 199,092 lekë, ndërsa Komisioni ka përfshirë në analizë vetëm shumën 1,291,032 lekë, pasi “Raiffeisen Bank” nuk ka dokumente për periudhën para vitit 2004.

Në lidhje me këtë pretendim të subjektit, Komisioni vlerëson të mos përfshijë depozitën prej 199,092 lekësh në likuiditetet e vitit 2003, për sa kohë subjekti nuk ka mundur të provojë këtë fakt me dokumentacion provues.

- ii. Në llogarinë e saj pranë “Raiffeisen Bank”, në datën 10.11.2005 është tërhequr shuma 528,571 lekë. Sipas llogarive të Komisionit, kjo shumë është lënë gjendje në datën 31.12.2005.

Në lidhje me këtë pretendim, Komisioni vlerëson se subjekti ka mundur të provojë këtë fakt me dokumentacion provues dhe ka kryer sistemimet në pasqyrën e likuiditeteve. Për më tepër, në deklaratën periodike të vitit 2005 subjekti ka deklaruar qartësisht se në fund të vitit 2005 ka tërhequr nga Banka e Kursimeve shumën 520,000 lekë dhe e ka depozituar në datën 13.1.2006 në Bankën Popullore në shumën 600,000 lekë.

- iii. Gjendja e llogarive pranë OTP Bank në vitet 2009 dhe 2010 ka qenë 30,000 euro në datën 31.12.2009 dhe 31,124 euro në datën 31.12.2010. Në analizën e Komisionit këto shuma janë hedhur njësoj, por në ekuivalentimin e tyre në lekë është përdorur gabimisht kursi i dollarit.

Vlerësohet i drejtë konstatimi i subjektit mbi gabimin material në likuiditete, të ndodhur nga përdorimi gabimisht i kursit në dollar në llogarinë e subjektit pranë OTP Bank në vitet 2009 dhe 2010 dhe ka kryer sistemimet në pasqyrën e likuiditeteve.

- iv. Në vitin 2016, totali i likuiditeteve në bono thesari ka qenë 7,081,711 lekë, ndërkohë nga Komisioni është llogaritur 1,790,000 lekë.

⁷⁵ Për më shumë detaje referohuni në pikën 154 të rezultateve të hetimit.

Në lidhje me këtë pretendim të subjektit, Komisioni vlerëson se në vitin 2016 në pasqyrën e likuiditeteve është pasqyruar në bono thesari shuma 5,291,711.57 lekë, si dhe në bono thesari shuma 1,790,000 lekë, që në total përbën shumën 7,081,711 lekë të pretenduar nga subjekti.

- v. Të ardhurat nga qiratë për pjesën e godinës në vitin 2014 nga Komisioni janë llogaritur 4,599 USD - 10% = 470,419 lekë. Më 30.6.2014 është mbyllur kontrata në USD dhe është nënshkruar kontratë e re për periudhën 1.7.2014 – 30.6.2015 në shumën *neto* 4,995 euro. Për vitin 2014 të ardhurat *neto* nga qiraja për pjesën e godinës kanë qenë 2,430 USD + 2,497 euro = 626,000 lekë.

Vlerësohet i drejtë konstatimi i subjektit mbi gabimin material dhe janë kryer sistemimet në të ardhurat nga qiratë për vitin 2014.

278. Komisioni, në përfundim ka kryer një analizë të re financiare sipas argumentimit të mësipërm, duke përfshirë në këtë analizë pjesërisht kursimet *cash* të subjektit, si dhe disa prej pretendimeve të tjera të saj, për të cilat depozitoi dokumentacion provues.

Komisioni vendosi të përfshijë në analizën e re financiare:

1. Shumën 351,706 lekë të deklaruar nga subjekti si e ardhur e përfituar si dhuratë nga motra e saj L.B.
2. Shumën 15,300 USD si kursim *cash* në vitin 2013, i krijuar nga të ardhurat e përfituara nga kontratat e qirave të pasurive të paluajtshme në bashkëpronësi të bashkëshortit dhe familjarëve të tij, të përfituara në vitet 2011, 2012 dhe 2013.
3. Të ardhurat e përfituara si dëmshpërblim nga babai i subjektit për nënën e tij, znj. F.B, në vlerën 698,271 lekë. Ndërkohë, për të ardhurat e shtetasve N.B, ato nuk do të përfshihen në analizë financiare, pavarësisht deklarimeve të subjektit, pasi nga ana e saj nuk është depozituar asnjë dokumentacion provues.
4. Shumën 50,000 euro si kursim *cash* të subjektit në vitin 2013, për sa kohë kemi të bëjmë me një pasaktësi në deklaram, e cila nuk shoqërohet me mungesë burimesh të ligjshme për krijimin e saj, pasi kjo shumë është krijuar nga shitja e pasurisë së paluajtshme apartament sipas kontratës së datës 20.8.2013 në shumën 53,000 euro.
5. Pakësimin e likuiditeteve në shumën 279,900 lekë, si rrjedhojë e gabimit material ndodhur nga impakti i llogaritjes me kursin e këmbimit, duke e konsideruar depozitën 30,000 USD dhe jo 30,000 euro.
6. Shpenzimet e jetesës që nga periudha maj 2008 – 2016 (kohë kur ka ndërruar jetë nëna e bashkëshortit të subjektit) janë llogaritur për 2 persona.
7. Shumën prej 1,500,000 lekësh si kursim *cash* në vitin 2011, pasi rezulton se: (i) subjekti dhe bashkëshorti i saj kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e kursimeve *cash* në vitin 2011; (ii) bashkëshorti i subjektit ka deklaruar saktësisht përdorimin e shumës 1,500,000 lekë në DPV/2011, ku deklaroi se: “Në dhjetor 2011 në bankën ‘Societe Generale Albania’ kam mbyllur llogarinë dhe tërhequr shumën 1,254,879 lekë, në nëntor 2011 kam rifutur bono thesari shumën 4,000,000 lekë, nga e cila kam tërhequr në nëntor 2011 shumën 275,928 lekë. Në janar 2012, të dyja këto shuma i kam futur në bono thesari. Pra, shuma 1,500,000 lekë ka qenë gjendje *cash* në shtëpi, në 31.12.2011”.
8. Shumën 1,291,032 lekë, e cila rezulton e pasqyruar në llogarinë e shtetasve R.S dhe G.S pranë Bankës së Kursimeve (sot “Raiffeisen Bank”) në datën 31.3.2003. Komisioni

vlerëson të mos përfshijë depozitën prej 199,092 lekësh në likuiditetet e vitit 2003, për sa kohë subjekti nuk ka mundur të provojë këtë fakt me dokumentacion provues.

9. Për vitin 2014 janë përfshirë në analizë të ardhurat nga qiraja për pjesën e godinës në vlerën 2,430 USD, si dhe 2,497 euro, në total 625,999.87 lekë.

279. Nga analiza financiare e kryer për të gjithë periudhën nga fillimi i detyrës deri në plotësimin e deklaratës *Vetting*, subjekti rezulton me rezultat negativ në vlerën 1,595,844.22 lekë.

Konkluzioni i Komisionit mbi vlerësimin e pasurisë

280. Siç u evidentua edhe më sipër, Komisioni analizoi, vlerësoi dhe mori në konsideratë qëndrimin e subjektit në harmoni me provat e administruara në dosje, duke pranuar dhe reflektuar të gjitha efektet e shpjegimeve bindëse dhe të bazuara në dokumentacion justifikues ligjor në rezultatet financiare të viteve respektive.

281. Në lidhje me problematikat e konstatuara në vlerësimin e kriterit të pasurisë, trupi gjykues çmon se balanca negative e fondeve prej -1,595,844.22 lekësh për gjithë periudhën e kontrolluar vjen për shkak të pasaktësisë në deklaratimet periodike vjetore, të cilat, të analizuar një nga një, vlerësohen nga trupi gjykues si pasaktësi, të cilat nuk janë kryer për ndonjë shkak të caktuar apo të kenë pasur qëllim akumulim të shumave monetare për krijimin e pasurive, e sidomos të shoqëruara me faktin provues të ekzistencës së burimeve financiare që kënaqin kërkesat e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, krijuan bindjen e plotë se ato janë pasaktësi që mbeten të veçuara e që nuk mund e nuk duhet të shoqërohen me aplikim penalizues për subjektin e rivlerësimit. Nga një analizë e përgjithshme rezulton se në tërësinë e tyre mjetet monetare të disponuara nga subjekti rivlerësimit dhe personi i lidhur, ndër vite, janë në një vlerë më të madhe se pasuritë e krijuara si likuiditete në bankë nga ata. Në këtë vlerësim të përgjithshëm, trupi gjykues ka mbajtur në konsideratë edhe faktin se subjekti rivlerësimit dhe personi lidhur me të nuk kanë krijuar pasuri të paluajtshme apo shpenzime, të cilat nuk kanë mundur t'i përballojnë dot. Ata rezultojnë se bëjnë një jetë modeste dhe se nuk ndodhen përpara ndonjërit prej shkaqeve të parashikuara në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, ku të ngriheshin dyshime të arsyeshme se pasaktësia në deklaratim ka qenë e qëllimshme.

Komisioni gjatë hetimit administrativ konstatoi se në asnjë rast pasaktësitë e konstatuara nuk kanë ndikuar në cenimin e burimit të krijimit të pasurive të subjektit të rivlerësimit.

282. Nga analiza financiare e kryer në Komision rezulton se subjekti ka pasur burime të ligjshme të të ardhurave, si dhe tepriçë të mjeteve monetare, që mundësonin kursime të konsiderueshme ndër vite.

283. Bazuar në konkluzionet më lart për të gjitha pasuritë e deklaruara të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur, trupi gjykues i Komisionit, në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë, krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit Fahrije Stringa (Budo) ka një nivel të besueshëm për kriterin e pasurisë, pasi nga një vlerësim proporcional dhe objektiv nuk u vërejtën shkaqe të tilla që të përmbushnin qëllimin e aplikimit të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra për efekt të procesit të rivlerësimit kalimtar të subjekteve. Në këtë vlerësim, trupi gjykues u bazua në bindjen e brendshme, pas vlerësimit objektiv të të gjitha pasurive dhe mjeteve monetare të krijuara nga subjekti i rivlerësimit në harkun kohor prej 23 vitesh në funksionin e gjyqtarës, ekzistencën e mjeteve financiare në dispozicion, të cilat përmbushin

plotësisht kërkesat e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe rrethanave specifike të rezultuara nga hetimi administrativ për subjektin Fahrije Stringa (Budo).

Trupi gjykues çmon se nuk është cenuar figura e gjyqtarit dhe as besimi i publikut te drejtësia.

284. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht, si dhe ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht në deklaratën *Vetting* pasuritë e tij dhe të personave të lidhur me të, ashtu siç parashikohet në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

285. Subjekti ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij. Nga hetimi ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk është përpjekur të fshehë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, zotërim ose në përdorim të tij. Kjo do të thotë që në rastin e subjektit të rivlerësimit Fahrije Stringa (Budo) nuk vërtetohen shkaqet që Kushtetuta i ka parashikuar të tilla që, nëse vërtetohen, do të zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

286. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Fahrije Stringa (Budo) ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

287. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Fahrije Stringa (Budo), me anë të verifikimit të deklaramëve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016.

288. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar në Komision raportin⁷⁶ mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Fahrije Stringa (Budo), ku ka konstatuar se: (i) formulari i deklaramit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) subjekti ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës; si dhe (iii) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të kimit të organizuar.

289. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit.

290. Komisioni kreu një hetim⁷⁷ të pavarur për kontrollin e figurës dhe integritetit të subjektit të rivlerësimit Fahrije Stringa (Budo). Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e saj në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Konkluzion i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës

⁷⁶ Raporti me nr. *** prot., datë 27.10.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZH-së nr.**, datë 6.1.2021.

⁷⁷ Shihni dosjen me informacion të klasifikuar të subjektit të rivlerësimit.

291. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Fahrije Stringa (Budo) ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

292. Vlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni është bazuar në:

- raportin për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit të kryer nga KLGJ-ja;
- kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
- denoncimet e paraqitura pranë Komisionit.

Raporti i hartuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor

293. Ky raport është përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

294. Hartimi i këtij raporti është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit; (ii) pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; dhe (iii) të dhënave nga burimet arkivore të KLGJ-së.

295. Raporti ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit: (a) aftësitë profesionale; (b) aftësitë organizative; (c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; si dhe (ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

296. Nga verifikimi i tri dokumenteve ligjore të depozituara nga subjekti nuk u konstatuan problematika.

297. Nga analizimi i pesë dosjeve të përzgjedhura me short subjektit iu kërkuan shpjegime për dosjet nr. 2, 3 dhe 5.

Dosja 2 – çështja civile nr. *** regjistri themeltar, datë 6.10.2015 regjistrimi, që i përket paditëses K.J, i paditur I.J me objekt “zgjidhje martesë etj.”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 20.6.2016.

1. Çështja u regjistrua në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 6.10.2015 dhe, sipas siglimit të kryetarit të gjykatës, datë 7.10.2015, i është caktuar subjektit të rivlerësimit. Për këtë gjykim janë zhvilluar 7 seanca përgatitore dhe 2 seanca gjyqësore. Në seancën e datës 20.6.2016, subjekti ka vendosur pranimin e padisë për zgjidhjen e martesës.

Nga aktet e paraqitura nuk evidentohet që ndaj këtij vendimi të jetë paraqitur ankim.

Bazuar në numërorin e vendimeve civile, dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor janë dorëzuar në kryesekretari në datën 1.7.2016, 11 ditë nga shpallja, jashtë afatit 10-ditor të parashikuar nga neni 308, paragrafi 2 i Kodit të Procedurës Civile.

Gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit ka zgjatur gjithsej 8 muaj e 13 ditë, në intervalin kohor 7.10.2015 – 20.6.2016.

2. Kohëzgjatja e gjykimit është jashtë afatit standard 4-mujor të përcaktuar nga pika 5, germa “d” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit.

Në lidhje me këtë vonesë, subjekti pretendoi se: *“Përveç arsyes objektive të mungesës sime në seancën e datës 25.11.2015 për arsye shëndetësore apo të mungesës së paditëses në seancën e datës 25.1.2016 për arsye objektive shëndetësore, është procedura e posaçme e gjyqësorëve të çështjeve familjare me objekt zgjidhje martesë, bazuar në parashikimet e Kodit të Familjes, procedurë e cila prevalon mbi afatet e parashikuara në Aneksin 1 të Sistemit të Vlerësimit, si më poshtë:*

Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë ka të parashikuar shprehimisht detyrat e gjykatës në rastet e zgjidhjes së martesës, nga e cila ka edhe fëmijë të mitur. Së pari, është i parashikuar shprehimisht zhvillimi i seancës së pajtimit. Ligjvënësi konsideron interesin më të lartë familjen e bashkuar, ndaj është detyrim i gjykatës të bëjë përpjekjet për pajtim, në referim të neneve 134 e 135 të Kodit të Familjes, si në rastin kur janë prezent të dy bashkëshortët, edhe në rastin kur nuk paraqitet bashkëshorti i paditur në gjykim. I padituri në këtë gjykim nuk u paraqit në asnjë seancë gjykimi - pajtimi (përgatitore) apo gjyqësore. Në seancat përgatitore të zhvilluara në datën 25.11.2015 u konfirmua se nuk ka marrë dëgjimin, pasi fletëthirrja ishte nënshkruar nga paditësjja, ndërkohë që në seancën e datës 24.2.2016 mori dëgjimin në adresën e prindërve të tij në Has (e para seancë që mori dëgjimin), por në kushtet e nenit 135 të Kodit të Familjes është detyrim ligjor përsëritja e njoftimit për të. Me përsëritjen e njoftimit, i padituri nuk ka marrë dëgjimin më as në seancën e datës 23.3.2016 dhe as në seancën e datës 25.4.2016 (pasi ishte larguar nga adresa e vetme që mundëm të kishim për të) e, në këto kushte, gjykata ka vendosur që i padituri të njoftohet me shpallje konform nenit 133 të Kodit të Procedurës Civile. Në vijim janë zhvilluar 3 seanca, njëra është seanca përgatitore e pajtimit datë 25.5.2016, ku është vendosur edhe kalimi i çështjes në seancë gjyqësore drejtpërdrejt në të njëjtën ditë 25.5.2016 (ku, pasi janë dhënë shpjegimet, është vendosur caktimi i një eksperti psikolog, i cili është paraqitur, ka bërë betimin dhe ka marrë detyrat, bazuar në nenet 6 e 155 të Kodit të Familjes dhe 224/a e 226 të Kodit të Procedurës Civile) dhe tjetra është seanca gjyqësore e datës 20.6.2016, ku pasi kam dëgjuar vlerësimin dhe rekomandimin e ekspertës së fushës përmes raportit të vlerësimit psikologjik, në lidhje me lënien e dy fëmijëve të mitur për rritje dhe edukim, kam dëgjuar edhe vetë fëmijët në prezencë të ekspertës psikologe, në referim të neneve 267 e 273 të Kodit të Familjes”.

Shpjegimet e subjektit në lidhje me këtë çështje janë bindëse. Nga ana e saj është shpjeguar dhe është provuar se vonesat në gjykim kanë ardhur si pasojë e mungesës së njoftimit të palës së paditur dhe jo për faj të subjektit, gjë që më pas ka sjellë si pasojë dhe kryerjen e njoftimit me shpallje. Pas përfundimit të kësaj procedure, subjekti e ka gjykuar çështjen brenda një afati të shkurtër kohor, ku me qëllim moszvarritjen e procesit ka kryer seancën përgatitore dhe një seancë gjyqësore në të njëjtën datë.

3. Në seancat gjyqësore është shënuar ora e hapjes dhe e mbylljes së seancës dhe evidentohet se orari i seancave gjyqësore është respektuar. Nga dokumentacioni në dosjen e vëzhguar nuk konstatohen të meta.

Seancat gjyqësore nuk evidentohet nëse janë zhvilluar në sallë gjykimi apo zyrë dhe nuk janë dokumentuar me regjistrim audio.

Në lidhje me këtë konstatim, subjekti shpjegoi se: *“Në këtë çështje seancat e pajtimit apo përgatitore janë zhvilluar në zyrë, si për shkak të numrit të madh të gjyqtarëve pranë Gjykatës së Tiranës në këtë periudhë, por edhe për shkak të ngarkesës emocionale që mbartin seancat e pajtimit. Edhe seanca gjyqësore e datës 20.6.2016 është zhvilluar në zyrë për shkak të faktit që sallat me audio shfrytëzoheshin nëpërmjet një programimi me grafik, sipas urdhërimeve të kryetarit të gjykatës, ku përcaktohej mënyra e shfrytëzimit të sallave të gjyqit. Aktualisht, për shkak të pakësimit të numrit të gjyqtarëve prej tri vitesh kam gjykuar vetëm në sallë dhe në regjistrim audio”.*

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato janë bindëse, duke marrë në konsideratë numrin e gjyqtarëve në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Dosja 3 – çështja civile nr. *** regjistri themeltar, datë regjistrimi 2.12.2013, që i përket paditës shoqërisë “A.A” sh.p.k., i paditur OSHEE, me objekt “anulimi pjesërisht i faturës datë 11.7.2011, për sa i përket muajit qershor 2011, si dhe zbritja e vlerës së muajit qershor prej 1,054,471 lekësh nga vlera totale e faturës prej 2,386,059 lekësh”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 24.6.2014.

1. Çështja është regjistruar në gjykatë, në datën 2.12.2013, dhe i është caktuar subjektit në datën 3.12.2013.

Në seancën e datës 13.10.2014, subjekti i rivlerësimit ka vendosur pranimin e padisë. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 17.11.2015, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 13.10.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ndaj vendimit është paraqitur rekurs dhe, sipas printimit të datës 18.10.2021 nga faqja zyrtare e Gjykatës së Lartë, çështja është ende në pritje për t’u gjykuar.

2. Vendimi është arsyetuar dhe dorëzuar në kryesekretari nga subjekti i rivlerësimit në datën 28.10.2014 - pas 15 ditëve nga shpallja, jashtë afatit 10-ditor të përcaktuar nga neni 308, paragrafi 2 i Kodit të Procedurës Civile dhe atij 5-ditor.
3. Gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit ka zgjatur gjithsej 10 muaj e 10 ditë, në intervalin kohor 3.12.2013 – 13.10.2014. Kohëzgjatja e gjykimit është jashtë afatit standard 6-mujor të përcaktuar nga pika 5, germa “e” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit.

Subjekti, në lidhje me këto konstatime, shpjegoi se: *“Në këtë çështje arsyetimi dhe dorëzimi i dosjes me vonesë ka ardhur si pasojë e ngarkesës me dosje që kam pasur unë dhe vetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë prej disa vitesh.*

Vlen të theksohet se disa seanca janë shtyrë për shkak të palës së paditur OSHEE (ish-CEZ Shpërndarje sh.a.), e cila fillimisht ishte në mungesë. Nga pala paditëse u kërkua pakësim i objektit të padisë në datën 31.1.2014, bazuar në nenin 185 të Kodit të Procedurës Civile, për të cilën është detyrim i Gjykatës të shtyjë seancën për të njoftuar palën e paditur në mungesë për këtë pakësim objekti. Pala e paditur, edhe pasi është paraqitur në seancë në datën 3 mars 2014, ka pretenduar (përfaqësuesja e CEZ Shpërndarje sh.a.) se nuk është njohur me aktet e dosjes, në vijim në seancën e radhës nga ana e tyre është kërkuar shtyrje e seancës, e cila është pranuar nga pala paditëse dhe nga gjykata. Ndërsa në vijim pala e paditur ka pretenduar se

fatura e pretenduar nga pala paditëse për t'u anuluar është anuluar prej tyre, por ende nuk e kanë nxjerrë si akt, nuk është konkretizuar me një dokument, por i rëndësishëm ishte fakti që nga përfaqësuesi i të paditurit u pretendua se kjo shkresë që pritet të dalë prej tyre sjell një situatë të re për palën paditëse. Ndaj gjykata, duke vlerësuar se kjo mund të passillte si pasojë zgjidhjen me pajtim të çështjes mes palëve... Dy seanca janë shtyrë për mungesën time për shkaqe shëndetësore familjare dhe leje të KLD-së (arsye e rëndë shëndetësore e motrës sime L.B, e cila ra në gjendje kome në datën 3 prill 2014, si pjesë e terapisë për ta zgjuar ishte e domosdoshme prezenca e familjarëve të saj).

Për sa më lart, duke i zbritur arsyet objektive si për shkak të lejes 2-mujore të miratuar nga KLD-ja për mua si gjyqtare e çështjes dhe 2 seanca të tjera që janë shtyrë nga vetë palët për pakësim të objektit të padisë e për t'i dhënë mundësinë për zgjidhje me pajtim, rezulton se çështja është gjykuar brenda afatit ligjor.

- *Depozitohet një fotokopje të akteve të gjykatës të kësaj dosjeje me nr. *** vendimi, datë 13.10.2014, dosja është në Gjykatën e Lartë, ende e pashqyrtuar.*
- *Në lidhje me provat po ju vë në dispozicion dokumentacionin, lejet e dhëna nga KLD-ja, si dhe konfirmimet nga IRCCS M për gjendjen shëndetësore të motrës sime të ndjerë L. B”.*

Bashkëlidhur prapësimeve të saj, subjekti ka paraqitur aktet e dosjes gjyqësore, ku evidentohen procesverbalet e seancave gjyqësore, fletëthirrjet e dërguara palëve ndërgjyqëse, leje për shkëputje të përkohshme nga puna (periudhë 2-mujore), të akorduara nga KLD-ja.

Nga dokumentacioni i administruar rezulton se vonesa e krijuar në shqyrtimin e çështjes gjyqësore ka ardhur si pasojë e shkëputjes 2-mujore të subjektit për arsye objektive mbi bazën e lejes së dhënë nga KLD-ja, si dhe për shkak të shtyrjes së seancave gjyqësore me qëllim njoftimin e palës së paditur. Për pasojë, shpjegimet e saj në lidhje me konstatimin e Komisionit janë bindëse.

4. Seancat gjyqësore nuk evidentohet nëse janë zhvilluar në sallë gjykimi apo zyrë dhe nuk janë regjistruar me audio, me përjashtim të seancave 11 e 12, të cilat janë zhvilluar në sallë gjykimi dhe mbajtur me regjistrim audio.

Subjekti në lidhje me këtë konstatim shpjegoi: *“Në këtë çështje disa seanca janë zhvilluar në zyrë, ndërsa dy seanca janë zhvilluar në audio. Pamundësia e të gjithë gjyqtarëve që të përdorim sallat të cilat e kanë sistemin audio, ndërsa zyrat e gjyqtarëve nuk e kanë regjistrimin e seancës në audio, si dhe për shkak të numrit të madh të gjyqtarëve pranë Gjykatës së Tiranës në këtë periudhë, të faktit që sallat me audio shfrytëzoheshin nëpërmjet një programimi me grafik, sipas urdhërimeve të kryetarit të gjykatës, ku përcaktohej mënyra e shfrytëzimit të sallave të gjyqit.*

Aktualisht, për shkak të pakësimit të numrit të gjyqtarëve prej tri vitesh, kam gjykuar vetëm në sallë dhe në regjistrim audio”.

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato janë bindëse, duke marrë në konsideratë numrin e gjyqtarëve në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Dosja 5 – çështja penale (masë sigurimi) nr. ***, datë 20.12.2013, që i përket Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt “vleftësim arresti në flagrancë dhe caktim mase

sigurimi ndaj të dyshuarit S.N për veprën penale të drejtimit të automjeteve në mënyrë të parregullt, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal”, e përfunduar me vendimin nr. *** akti, datë 21.12.2013. Çështja është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në datën 20.12.2013 dhe i është caktuar subjektit të rivlerësimit.

1. Në seancën e vetme gjyqësore të datës 21.12.2013, subjekti i rivlerësimit vendosi vleftësimin e ligjshëm të arrestimit në flagrancë dhe caktimin si masë sigurimi “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore një herë në dy javë, të enjten e parë e të tretë të çdo muaji, ora 14:00”. Ndaj vendimit nuk rezulton të jetë paraqitur ankim.
2. Nga fleta e librit të dorëzimit të dosjes në sekretarinë e gjykatës rezulton se dosja gjyqësore, së bashku me vendimin e arsyetuar, është dorëzuar nga subjekti në datën 23.1.2014 – 1 muaj e 2 ditë nga shpallja e vendimit, jashtë afatit 5-ditor të përcaktuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale.

Në lidhje me këtë konstatim, subjekti⁷⁸ shpjegoi: *“Bazuar në urdhrin e kryetarit të gjykatës nr. 116, datë 27.11.2013, kam qenë e gatshme për shqyrtimin e masave të sigurimit nga data 16 deri në datën 22 dhjetor 2013. Gjatë kësaj jave ka pasur shumë ngarkesë me gjykime, si të masave të sigurimit penale, edhe gjykimet e tjera civile. Vetëm masa sigurimi kanë qenë 55 vendime, pa përfshirë kërkesat e tjera penale të organit të prokurorisë. Gjithashtu, shtoj se kam pasur probleme të rënda familjare shëndetësore, babai im i sëmurë rëndë i shtruar në sanatorium për një periudhë funddhjetor 2013 deri në janar 2014. Madje, edhe masat e sigurimit që kanë qenë me afat (të cilat shqyrtohen nga i njëjti gjyqtar që ka dhënë vendimin e masës së sigurimit), për shkak të mungesës sime, janë shqyrtuar nga gjyqtari i gatshëm, sigurisht me miratimin e kryetarit të gjykatës. Ndërsa kërkesa e tretë për të njëjtin person nën hetim G. D. me objekt zëvendësim të masës së sigurimit, është shqyrtuar nga ana ime, është shpallur vendimi nr. ***, datë 21.3.2014, ku është vendosur mospranim i kërkesës.*

Sqaroj gjithashtu se nuk ka ardhur ndonjë pasojë për palët nga kjo vonesë”.

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, ndër të tjera, konstaton se ajo i ka bashkëlidhur parashtrimeve të saj urdhrin nr. 116, datë 27.11.2013, të kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në të cilin subjekti i rivlerësimit është caktuar si një ndër gjyqtarët që do të gjykojnë kërkesat paraprake (masa sigurimi dhe kërkesa të tjera) në muajin dhjetor të vitit 2013. Bazuar mbi këtë urdhër, rezulton se në intervalin kohor 16.12.2013 - 23.12.2013 subjekti i rivlerësimit ka gjykuar 55 kërkesa paraprake penale. Pavarësisht këtij fakti, subjekti duhej të nxirrte në kohë vendimin e arsyetuar, pasi kemi të bëjmë me masa sigurimi të cilat duhet të shqyrtohen në një kohë sa më të shkurtër.

⁷⁸ Subjekti ka depozituar: tabelën me numrin e çështjeve – kërkesa për masë sigurimi të shqyrtuara nga data 16.12.2013 deri në datën 23.12.2013; urdhrin nr. 116, datë 27.11.2013, të kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për zhvillimin e gjykimeve të kërkesave gjatë hetimeve paraprake për muajin dhjetor 2013; nxjerrë nga sistemi: vendim nr. *** akti, datë 21.12.2013, për caktim mase sigurimi “arrest në burg me afat 10-ditor”, për personin nën hetim G. D.; vendim nr. ***, datë 31.12.2013, për të njëjtin person nën hetim, ku janë bashkuar dy kërkesa, kërkesa nr. *** e personit nën hetim për shuarje mase dhe kërkesa me nr. *** akti e Prokurorisë për caktim mase sigurimi “arrest në burg”, shqyrtuar nga gjyqtari i gatshëm (për shkak të mungesës sime për arsye objektive), për personin nën hetim G. D.; vendim nr. ***, datë 21.3.2014, për të njëjtin person nën hetim G. D.; kopje të akteve të dosjes masë sigurimi, nr. *** akti, datë 20.12.2013, datë vendimi 21.12.2013, për personin nën hetim S.N; kopje të librit të dorëzimit të dosjeve të masave të sigurimit, intervali kohor 30.12.2013 – 24.1.2014 (7 fletë); kopje të librit të dorëzimit të dosjeve civile, intervali kohor 21.11.2013 – 24.1.2014 (13 fletë).

3. Gjykimi nga subjekti i rivlerësimit ka zgjatur gjithsej 1 ditë në intervalin kohor 20.12.2013 – 21.12.2013, bazuar në nenin 259/5 të Kodit të Procedurës Penale. Kohëzgjatja e gjykimit nga subjekti i rivlerësimit ka respektuar natyrën urgjente të këtyre lloj kërkesave dhe, rrjedhimisht, ka respektuar edhe standardin e procesit të rregullt ligjor.
4. Në dosje nuk ka vendim për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore dhe as akte të njoftimit të palëve për datën e seancës.

Në lidhje me këtë konsatim, subjekti sqaroi se gjykimet e masave të sigurimit në bazë të nenit 259 të Kodit të Procedurës Penale janë të karakterit urgjent, pasi gjykohen brenda 48 orëve dhe nuk i nënshtrohen rregullave procedurale të gjykimit të zakonshëm. Për pasojë, nuk parashikohen vendime formale për caktim seancash, pasi ato zhvillohen në vijimësi, njëra pas tjetrës. Po ashtu, njoftimi i të arrestuarve bëhet me një shkresë drejtuar Drejtorisë së Policisë e Qarkut Tiranë, ku listoheshin të arrestuarit, të cilët shoqëroheshin nga toga e shoqërimit. Po ashtu edhe prokurorët njoftoheshin me telefon ose, kur paraqisnin kërkesën, caktohej seanca dhe ata paraqiteshin dhe merrnin pjesë në seancat në vijimësi.

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, konstaton se ato nuk janë të shoqëruar me prova si dhe mbeten në nivel deklarativ.

5. Vendimi gjyqësor është vendim për vleftësim arresti dhe caktim mase sigurimi, me të cilin është vendosur vleftësimi i arrestit në flagrancë dhe caktimi i masës së sigurimit detyrim për t'u paraqitur në policinë gjyqësore.

Vendimi rezulton se është i strukturuar sipas elementeve të parashikuara në nenet 245 dhe 259 të Kodit të Procedurës Penale: pjesa hyrëse, përshkruese-arsyetuese dhe dispozitivi i gjykatës. Dispozitivi i vendimit është i qartë dhe është rrjedhojë e analizës së kryer nga gjykata në pjesën përshkruese-arsyetuese. Është urdhëruar Policia Gjyqësore Tiranë të zbatojë vendimin, si dhe tregohet e drejta e ankimit dhe afati i ushtrimit të kësaj të drejte.

TË DHËNA NGA BURIME ARKIVORE TË KLD-së

298. Nga raporti i KLGJ-së u konstatua se ndaj subjektit kishte disa ankesa, për 2 ankesa të vitit 2014, verifikuar bazuar mbi informacionin periodik ardhur nga kryetari i gjykatës për mosdorëzimin në afat të vendimeve gjyqësore të arsyetuara i janë regjistruar subjektit për efekt vlerësimi profesional dhe etik.

299. Komisioni ka administruar dokumentacionin⁷⁹ që lidhet me këto ankesa dhe nga shqyrtimi i tij ka rezultuar:

- a) KLD-ja ka kryer verifikimet në lidhje me informacionin e përcjellë nga kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me shkresën nr. *** prot., datë 3.2.2014, mbi mosdorëzimin në afat të vendimit gjyqësor të arsyetuar nr. ***, datë 22.11.2013, nga subjekti i rivlerësimit.

Nga verifikimi ka rezultuar se vendimi është dorëzuar në sekretari në datën 9.1.2014, pra në një afat prej 1 muaj e 18 ditë, tej afatit 10-ditor të parashikuar nga neni 308 i Kodit të Procedurës Civile apo afatit të përgjithshëm të ankimit prej 15 ditësh.

⁷⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 31.1.2023, drejtuar KLGJ-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 6.2.2023, e KLGJ-së.

Në shpjegimet e saj, subjekti ka pretenduar se gjatë kësaj periudhe ka pasur mbingarkesë, ku vetëm për masat e sigurimit ka dhënë 55 vendime, si dhe ka pasur probleme të rënda shëndetësore të familjarëve të saj. Ajo sqaron se nuk rezulton të ketë ardhur ndonjë pasojë për palët nga kjo vonesë.

Në konkluzion, KLD-ja ka çmuar se shkelja e konstatuar duhet t'i evidentohet gjyqtarës për efekt vlerësimi etik dhe profesional të saj, pa aktin e tërheqjes së vëmendjes me shkrim.

Komisioni, pasi analizoi dokumentacionin e mësipërm, i kërkoi shpjegime subjektit në lidhje me dorëzimin e vendimit në një afat prej 1 muaj e 18 ditë, tej afatit 10-ditor të parashikuar nga neni 308 i Kodit të Procedurës Civile.

Subjekti, në lidhje me këtë konstatim, shpjegoi: *“Arsyetimi i vendimit është bërë në kohë nga ana ime si gjyqtare, por dorëzimi i dosjes në sekretari me vonesë ka ardhur për disa arsye, që mendoj se janë: probleme teknike të kompjuterit dhe pamundësia e nxjerrjes së vendimit, për të cilën pas datës 1 dhjetor 2013 është bërë reformatimi i tij. Ishim në pamundësi për ta nxjerrë teknikisht, kësaj arsyeje i shtohet edhe ngarkesa e madhe e shpalljeve të kësaj periudhe si çështje civile, edhe administrative që u nisën për në Gjykatën Administrative të Tiranës. Gjithashtu, ka qenë edhe java e masave të sigurimit që kam qenë e gatshme me një ngarkesë të madhe për periudhën 16.12.2013 - 23.12. 2013. Vetëm masa sigurimi kanë qenë 55 vendime, pa llogaritur kërkesat e tjera të organit të Prokurorisë. Kësaj periudhe me ngarkesë më duhet t'i shtoj edhe problemet e rënda familjare shëndetësore, kam pasur babain të sëmurë rëndë, e kemi shtruar në sanatorium për një periudhë nga fundi i dhjetorit deri në janar 2014. Madje, edhe masat e sigurimit që kanë qenë me afat për shkak të mungesës sime, janë shqyrtuar nga gjyqtarët e tjerë të gjykatës, sigurisht me miratimin e kryetarit të gjykatës. Menjëherë, sa kam ardhur në punë, në javën që bëhen mbartjet në gjykatë, kam dorëzuar edhe dosjen objekt shqyrtimi.*

Në lidhje me provat, theksoj se janë të njëjtat prova që kam depozituar për dosjen nr. 5 shpjeguar më lart, duke shtuar edhe faktin e ngarkesës së madhe me dosjet civile dhe administrative, që u nisën me vendim për në Gjykatën Administrative të Tiranës, ndërsa problemet teknike të kompjuterit i përkasin muajit dhjetor 2013 dhe është evidentuar si problem nga vetë inspektorët e KLD-së”.

Nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti, së bashku me parashtrimet e saj, rezulton se me urdhrin datë 27.11.2013, subjekti i rivlerësimit ishte caktuar nga kryetari i gjykatës si një ndër gjyqtarët që do të gjykonte kërkesat paraprake (masa sigurimi dhe kërkesa të tjera) në muajin dhjetor të vitit 2013. Referuar tabelës ku pasqyrohen kërkesat për “masa sigurimi” të paraqitura nga subjekti, rezulton se gjykimet për këto kërkesa janë zhvilluar në intervalin kohor 16.12.2013 - 23.12.2013. Duke konsideruar që vendimi gjyqësor është dhënë nga subjekti në datën 22.11.2013 edhe gjykimet për masa sigurimi janë kryer rreth 20 ditë më pas, Komisioni vlerëson se subjekti ka pasur kohën e nevojshme për dorëzimin e vendimit në sekretari. Për rrjedhojë, subjekti në këtë rast rezulton se nuk ka respektuar afatet kohore për zbardhjen e vendimit. Duke qenë se afati kohor nuk është shumë i gjatë, si dhe duke marrë në konsideratë faktin se subjekti ka pasur ngarkesë në punë, duke qenë se ka punuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, vlerësohet se kjo vonesë nuk mund të ndikojë në vlerësimin profesional të subjektit.

b) KLD-ja ka kryer verifikimet në lidhje me informacionin e përcjellë nga kryetari i Gjykatës Tiranë me shkresën nr. *** prot., datë 2.6.2014, mbi mosdorëzimin në afat të vendimit gjyqësor të arsyetuar nr. ***, datë 11.4.2014, nga subjekti i rivlerësimit.

Nga verifikimi ka rezultuar se vendimi është dorëzuar në sekretari në datën 30.6.2014, pra për një afat kohor prej 2 muaj e 19 ditë.

Në shpjegimet e saj, subjekti ka pretenduar se vonesa në zbardhjen e vendimit ka ardhur pasi ajo është shkëputur me leje nga kryetari i Gjykatës Tiranë për intervalin kohor 22.4.2014 - 22.5.2014 dhe për intervalin kohor 23.5.2014 - 23.6.2014 për arsye familjare. Duke zbritur periudhën e lejes, mbeten vetëm 19 ditë kohë efektive pune për zbardhjen e vendimit.

Në konkluzion, KLD-ja ka çmuar se shkelja e konstatuar duhet t'i evidentohet gjyqtarës për efekt vlerësimi etik dhe profesional të saj.

Komisioni, pasi analizoi dokumentacionin e mësipërm, i kërkoi shpjegime subjektit në lidhje me dorëzimin e vendimit në sekretari, në një afat prej 2 muaj e 19 ditë, tej afatit 10-ditor të parashikuar nga neni 308 i Kodit të Procedurës Civile.

Në lidhje me këtë konstatim, subjekti shpjegoi: *“Kjo çështje është gjykuar nga ana ime dhe është shpallur vendimi nr. ***, datë 11.4.2014. Nga ana ime ky vendim është dorëzuar i arsyetuar me vonesë për arsye familjare shëndetësore, për të cilën unë jam shkëputur me arsye dhe me leje nga kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me nr. *** prot., datë 2.4.2014 dhe me leje nga KLD-ja sipas akordimit për leje për shkëputje të përkohshme nga puna me nr. *** prot., datë 16.4.2014, me të cilën më është dhënë leje nga data 22.4.2014 deri më 22.5.2014 dhe me shkresën nr. *** prot., datë 19.5.2014, më është dhënë leje nga 23.5.2014 deri në datën 23.6.2014 për arsye familjare. Arsyeja familjare për të cilën më janë dhënë lejet e mësipërme si nga kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe nga KLD-ja janë për arsye familjare, si më poshtë: motra ime L.B, e cila banon në Itali, ka pasur një situatë shumë të rëndë shëndetësore dhe ka qenë me diagnozë insuficiencë të rëndë të organizmit në gjendje kome, situatë e cila kërkonte prezencën e familjarëve të saj.*

Përveç ngarkesës së madhe që kam pasur në punë, arsyeja kryesore që ka sjellë vonesën në arsyetimin në dosjen e mësipërme, është arsyeja shëndetësore e motrës sime, për të cilën jam detyruar të largohem për një periudhë të gjatë në Itali, për t'i shërbyer motrës sime.

Në lidhje me provat, po ju vë në dispozicion dokumentacionin - lejet e dhëna nga KLD, si dhe konfirmimet nga IRCCS M për gjendjen shëndetësore të motrës sime të ndjerë L.B, të cilat i kam pasqyruar edhe më lart, në dosjen nr. 3.”

Bazuar në dokumentacionin e depozituar nga subjekti, rezulton se i janë akorduar leje për periudhat 22.4.2014 - 22.5.2014 dhe 23.5.2014 - 23.6.2014, për rrjedhojë, vonesa në zbardhjen e vendimit provohet se ka ardhur jo vetëm për fajin e subjektit. Nëse në këtë vonesë nuk do të përfshijmë periudhën e lejes së dhënë subjektit, ajo rezulton me një vonesë prej 7 ditësh, e cila duke marrë në konsideratë ngarkesën e subjektit por dhe problemet e saj familjare është e justifikueshme.

300. Për dy ankesa të tjera të vitit 2014 rezulton se ato janë verifikuar për zvarritje gjykimi, ndër të cilat një ankesë i është regjistruar për efekt vlerësimi profesional dhe etik, ndërsa një tjetër i është sugjeruar “tërheqje vëmendjeje” me shkrim për efekt vlerësimi. Këto ankesa i

përkasin pretendimeve të ngritura nga shtetasit A dhe A.C përmes shkresës nr. *** prot., datë 24.9.2014 dhe shtetasës V.P përmes shkresës nr. *** prot., datë 30.12.2014.

301. Nga verifikimi i dokumentacionit që u përket këtyre ankesave, rezulton si vijon:

a) Inspektorati i KLD-së ka verifikuar ankesën e shtetasve A e A.C, lidhur me pretendimin për zvarritje të gjykimit nga subjekti i rivlerësimit, për një afat 2 vjet, 4 muaj e 2 ditë.

Nga verifikimi ka rezultuar se gjykimi i çështjes është zgjatur përtej afatit standard për shkak të planifikimit dhe mosorganizimit të mirë të punës nga subjekti i rivlerësimit, lidhur kryesisht me afatin e shtyrjes së seancave gjyqësore nga njëra-tjetra.

Në përfundim, KLD-ja konkludon se zvarritja e gjykimit do t'i evidentohet subjektit për efekt vlerësimi etik dhe profesional.

Për sa më sipër, duket se subjekti ka zvarritur gjykimin, duke cenuar të drejtat e palëve për një proces brenda një afati të arsyeshëm.

Pas kalimit të barrës së provës, subjekti pretendoi se: *“Sqaroj se kjo çështje civile me nr. *** akti, regjistruar në datën 31.5.2011, me nr. vendimi ***, datë 2.10.2013, me paditës A dhe A. C, ka pasur fillimisht të paditur Ministrinë e Brendshme dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, me objekt ‘detyrimi i të paditurve që të paguajnë pagën e bashkëshortes A. C, e papunë, si rezultat i transferimit të paditësit A.C që prej datës 31.7.2007 dhe në vazhdim, deri në afatin e përcaktuar në ligj’.*

Përpos faktit që janë shtyrë disa seanca për arsye objektive të mungesës sime si gjyqtare e çështjes në datën 5.10.2011 dhe 2.5.2012 – angazhimi pranë Shkollës së Magjistraturës apo të dy kërkesave për shtyrje seance nga personi i tretë në datën 17.12.2012 dhe prej të paditurit në datat 27.5.2013 dhe 25.9.2013, vlen për t’u theksuar se nga pala paditëse janë shtyrë disa herë seancat, si për shkak të padisë me të meta në datën 13.7.2011 – mungesa e tarifës gjyqësore, me kërkesat e tyre për shtyrje seance në datën 24.11.2011 dhe 26.1.2011, edhe në vijim me disa kërkesa si paditës për rregullim ndërgjyqësie, datë 18.6.2012, për shtim objekti padie dhe thirrjen e personave të tretë në datën 11.7.2012, për të siguruar prova të tjera në datën 22.2.2012, për rregullim ndërgjyqësie largimin e personave të tretë DPQ Kukës dhe DPQ Tiranë dhe thirrjen e tyre si të paditur në datën 12.4.2013.

Gjykata i ka dhënë mundësinë palës paditëse të plotësojë të gjitha të metat, si për sa i përket ndërgjyqësisë, objektit të kërkimit në padi, edhe plotësimin me të gjithë provat e pretenduara prej tyre për një hetim të plotë të saj.

- *Ndaj, zvarritjet e konstatuara janë kryesisht nga vetë pala paditëse dhe, nëse i përjashtojmë nga afati i gjykimit gjashtë seancat që janë shtyrë me kërkesën e vetë palës paditëse, rezulton se gjykimi nga ana e gjykatës nuk ka pasur zvarritje.*
- *Ndërsa afati i shtyrjes së seancave gjyqësore nga njëra-tjetra është pasojë e ngarkesës me dosje që kam pasur unë dhe vetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë prej disa vitesh.*

*Vlen për t’u theksuar edhe vendimmarrja e kësaj gjykate, një gjykim i drejtë dhe objektiv, i pacenuar, ka mbetur në fuqi në gjykatat më të larta. Konkretisht, pas ankimit të palës paditëse, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 30.4.2014, ka vendosur të shpallë moskompetencën e Gjykatës Apelit Tiranë për gjykimin e çështjes nr. *** regj. them., datë*

3.2.2014 dhe dërgimin e akteve gjykatës kompetente, Gjykatës Administrative të Apelit, e cila, me vendimin nr. ***, datë 21.7.2014, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 2.10.2013. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë si paditësit, edhe pala e paditur.

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. ***, datë 19.2.2019, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga pala paditëse A.C dhe A.C dhe palë e paditur Drejtoria e Policisë Qarku Tiranë, ndaj vendimit nr. ***, datë 21.7.2014, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

Paditësit janë ankuar për zvarritje të gjykimit pranë KLD-së, e cila me urdhrin nr. *** prot., datë 14.10.2014, ka verifikuar ankesën dhe ka nxjerrë konstatimet e evidentuara në kthim përgjigjen nr. ***, datë 23.3.2015.

Në lidhje me afatin e pretenduar nga KLD-ja, sqaroj se ky afat 6-mujor që u vendos prej tyre nuk ishte në përputhje me afatet që zbatonte KEDNJ-ja për gjykimet, i cili llogaritet mesatarisht 2 vjet për çdo shkallë gjykimi. Në përlllogaritjen e afatit merren parasysh edhe elemente të tjera, si: kompleksiteti i çështjes, palët pjesëmarrëse, sjellja e tyre gjatë gjykimit etj. Koha e tregoi që afati i aplikuar për vlerësimet nga KLD-ja ishte joobjektiv. Për rrjedhojë, ligjvënësi me ndryshimet që i bëri Kodit të Procedurës Civile me ligjin 38/2017, neni 399/2, pika 1/b, përcaktoi një afat 2-vjeçar si afat i arsyeshëm për gjykimin e çështjeve civile. Vlerësoj se kjo çështje e sipërcituar, nisur nga kompleksiteti i paraqitur, është gjykuar prej meje brenda një afati të arsyeshëm”.

Komisioni analizoi dosjen e depozituar nga subjekti, nga ku konstatohet se çështja ka qenë komplekse dhe sjellja e palëve nuk ka qenë në nivelin e duhur. Nga ana e subjektit nuk janë marrë masat e nevojshme për të rregulluar sjelljen e palëve, si dhe në disa raste seancat janë lënë me afate të gjata. Pavarësisht pretendimeve të subjektit lidhur me kërkesat për shtyrje të palëve ndërgjyqëse të cilat kanë shkaktuar vonesën në shqyrtimin e çështjes gjyqësore, si dhe kompleksitetit të çështjes, subjekti i rivlerësimit duhet të kishte treguar kujdesin e nevojshëm për përfundimin e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm. Për rrjedhojë, Komisioni vlerëson se subjekti në këtë rast ka shfaqur mangësi në drejtim të aftësive organizative sipas parashikimit të nenit 74, pika 2 e ligjit nr. 96/2016.

b) Inspektorati i KLD-së ka verifikuar ankesën e shtetases V.P lidhur me pretendimin për mosrespektim formal të ligjit në shqyrtimin e çështjes familjare me objekt “lëshim i urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes”.

Nga verifikimi ka rezultuar se gjykimi i çështjes ka zgjatur 5 ditë, në shkelje të afatit 48-orësh të parashikuar në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar. Në përfundim të gjykimit, subjekti ka vendosur të rrëzojë kërkesën për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes. Ky vendim është ndryshuar nga Gjykata e Apelit Tiranë, e cila ka çmuar se ka vend për t’u lëshuar urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes.

Në përfundim, KLD-ja çmon se nga ana e subjektit të rivlerësimit ka mosrespektim formal të ligjit në drejtim të mosrespektimit të afatit 48 orë për të vendosur lidhur me kërkesën për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes dhe, për këtë shkak, çmon se ka vend për tërheqje vëmendjeje me shkrim gjyqtares dhe evidentimin e saj për efekt vlerësimi etik dhe profesional.

Në përfundim duket se:

- Subjekti ka tejkaluar afatet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi.
- Subjekti nuk ka argumentuar vendimin e lëshimit të urdhrit të mbrojtjes.
- Për rrjedhojë, ka cenuar të drejtën e palës kërkuese për një proces të rregullt dhe brenda afatit.

Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, pretendoi se: *“Sqarohet se kjo çështje civile familjare me nr. *** akti, datë regjistrimi 16.12.2014, ka ardhur pranë meje si gjyqtare në datën 17.12.2014 dhe është caktuar për shqyrtim seanca gjyqësore në datën 18.12.2014, seancë e cila nuk u zhvillua për shkak të mungesës së palës së paditur. Në seancën e datës 19.12.2014, pasi dëgjoi palët, me kërkesën e palës paditëse, si dhe faktet e parashtruara në seancë gjyqësore, gjykata vendosi të thërrasë si dëshmitar në gjykim djalin e ndërgjyqësve, si dhe të kërkojë provat nga policia, të kërkojë nga ana e Komisarariatit të Policisë emrat e personave që kanë qenë prezent në ditën e ngjarjes dhe dëshminë e tyre në komisarariat, duke caktuar seancë të nesërmen, në datën 20.12.2022. Nisur nga shkresa e gjykatës, datë 19.12.2022, Komisaritati i Policisë nr. 4 Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë 21.12.2014, ka përcjellë në gjykatë materialin e munguar, dëshmitë e katër shtetaseve. Provat e paditëses, fotokopje, nuk ishin në formën e kërkuar nga ligji. Në seancën e datës 21.12.2014, me administrimin e provave, përfundoi hetimi gjyqësor dhe u vijua me shpalljen e vendimit.*

Sikurse e kam shpjeguar më lart, dosja ka mbërritur formalisht në gjykatë në datën 16.12.2017 dhe pranë meje si gjyqtare në datën 17.12.2014, me mangësi të akteve e, në këto kushte, nisur nga kërkesa e vetë paditëses e konform parashikimeve të ligjit për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare nr. 9669, datë 18.12.2006, i ndryshuar, me paraqitjen e akteve të plota nga Komisaritati i Policisë nr. 4 Tiranë, në datën 21.12.2022, është një afat i ri i paraqitjes së kërkesëpadisë me aktet e plota, e në të njëjtën datë 21.12.2014, gjykata ka shpallur vendimin.

*Momenti i dytë është arsyetimi i vendimit, i cili është i plotë, nuk ka asnjë mangësi, është i arsyetuar konform parashikimeve të ligjit. Gjykata ka arsyetuar vendimin, ka konstatuar se palët ndërgjyqëse janë ish-bashkëshortë, pasi martesë e tyre është zgjidhur, jetojnë në banesë me vete, aktualisht është konstatuar se kanë mosmarrëveshje mes tyre dhe marrëdhënia nuk është e qetë, por shkak i mosmarrëveshjeve është bashkëpronësia e tyre mbi disa pasuri, si dhe qiratë që ata vjelin nga pasuritë. Është konstatuar se mosmarrëveshja që kanë ndërgjyqësit në lidhje me qiratë e godinës me disa kate, ku përfshihen edhe të ardhurat nga qiratë, nuk mund të zgjidhen me kërkesëpadinë për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes, i cili ka për qëllim parësor të mbrojë viktimat nga dhuna në familje, me të gjithë format e saj. Në këto kushte, pasi ka vlerësuar dhe arsyetuar gjykata me vendimin nr. **, datë 21.12.2014, ka konkluduar në rrëzimin e padisë. Nisur nga ankimi i paditëses, çështja është gjykuar në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila me vendimin nr. *, datë 20.2.2015, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. ** të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Tiranë, pranimin e padisë së paditëses V.P, lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes për paditësen, urdhërohet i padituri P.P të mos kërcënojë, të mos cenojë, ngacmojë dhe kontaktojë paditësen V.P, të mos i afrohet banesës dhe qendrës së punës së paditëses, efektet e vendimit nga data 20.2.2015 deri në datën 20.8.2015”.*

Komisioni, pasi analizoi fashikullin gjyqësor të depozituar nga subjekti, konstaton se:

- Çështja civile është regjistruar në gjykatë, në datën 16.12.2014 dhe i është caktuar për gjykim një tjetër gjyqtari. Pasi ky gjyqtar ka dhënë dorëheqjen për shqyrtimin e çështjes, me vendim të kryetarit të gjykatës, çështja u rihodh në short në datën 17.12.2014 dhe i kaloi për shqyrtim subjektit të rivlerësimit.

Sipas fletëthirrjeve në dosjen gjyqësore, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka caktuar seancat gjyqësore datë 18.12.2014, 19.12.2014, 20.12.2014 dhe datë 21.12.2014. Referuar procesverbaleve të seancave gjyqësore rezulton se pala e paditur nuk është paraqitur në seancën e datës 18.12.2014. Në seancën e datës 19.12.2014 u paraqit pala e paditur dhe po në këtë seancë subjekti vendosi të thërrasë si dëshmitar djalin e ndërgjyqësve, i cili ka refuzuar të dëshmojë. Në seancën e datës 21.12.2014, subjekti ka administruar në cilësinë e provës procesverbalet e 4 shtetasve, të cilët kanë qenë prezent gjatë konfliktit të pretenduar. Nga sa më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka marrë masat e nevojshme për gjykimin e çështjes brenda afatit 48 orë të përcaktuar në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar, duke caktuar seancën gjyqësore të nesërmen e datës, që i është caktuar për shqyrtim kjo çështje.

Sa i përket vendimmarrjes së subjektit, vlerësojmë se Komisioni nuk mund të përfshihet në analizë të themelit të çështjes, e cila u përket gjykatave më të larta, ndërkohë që vendimi përmban të gjitha elementet e parashikuara nga legjislacioni. Në lidhje me argumentimin vlerësohet se subjekti mund të kishte bërë një vlerësim më të plotë të provave, por për sa kohë nuk ka *indicie* për ndikim në vendimmarrje, si dhe kemi të bëjmë vetëm me një rast, Komisioni vlerëson se nga ana e subjektit nuk janë shfaqur mangësi profesionale.

302. Për 1 ankesë të vitit 2016, verifikuar për zvarritje, i është regjistruar gjyqtares për efekt vlerësimi profesional dhe etik.

Kjo ankesë është paraqitur sërish nga shtetasi S.B, i cili pretendon zvarritjen e gjykimit nga subjekti i rivlerësimit. Nga verifikimet e kryera prej KLGJ-së ka rezultuar se shqyrtimi i çështjes ka zgjatuar 3 vite, 4 muaj e 19 ditë. Për këtë çështje janë zhvilluar 39 seanca (2 seanca përgatitore dhe 37 seanca gjyqësore), por KLGJ-ja evidenton se çështja ka pasur natyrë tepër komplekse, pasi në të përfshihen 5 paditës të kundërpaditur, 13 të paditur, 2 të paditur të tjerë me tri objekte të padisë dhe një objekt të kundërpadisë. Lidhur me afatin e gjykimit të çështjes, KLGJ-ja thekson faktin se në këtë afat janë përfshirë edhe dy leje me nga një muaj secila, të akorduara nga zëvendëskryetari i KLD-së, dy leje me nga 5 ditë të akorduara nga kryetari i gjykatës dhe 4 raporte shëndetësore për 14 ditë pushim. Po kështu, shtyrjet e seancave gjyqësore kryesisht me kërkesa për shtyrje të vetë paditësve të kundërpaditur dhe të të paditurve kundërpaditës, gjithsej në 17 seanca gjyqësore, kanë ndikuar dukshëm në tejkalimin e afateve standarde të gjykimit.

Për sa më sipër, duket se subjekti ka zvarritur gjykimin, duke cenuar të drejtat e palëve për një proces brenda një afati të arsyeshëm.

Pas kalimit të barrës së provës, subjekti pretendoi se: *"Nga verifikimi i akteve të dosjes është e mundur të konstatohet natyra komplekse e çështjes, 5 paditës të kundërpaditur, me 13 të paditur kundërpaditës, si dhe 2 të paditur, me tri objekte të padisë dhe një objekt të kundërpadisë, domosdoshmëria e kryerjes së një aktekspertimi teknik, nga ekspert topogjeodet i fushës, pasqyrohen arsyet objektive të palëve dhe të gjykatës në shtyrjet e seancave. Për sa u përket*

arsyeve të mia si gjyqtare e çështjes, janë objektive për arsyen shëndetësore të motrës sime, me leje të miratuar nga KLD-ja, që e kam shpjeguar edhe në dosjet e mësipërme, arsyeja ime shëndetësore, sindroma e tunelit karpal, kam operuar dorën e djathtë në datën 10 shkurt 2016, shoqëruar kjo situatë me një raport mjekësor 15-ditor (akte të verifikuara edhe nga inspektorët e vetë KLD-së).

Në lidhje me përlllogaritjen e afatit mendoj se duhet të merren parasysh të gjitha elementet, si: kompleksiteti i çështjes, palët pjesëmarrëse dhe sjellja e tyre gjatë gjykimit etj. Edhe mënyra e vlerësimit e aplikuar nga KLD-ja ishte joobjektive. Për rrjedhojë, ligjvënësi me ndryshimet që i bëri Kodit të Procedurës Civile, me ligjin nr. 38/2017, në nenin 399/2, pika 1/b, përcaktoi një afat 2-vjeçar, si afat i arsyeshem për gjykimin e çështjeve civile. Vlerësoj se kjo çështje e sipërcituar e ka pasur si kompleksitetin e paraqitur, mbledhjen e provave, por edhe arsyet objektive të shtyrjeve të seancave, të cilat duhen marrë në konsideratë. Respektimi i kohës dhe i afateve është një aspekt i rëndësishëm i procesit të rregullt, por qëllimi kryesor në një gjykim është dhe realizimi i një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm, referuar nenit 14 të Kodit të Procedurës Civile, me cilësi dhe, në këtë kontekst, nisur edhe nga një sërë faktorësh, të cilët nuk varen tërësisht nga gjykata (si shtyrje seance, marrje apo njohje me prova, harmonizim me institucione të tjera etj.). Shtyrjet e seancave, sikurse edhe është konstatuar, janë kryesisht me kërkesa për shtyrje të vetë paditësve të kundërpaditur dhe të të paditurve kundërpaditës, gjithsej në 17 seanca gjyqësore dhe, nëse i përjashtojmë nga afati i gjykimit afatin e shtyrjeve me kërkesën e vetë palës paditëse, rezulton se gjykimi nga ana e gjykatës nuk ka pasur zvarritje”.

Komisioni, pasi analizoi fashikullin gjyqësor të depozituar nga subjektit, si dhe provat e paraqitura në lidhje me lejet e akorduar, vlerëson se pjesërisht justifikohen vonesat në lidhje me këtë çështje gjyqësore, por subjekti duhej të kishte treguar kujdesin e duhur për sa i përket organizimit të seancave gjyqësore. Nëse ajo kishte disa leje të marra mund të kërkonte tërheqjen nga kjo çështje gjyqësore me qëllim shmangien e një afati kaq të gjatë të gjykimit të çështjes. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka shfaqur mangësi në drejtim të aftësive organizative, sipas parashikimit të nenit 74, pika 2 e ligjit nr. 96/2016.

303. Për subjektin e rivlerësimit janë administruar 9 denoncime të paraqitura pranë Komisionit. Për njërin prej tyre, si vijon, Komisioni i ka kaluar barrën e provës subjektit.

Denoncim i shtetasit Y.B⁸⁰

Denoncuesi pretendon se subjekti i rivlerësimit ka marrë vendim të padrejtë dhe në shkelje me ligjin, si dhe ka kryer zvarritje të qëllimshme të procesit për një periudhë 12-mujore. Ai i ka bashkëlidhur ankesës së tij kopje të vendimit “për fazën e parë të pjesëtimit” të dhënë nga subjekti i rivlerësimit. Referuar përmbajtjes së vendimit, çështja gjyqësore është regjistruar në datën 20.1.2017 dhe vendimi është dhënë në datën 18.12.2017. Përmes këtij vendimi subjekti i rivlerësimit ka përcaktuar sendet që do t’i nënshtrohen pjesëtimit.

Për sa më sipër, duket se subjekti ka zvarritur gjykimin, duke cenuar të drejtat e palëve për një proces brenda një afati të arsyeshem.

Pas kalimit të barrës së provës, subjekti pretendoi se: “Në lidhje me afatin e gjykimit të kësaj çështjeje, e regjistruar në datën 20 janar 2017 dhe shpallur vendimi në 20 dhjetor 2017, sqaroj

⁸⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 23.1.2018.

se nuk duhet konsideruar zvarritje, është një konflikt familjar për pjesëtim pasurie mes ish-bashkëshortëve, i cili ka pasur problematikat e veta. Ka pasur shtyrje seance për pamundësinë e gjetjes së një adrese të të paditurit apo për t'u dhënë mundësi palëve të paraqesin prova, ka pasur pakësim të objektit të padisë, madje nga i padituri provat janë paraqitur në seancën përgatitore të datës 4.5.2017, ku u vendos kalimi i çështjes në seancë gjyqësore në datën 2.6.2017. Me kërkesë të palëve nga gjykata u janë kërkuar prova bankave konform parashikimeve të nenit 223 të Kodit të Procedurës Civile, nga pala e paditur është kërkuar shtyrje seance për të përgatitur prapësimet në lidhje me kontributet e secilit bashkëshort, si dhe për të paraqitur prova të reja, ndërsa në seancën e datës 22 shtator 2017 është vendosur inventarizimi i sendeve të luajtshme të ndodhura në banesën bashkëshortore, nëpërmjet Zyrës së Përmbarrimit Gjyqësor Tiranë. Në përllogaritjen e afatit mendoj se duhet të merren parasysh edhe elemente të tjera, si: fakti që janë ish-bashkëshortë me mosmarrëveshje, si edhe sjellja e tyre gjatë gjykimit etj., si dhe ndryshimet në Kodin e Procedurës Civile me ligjin nr. 38/2017 në nenin 399/2, pika 1/b, ku është përcaktuar një afat 2-vjeçar si afat i arsyeshëm për gjykimin e çështjeve civile. Vlerësoj se kjo çështje e sipërcituar, nisur nga kompleksiteti i paraqitur, është gjykuar prej meje brenda një afati të arsyeshëm”.

Komisioni, pasi analizoi fashikullin gjyqësor të depozituar nga subjekti, vlerëson se shpjegimet e saj në lidhje me konstatimin “për zvarritje” të procesit gjyqësor janë bindëse dhe duhet të pranohen. Nga shqyrtimi i akteve të dosjes gjyqësore rezulton se 2 seanca përgatitore janë shtyrë për shkak të njoftimit të palës së paditur. Në seancat vijuese (përgatitore) në disa raste kanë qenë vetë palët që nuk kanë dakordësuar për datat e ofruara nga gjykata për seancat e radhës, duke sjellë si pasojë caktimin e seancave gjyqësore në data të mëvonshme. Si pasojë e plotësimit të provave dhe paraqitjes së tyre në formën e kërkuar nga ligji, subjekti i rivlerësimit ka mundur të kalojë çështjen në seancë gjyqësore vetëm në datën 29.6.2017.

Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se afati i gjykimit të “fazës së parë të pjesëtimit” është zgjatur kryesisht si pasojë e sjelljes së palëve ndërgjyqëse gjatë gjykimit. Duke konsideruar edhe ndryshimet në Kodin e Procedurës Civile me ligjin nr. 38/2017, në nenin 399/2, pika 1/b, ku është përcaktuar një afat 2-vjeçar si afat i arsyeshëm për gjykimin e çështjeve civile, Komisioni vlerëson se nuk ka pasur zvarritje të gjykimit të kësaj çështjeje nga subjekti i rivlerësimit.

Konkluzion për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

304. Pas shqyrtimit të raportit të hartuar nga KLGJ-ja, denoncimeve të depozituara në Komision dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si më sipër, trupi gjykues vëren se nuk mund të ngrihen dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e gjyqtarit.

305. Në përfundim të vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale, trupit gjykues i rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale. Pavarësisht nga ky konstatim, si dhe nga sa u përshkrua më sipër, rezultoi se sjellja e subjektit të rivlerësimit në disa raste nuk ka qenë në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e nenit 74 të ligjit nr. 96/2016, lidhur me aftësitë organizative të një gjyqtari. Si rrjedhojë e sa më sipër, Komisioni vlerëson se problematikat e konstatuara nuk ngrihen në nivelin e shkakut që e bëjnë subjektin e rivlerësimit të papërshtatshëm në kuptim të nenit 44, germa “c” e ligjit nr. 84/2016, për të justifikuar vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, sipas parashikimeve të nenit 61, pika 4 e këtij ligji.

306. Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatores së çështjes, dëgjoji subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konkludon se subjekti:

- i. arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- ii. arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- iii. ka një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

Për këto arsye,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, referuar në nenin 4, pika 2, nenin 58, pika 1, germa “a”, si dhe në nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Fahrije Stringa (Budo), gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
 2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
 3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
 4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
- U shpall në Tiranë, në datën 13.4.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Lulzim HAMITAJ
Kryesues

Genta Tafa (BUNGO)
Relatore

Valbona SANXHAKTARI
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Etmonda Hoxha